

UNIVERSITETI SHTETËROR I TETOVËS
FAKULTETI FILOZOFIK
PROGRAMI STUDIMOR SOCIOLOGJI



TEZË MAGJISTRATURE

**Identiteti i migrantit shqiptar dhe integrimi i tij në Gjermani,
me theks të veçantë në qytetin e Leverkusenit**

Mentori :

Doc. Dr. Qani Nesimi

Kandidati:

Amir Xheladini

Tetovë, 2012

PËRMBAJTJA

Përmbajtja	2
Parathënie	4
Hyrje	6
1. Hipotezat e studimit	9
2. Mënyra e hulumtimit dhe metodologjia e studimit	10
3. Metodatat e përdorura	12
Kapitulli I.	14
SFONDI TEORIK I IDENTITETIT TË MIGRANTIT NË LEVERKUSEN TË GJERMANISË	14
1. Teoritë klasike për identitetin	14
2. Koncepti i identitetit etnik	15
3. Dimensionet e identitetit etnik	18
4. Akulturalizimi dhe identiteti etnik	19
Kapitulli II.	21
IDENTITETI I MIGRANTËVE SHQIPTARË NË LEVERKUSEN TË GJERMANISË	21
1. Identiteti nacional dhe migracioni	21
2. Strategjitë e formimit të identitetit tek migrantët	24
2.1.Gjuha e vendit pritës dhe gjuha amtare	25
2.2.Njohuritë e migrantëve shqiptarë ndaj gjuhës gjermane	27
2.3.Njohuritë e migrantëve shqiptarë ndaj gjuhës amtare	28
3. Kontakti i migrantëve shqiptarë me bashkëatdhetarët e tyre dhe me anëtarët e etnive dhe kulturave tjera	28
3.1.Përbërja e shoqërisë së migrantit shqiptar në Leverkusen	29
3.2.Kontakti i migrantëve shqiptarë në Leverkusen me pjesëtarët e kulturës kombëtare dhe pjesëtarët e etnive dhe kulturave tjera	30
4. Shkaqet e migrimit të shqiptarëve në Gjermani	31
4.1.Largimi nga vendlindja dhe zbarkimi i shqiptarëve në Gjermani	32
4.2.Ballafaqimi me një mjedis të ri	32
4.3.Ballafaqimi i migrantëve në Leverkusen me dukuritë si ksenofobia, diskriminimi dhe racizmi	34
5. Pozita e identitetit të migrantëve shqiptarë në Leverkusen	35
5.1.Identiteti nacional i migrantëve shqiptarë në Leverkusen	37
5.2.Identiteti fetar i migrantëve shqiptarë në Leverkusen	38

Kapitulli III.....	41
DIMENSIONET E IDENTITETIT TË MIGRANTIT SHQIPTAR DHE INTEGRIMI I TIJ NË SHOQËRINË E LEVERKUSENIT TË GJERMANISË.....	41
1. Migranti shqiptar dhe gjendja e identitetit të tij në procesin e integrimit në shoqërinë e Leverkusenit.....	41
2. Faktorët ndikues në mbrojtje të identitetit.....	44
2.1.Emancipimi kombëtar si faktor në mbrojtjen e identitetit.....	44
2.2.Emancipimi fetar si faktor në mbrojtjen e identitetit.....	45
2.2.1. Statistikat përshkruese të njohurive fetare.....	47
3. Shqiptarët dhe modeli i identitetit të tyre.....	48
4. Modeli tre dimensional i identitetit të shqiptarëve në procesin e integrimit.....	49
4.1. Identifikimi i migrantëve shqiptarë me kulturën kombëtare.....	50
4.1.1. Statistikat përshkruese të identifikimit të migrantit shqiptar me kulturën kombëtare.....	53
4.2. Identifikimi i migrantëve shqiptarë me kulturën gjermane.....	54
4.2.2. Statistikat përshkruese të identifikimit me kulturën gjermane.....	59
4.3. Identifikimi i migrantëve shqiptarë me kulturën fetare.....	60
4.3.3. Statistikat përshkruese të identifikimit me kulturën fetare.....	64
4. Rrjedha e hulumtimit.....	66
5.1. Mostra e hulumtimit dhe analizimi i të dhënave.....	66
5.2. Pjesëmarrja e të anketuarve sipas moshës dhe gjinisë së tyre.....	67
5.3. Pjesëmarrja e të anketuarve sipas nivelit arsimor dhe profesionit të tyre.....	69
5.4. Pjesëmarrja e të anketuarve sipas kohëzgjatjes së qëndrimit të tyre në migrim.....	70
5.5. Pjesëmarrja e të anketuarve sipas llojit të lejeqëndrimit dhe prejardhjes.....	70
5.6. Ngjasimi i migrantit shqiptar me një vendës dhe të ndjenjurit i huaj në Gjermani.....	72
5.7. Dimensionet e përceptimit të migrantëve shqiptarë.....	73
5.8. Migranti shqiptar mund apo jo të bëhet gjerman?!.....	73
5.9. Besueshmëria dhe vlera e statistikave përshkruese.....	74
6. Verifikimi dhe diskutimi i hipotezave.....	75
6.1. Hipoteza e parë.....	76
6.2. Hipoteza e dytë.....	82
6.3. Hipoteza e tretë.....	85
Përfundim.....	91
Shtojcë: Rezultatet e intervistave në formë tabelash.....	93
Literatura e shfrytëzuar.....	101

Parathënie

Shikuar nga prespektiva e ruajtjes, mbrojtjes dhe zhvillimit të identitetit kombëtar dhe fetar në shoqëritë multikulturore të kohës aktuale, shihet se studimet në këtë fushë janë ende në etapë eksperimentale. Diferencimet kulturore gjatë kësaj etape hasin në vështirësi të konsiderueshme gjatë realizimit praktik të tyre. Zhvillimit shoqëror të vendeve perëndimore të Europës posaçërisht në Gjermani, i kontribuon pa dyshim edhe historia, kultura, qytetërimi dhe tradita të cilën e sjellin migrantët. Duke u tematizuar në formë esenciale përmbajtja e identitetit (kombëtar dhe fetar) të migrantëve shqiptarë në kuadër të këtyre zhvillimeve për t'u rreshtuar me prespektivë për një të ardhme me vlera kulturore mes shoqërive perëndimore me kërkesa moderne. Ky punim ka për synim t'i kontribuoj këtij koncepti. Përmbajtja e temës synon shpalimin e botëkuptimeve, qëndrimeve dhe ndjenjave të migrantëve shqiptarë, në kuadër të identitetit kombëtar dhe fetar nga njëra anë dhe përceptimet e tyre ndaj identifikimit me kulturën gjermane, nga ana tjetër.

Në këtë punim përmbledhet kontributi i migrantëve shqiptarë nga të gjitha trojet etnike ndaj rrjedhave të proceseve integrale. Aktivitetet e migrantëve në fusha dhe krijimtari artistike të ndryshme të artikuluar në bazë të identitetit kombëtar dhe fetar kanë mundur dhe ofruar mundësi të shumta për komunikim serioz mes kulturave me përmasa lokale, regjionale dhe globale. E gjithë kjo ka ndikuar që në vendin përkatës migrantët të kenë qasje të qartë brenda këtyre koncepteve. Rezultatet e studimit mbeten të vlerësojnë këto merita të migrantëve për punën e tyre serioze në këtë fushë. Ambientimi shoqëror që synon të zotërojë klimën e përgjithshme socio-kulturore dhe strategjiko-politike, të plotësojë euforinë dhe pjekurinë e mirëfilltë kombëtare dhe fetare, pashmangshëm kuptohet nga migrantët mirë dhe drejtë nëse paraqiten nga pozita objektive, reale dhe pa prapavijë akulturalizuese.

Opinionet dhe mendimet e migrantëve respektohen dhe vlerësohen si të rëndësishme, të pëlqyeshme dhe me ndikim deri në një masë të duhur. Kjo vërehet përmes dialogut ndërretnik dhe ndërfejar që njëherit shihet si alternativë shumë e rëndësishme e kohës. Shkëmbimi i mendimeve në këtë fushë çon pa dyshim në njohje më të thellë reciproke që njëherit mbetet qëllim final i këtij punimi. Ky punim njëherit ka për qëllim të shmangë paragjykimet, dyshimet dhe njohuritë e cinguar në mënyrë që të arrihet kuptimi i drejtë dhe i plotë i veprimeve të migrantëve përmes aktiviteteve kulturore dhe projekteve të ndryshme sociale.

Në fakt, ky punim ka qëllim të dyfishtë. Në njërin anë të hulumtojë gjendjen e identitetit ndër migrantët shqiptarë, për nevojën e kultivimit të tij, për faktin që shqiptarët thirren për të qenë bartës dhe dëshmitarë të tolerancës, dialogut, mirësisë dhe paqes. Për të

përcjellë dhe ndërtuar këtë me argumente bindëse në botën moderne nga brezi në brez. Në anën tjetër punimi synon të sigurojë vendet e origjinës, se identiteti i bashkëkombasve të tyre të migruar është në gjendje solide. Meqë kjo temë është e ndieshme dhe shumë e gjërë, është e pamundur të përfshihet në një punim siç është ky. Struktura dhe tema qendrore e punimit analizon identitetin e migrantit shqiptar në Leverkusen të Gjermanisë në formë shumëdimensionale. Vëmendje serioze i kushtohet analizimit dhe prezantimit përmes statistikave përshkruese, identifikimit të migrantëve shqiptarë me kulturën kombëtare, gjermane dhe fetare.

Punimi ndahet në tre kapituj: Në kapitullin e parë flitet për sfondin teorik të identitetit të migrantit në Leverkusen të Gjermanisë. Ky kapitull bazohet në teoritë klasike për identitetin, pastaj analizon konceptin e identitetit etnik, dimensionet e tij si dhe për lidhshmërinë e akulturalizimit me identitetin etnik. Në kapitullin e dytë flitet për identitetin e migrantëve shqiptarë në Leverkusen të Gjermanisë. Ky kapitull debaton lidhjet orientuese të identitetit nacional që ndikojnë në mbyllje apo krijim të lidhjeve të reja të një strukture përparimtare idealiste. Në vazhdim ky kapitull trajton strategjitë e formimit të identitetit tek migrantët, shkaqet e migrimit të shqiptarëve në Gjermani, si dhe pozitën e identitetit të shqiptarëve në këtë vend. Kapitulli i tretë përqëndrohet mbi dimensionet e identitetit të migrantit shqiptar dhe integrimin e tij në shoqërinë e Leverkusenis të Gjermanisë. Këtë kapitull e karakterizon gjendja e identitetit të shqiptarëve në proceset integruese dhe faktorët ndikues në mbrojtje të identitetit. Analizon modelin tre dimensional të identitetit të shqiptarëve në proceset integruese. Kapitullin e tretë e finalizon verifikimi dhe diskutimi i hipotezave të punimit.

Literatura bazë në të cilën është mbështetur punimi janë veprat, studimet dhe hulumtimet aktuale të cilat trajtojnë identitetin e migrantit në shoqëritë perëndimore. Ky punim është bazuar në autorë dhe sociologë universitarë të cilët në masë të madhe dhe në mënyrë të përpiktë shtjellojnë finesat strukturore të identitetit të migrantëve, kuptohet pashmangshëm formësimi patriotik, politik dhe objektiv të identitetit. Gjatë këtij punimi është shrytëzuar literaturë bibliotekash universitare: Biblioteka e Universitetit të Kölnit, Biblioteka e Universitetit të Evropës Juglindore, Biblioteka e Universitetit Shtetëror të Tetovës, Biblioteka e Qytetit të Leverkusenis, Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës, Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë, etj. Një pjesë e litaraturës së shfrytëzuar është e botuar edhe në mënyrë digjitale në gjuhën shqipe, gjermane dhe angleze.

Hyrje

Migrimi përfaqëson një tipar shumë karakteristik të historisë së njerëzimit.¹ Ai ka qenë dhe mbetet i dhimbshëm ngase në shumicën e rasteve ndodhë si pasojë e problemeve materiale, ekonomike, sociale, poashtu edhe të ndërhyrjeve ushtarake. E veçanta e këtyre ndikimeve është rënia e Bashkimit Sovjetik,² si dhe në vazhdim rënia e të gjithë shteteve me ndikim dhe sistem monist. Shqiptarët poashtu janë pjesë dhe viktimë e këtij ndikimi. Gjenerata e parë e mërgatës shqiptare të viteve të 60-ta ka patur opsion kryesor zbutjen e problemeve materiale dhe ekonomike. Kjo gjeneratë mendonte që me plotësimin e zbrastirave esenciale, si rregullimi i standardit jetësor, shtëpisë, tokës, etj. të kthehet në vendlindje. Tashmë ky opsion i takon vetëm një kujtose të kaluar emocionale. Migrantët shqiptarë janë ngulitur nëpër qytetet e Gjermanisë, (edhe në Leverkusen), duke u shndëruar nga punëtorë të përkohshëm, në punëtorë të përhershëm, nga qytetarë të huaj në qytetarë vendas.

Zhvillimeve shoqërore dhe familjare në këtë proces i bashkangjitet sjellja dhe etablimi i familjeve e viteve të 80-ta. Tanimë qartësohet se ky proces merr përmasa kombëtare dhe qëndrimi i migrantëve në këto vende do të jetë i vazhdueshëm. Asaj kohe pak është dëgjuar dhe përfolur për termat; identitet dhe integrim, ajo që më shumë dëgjohej dhe përfolej ishte fjala „arbeit“ dhe „arbeiter“, punë dhe punëtorë. Konkluzione të asaj kohe në Gjermani kanë qenë; vendi të ndërtohet, industria të zhvillohet.³ Me kalimin e kohës nga migrantët shqiptarë fillon shfaqja e interesit për kultivimin e identitetit. Përmes këtij interesi fillojnë nismat e para për organizim shoqëror brenda komunitetit. Fillimisht shfaqen xhamitë dhe më vonë shoqatat kulturore që asaj kohe ishin jugosllave, pjesë e së cilës ishin edhe shqiptarët e Maqedonisë, Kosovës, Sërbisë dhe Malit të Zi. Shoqëria (nikoqire) tashmë krijon bindjen se ka të bëjë me njerëz të ndryshëm dhe me shoqëri të cilat kanë tipare dalluese.⁴

Politikanë, sociologë dhe akademikë vendës duke analizuar seriozitetin e identitetit të migrantëve angazhohen për gjetjen e një baze ideore dhe praktike sa më funksionale dhe të përshtatshme për jetë të përbashkët. Për një kohë relativisht të gjatë këto studime janë zhvilluar në forma eksperimentale dhe skeptike, të izoluara nga shoqëria. Me përparimin e mediave të pavarura, posaçërisht në kohën e globalizimit, nis një rikonceptim i krejt kësaj çështje duke u plasuar në shoqëri termat; multikulturë dhe integrim. Kjo mëton të jetë një metodë reformuese që migrantët të krijojnë vetëbesim dhe siguri psikologjike në një mjedis

¹ Straubhar, Thomas, *Migration im 21. Jahrhundert*, J.C.B. Mohr, Tübingen, 2002, fq. 10.

² Gestrich, Andreas, & Kraus, Marita, *Migration und Grenze*, Franz Steiner Verlag, Wiesbaden, 1998, fq. 12.

³ Nuscheler, Franz, *Internationale Migration. Flucht und Asyl*, Leske+Budrich, Opladen, 1995, fq. 33.

⁴ Po aty, fq. 222.

të hapur, me tolerancë socio-kulturore.⁵ Në kontekstin bashkëkohor sistematikisht hulumtohet dhe studiohet burimi kryesor i koncepteve të identitetit kombëtar dhe fetar që bartin migrantët. Ajo që më tepër është vërtetuar mbetet të jetë pritja e kalimit të kohës, ndërrimit të gjeneratave,⁶ ngase gjeneratat e para të migrantëve konsiderohen të jenë konservatore, të pandryshueshme, posaçërisht muslimanët.⁷

Gjeneratat e para ndonëse të pashkolluara dhe me mungesë të edukimit intelektual, mbeten me resurse, burime të pashtershme në fushën e mbrojtjes së identitetit. Sygjerimet e tyre janë që përmes shkollimit adekuat në vendin pritës, tashmë vendlindja e dytë, gjeneratat e reja të theksojnë përkatësinë ndaj identitetit, kulturës, traditës kombëtare dhe fetare. Në Gjermani ka bashkësi migrantësh mirë të organizuara, natyrisht shikimet përqëndrohen drejt një realiteti të ri. Më herët, migrantët që ishin të pashkolluar, të pakualifikuar, të ngarkuar dhe të etiketuar si „auslander“ (të huaj), tani diku dëgjon për tituj akademik dhe shkencor nga rradhët e tyre. Ata tashmë janë punëtorë të kualifikuar dhe qytetarë të akceptuar të mbrojtur nga shoqëria dhe ligji për të mbrojtur vetveten dhe identitetin. Në kohën e proceseve integruese në Gjermani, posaçërisht në Leverkusen paraqitet nevoja të dihet se cili është elementi që ndikon më pozitivisht për zbutjen e këtyre problemeve dhe cila është gjuha e përbashkët për afrimin e identiteve, kulturave dhe traditave.

Termi integrim sipas sociologut Hartmut Esser ka kuptimin e përshtatjes, barazisë ose shkrirjes të një personi, grupi ose komuniteti në një rreth ose shoqëri më të gjërë.⁸ Ky definim sipas sociologëve tenton të jetë rruga dhe forma më e përshtatshme e unitetit në diversitet. Migranti duke mësuar gjuhën e vendit, duke krijuar kontakte dhe duke kërkuar punë me siguri se është ndikues në proceset integruese, mirëpo parashtrohet pyetja se çka ndodhë me rastin e ndërrimit të shtetësisë, me rastin që fëmijëve në shtëpi ju flet gjuhën e shtetit të ri. Me rastin e marrjes së shtetësisë së re dhe duke mos komunikuar shqip, termi “integrim” fillon të merr një trajtë tjetër, ai veç fillon të anojë kah asimilimi. Sociologu Esser dallon katër lloje të integritit: Integrimi kognitiv; që ka të bëjë me njohjen e gjuhës dhe kulturës së shoqërisë së re. Integrimi strukturor; që nënkupton punësimin dhe banimin të cilët duhet të jenë të njëjtë me vendasit. Integrimi social; që paraqet krijimin e kontakteve me vendasit dhe pjesëmarrja

⁵ Schultz, Günther, *Zur Rolle der Medien in der Einwanderungsgesellschaft*, Friedrich-E.-Stiftung, 2010, fq. 5.

⁶ Kyra, Maria Fedtke, & Ribeiro, Leyla Steinbrugger, *Die unterschiedlichen Lebenswirklichkeiten der in Deutschland lebenden türkischen Männer und Frauen der 2. Generation*, Institut für Translation und Mehrsprachige Kommunikation Fachhochschule Köln, 2006, fq. 4.

⁷ Sarrazin, Thilo, *Deutschland schafft sich ab, Wie wir unser Land aufs Spiel setzen*, Deutsche Verlags-Anstalt, München, 2010, fq. 56.

⁸ Esser, Hartmut, *Soziologie, Band 2*, Campus Verlag, Frankfurt, 2000, fq. 262.

në jetën publike. Integrimi identifikues; që është përvetësimi i vlerave dhe normave në shoqërinë e re.⁹

Nga kjo përmbledhje që bën sociologu Esser duhet të analizohet më thellësisht teoria e integritit për tu kuptuar esenca e së vërtetës ndërmjet “integritit” dhe “asimilitit”. Migrantët duke paragjykuar se integrimi ka një dozë asimilimi fillojnë të shfaqin stereotipet etnike, fetare dhe kulturore. Paragjykimet kanë dy komponentë: komponentin kognitiv (njohës) dhe komponentin emocional. Për faktin se njerëzit jetojnë bashkë dhe nuk njihen mirë ndërmejt veti, duke patur mendime iracionale vjen në shprehje në kokat e tyre të lind paragjykimi.¹⁰ Gordon Marshall duke shpjeguar termin integrim social dhe integrim në sistem ka një qasje tjetër. Ai shprehet duke thënë: Ndonëse përdoret fjala “integrim”, nuk presupozohet që marrëdhëniet e emëruara në këtë mënyrë të jenë të harmonishme. Termat “integrim social” dhe “integrim në sistem” mund të përfshijnë edhe rendin edhe konfliktin.¹¹ Në pikën e pajtueshmërisë rreth çështjes së konceptit të teorisë së integritit thuajse ekziston një unitet mendimesh i cili ndërtohet mbi parimet e projekteve për jetë të përbashkët, tolerancë, dialog, respekt të ndërsjellë, shkëmbim mendimesh, idesh dhe përvojash duke u plasuar format e veçanta të diversitetit kulturor, gjuhësor, etj.

Fakti që njerëzit mund të jetojnë paralelisht me kultura, gjuhë dhe identitete të ndryshme ndjellë më tepër mrekulli, kulturë dhe histori sesa përjashtim.¹² Një numër i konsiderueshëm i migrantëve shqiptarë përdorin termin integrim duke mos ju interesuar të kuptojnë rrënjësisht domethënien e tij, njëherit edhe të vetëdijësohen për implikacionet e integritit. Nga ana tjetër ka edhe përzierje ndërmjet dimensionit kulturor, religjioz dhe nacional të termit integrim. Duke u ndeshur të tillët me qëndrime përkufizuese në mosdeklarimin çfarë ata janë, mbeten të jetojnë me sindromin, i cili në botën demokratike, i pengon të shohin veten ndryshe nga të tjerët.

⁹ Esser, Hartmut, *Integration und ethnische Schichtung*, Mannheimer Zentrum für Europäische Sozialforschung, Mannheim, 2001, fq. 8.

¹⁰ Sulejmani, Metush, *Përsiatje sociologjike*, Logos-A, Shkup, 2005, fq. 28.

¹¹ Marshall, Gordon, *Fjalor Sociologjik i Oksfordit*, Botimet IDK, Tiranë, pa vit botimi, fq. 152.

¹² Kermani, Navid, *Wer ist wir-Deutschland und seine Muslime*, C. H. Beck oHG, München, 2009, fq. 12.

1. Hipotezat e studimit

Hipoteza është pohim i asaj që besohet se është faktike, është supozim për të cilin besohet se mund ta zgjidhë problemin e shtruar. Ajo tregon se çfarë pritet të zbulohet kur organizohen në mënyrë të duhur vrojtimit e realitetit.¹³ Teoritë sociologjike mundësojnë shpjegimin e formësimit të identitetit. Njerëzimi në botën e sotme shfaqë kontekste të ndryshme rreth dimensioneve të identitetit individual dhe kolektiv. Përmes hipotezave të këtij studimi analizohen raportet mes identiteteve të migrantit shqiptar në Leverkusen të Gjermanisë. Ndikimi i rrethanave dhe proceseve të migracionit, posaçërisht në kohën moderne rezulton me përkufizimet e konceptit të identitetit. Përkufizimet në proceset e integrimi evropiane të migrantëve shqiptarë janë të dobishme për evidentimin e pasojave të cilat mundësojnë moskuptimin e elementeve strategjike të krijimit të identitetit. Gjatë rrugëtimit të migrantit shqiptar nëpër vite, fillimisht shoqëria mirë e organizuar ka ndikuar në mbrojtjen, ruajtjen dhe zhvillimin e identitetit kombëtar dhe fetar. Natyrisht ideja për vazhdimësinë e identitetit të të parëve, të origjinës, ka qenë e mbjellur në vendlindje.

Njeriu është i prirur t'i bashkangjitet ndonjë grupi, vetmia dhe dhembja që kanë shoqëruar migrantin shqiptar kanë ndikuar më tepër në organizimin e jetës kolektive. Për dallim nga idetë tjera, migracioni ka ndikuar që identiteti kombëtar dhe fetar të ketë një dimension politik dhe gjeografik të një formati tjetër. Pëlqimi i njerëzve që të vazhdojnë jetën si në vendlindje të organizuar në bashkësi dhe për tu ndjerë pjestarë të një identiteti, cilësohet si forma më e mirë e solidarizimit të migrantëve shqiptarë në Leverkusen të Gjermanisë. Dilema kryesore e hipotezave të studimit është përpjekja për të gjetur elementet kryesore për përkufizimin, origjinën dhe krijimin e identitetit posaçërisht në saje të integrimi evropiane. Pavarësisht dilemave të ndryshme, faktorët kontribues në formimin e identitetit kanë krijuar prespektiva praktike për vazhdimësinë e identitetit kombëtar dhe fetar. Janë krijuar kushte dhe rrethana për transformim të mjaftueshëm që migrantët shqiptarë të integrohen në shoqërinë vendëse përmes identifikimit me kulturën gjermane.

Duke u bazuar mbi baza të proceseve diferencuese dhe mbi baza të shkëmbimeve të ndërsjellta kulturore, mund të thuhet se varësisht nga rrethanat ekonomike dhe politike identitetit personal dhe kolektiv i hapen dyer të mundësive dhe rrethave të pritshme. Shumica e fakteve dëshmojnë se shtresimet e identitetit kulturor e kombëtar më shumë janë pasojë e gjendjes së pushtimeve se sa të një zhvillimi normal. Nga kjo kuptohet se më tepër bëhet fjalë për imponime nga jashtë, nganjëherë edhe të dhunshme, e më pak si përpjekje për

¹³ gselaci.files.wordpress.com, Selaci, Gëzim, *Si të kryeni një projekt hulumtues*, (20.12.2011).

kontakte normale. Të tjerët mendojnë se identiteti i popujve pa marrë parasyshë si definohet nga të tjerët, në fakt janë të dhëna të lindura.¹⁴ Në këtë kontekst, hipotezat kryesore të studimit fokusohen në:

- a. Karakteristikat e identitetit,
- b. Identiteti personal dhe shoqëror në kontekstin e globalizimit kulturor, rreziqet dhe mundësitë,
- c. Gjermania është apo jo vend emigracioni.

Asnjëherë më parë njerëzimi nuk ka qenë në lëvizje sikur tani në kohën e globalizimit. Pa marrë parasysh se nga cili vend vijnë apo në cilin vend jetojnë, migrimi është në rritje e sipër. Shtresat sociale janë të dukshme në grupet e migrantëve, njëherit edhe diversiteti i tyre kulturor është i pashëm.¹⁵ Gjithë kjo ndikon që të ketë një shoqëri pluraliste, multikulturore dhe multietnike. Tema „*Identiteti i migrantit shqiptar dhe integrimi i tij në Gjermani, me theks të veçantë në qytetin e Leverkusenit*“ ka një soditje të bazuar në dy premisa:

1. Nga njëra anë identiteti konstruktohet, ndërtohet mbi baza të proceseve diferencuese.
2. Nga ana tjetër identiteti ndërtohet mbi baza të ndërsjellta, reciproke.¹⁶

Duke marrë parasysh faktin se boshti kryesor i kësaj teme është identiteti i migrantit shqiptar në Gjermani, hipotezat kryesore janë:

1. Identifikimi i migrantit shqiptar me kulturën kombëtare,
2. Identifikimi i migrantit shqiptar me kulturën gjermane,
3. Identifikimi i migrantit shqiptar me kulturën fetare.

2. Mënyra e hulumtimit dhe metodologjia e studimit

Tema „*Identiteti i migrantit shqiptar dhe integrimi i tij në Gjermani, me theks të veçantë në qytetin e Leverkusenit*“ ka për qëllim të hulumtoj shkaqet të cilat ndikojnë në procesin e zhvillimit, formimit të identitetit si dhe shkaqet të cilat çojnë në shkrirjen apo humbjen e identitetit gjatë proceseve të integritit të migrantëve në Gjermani. Bazë metodologjike e këtij hulumtimi është qasja që ndërlidhet me identitetin kombëtar dhe fetar të migrantëve shqiptarë. Qasja në fjalë merr parasysh kontekstet e brendshme si dhe ato ndërkombëtare, ndryshimet e gjata kohore dhe krahasimet historike.¹⁷ Shoqëritë ndikohen nga ndryshimet radikale që dominojnë në sferat shoqërore, ekonomike, politike, shkencore,

¹⁴ Krasniqi, Milazim, *Shtresimet e Identitetit Kulturor Kombëtar Shqiptar*, Zëri ynë, Prishtinë, 2003, fq. 58.

¹⁵ Hartmut, Wagner, *Bezugspunkte europäischer Identität*, LIT Verlag, Münster, 2006, fq. 22.

¹⁶ Regine, Penitsch, *Migration und Identität*, Weißensee Verlag, Berlin, 2003, fq. 16.

¹⁷ Ukshini, Sylë, *Kosova në politikën e jashtme të BE-së 1991-2007*, Logos-A, Shkup, 2008, fq. 31.

teknologjike, ideologjike, ekologjike, etj. Nga modernizmi lind postmodernizmi, nga konkurrenca ideologjike mes kapitalizmit dhe socializmit lind globalizmi.¹⁸ Migrantët të ballafaquar me këto ndryshime rapide duhet të tregojnë maturi, vetëmohim dhe sakrificë për të mos refuzuar proceset integruese dhe mbrojtjen me lehtësi të identitetit të tyre në tregun global.

Gjatë këtij hulumtimi:

- a. Vështrohen korelacionet teorike të identitetit dhe migracionit si sfond i hulumtimit,
- b. Analizohen, interpretohen, komentohen të gjitha dukuritë ndikuese në process,
- c. Hulumtohen gjeneratat në kërkimin e elementeve të përbashkëta të mbrojtjes dhe zhvillimit të identitetit,
- d. Analizohen kualitetet jetësore,
- e. Hulumtohen fazat e migrimit,
- f. Analizohen shkaqet e migrimit të migrantëve shqiptarë,
- g. Analizohen se si u ballafaquan migrantët me mjedisin e ri.

Hulumtimi për të qenë i dobishëm ai duhet të analizohet. Analizimi duhet të përfshijë saktësinë dhe qëndrueshmërinë e informatave. Jo gjithëherë informatat e marra përmes teknikave hulumtuese janë valide dhe të sigurta. Validiteti dhe siguria e tyre nvarret nga analizimi dhe interpretimi i rezultateve. Validiteti përfshinë fushën përmbajtësore, sipërfaqësore dhe dalluese të informatave. Interpretimi i rezultateve paraqitet ndaras, duke i ndërlidhur analizat me pyetjet përkatëse të pyetësorit dhe hipotezat. Metodologjia e punimit të temës bazohet në hulumtimin e të gjithë dokumentacionit, raporteve dhe anketave të zhvilluara gjatë procesit. Përveç hulumtimit të raporteve dhe bisedave, kjo pjesë bazohet edhe në një grup intervistash të zhvilluara me kategori të moshave të ndryshme, gjinive dhe trojeve etnike shqiptare nga vijnë migrantët shqiptarë në qytetin e Leverkusenit.

Në këtë studim paraqiten edhe të dhëna të aktiviteteve kulturore dhe fetare të arkivuara në shoqatat kulturore dhe fetare të migrantëve shqiptarë në qytetin e Leverkusenit gjatë periudhave të ndryshme, të cilat reflektojnë me rezultatete reale mbi temën “ Identiteti i migrantit shqiptar dhe integrimi i tij në Gjermani, me theks të veçantë në qytetin e Leverkusenit ”

¹⁸ Prah, Hans-Werner, *Sociologie der Freizeit*, Ferdinand Schöningh, Paderborn, 2002, fq. 35.

3. Metodatat e përdorura

- a. Observacioni,
- b. Metoda statistikore,
- c. Eksperimenti ,
- d. Intervista,
- e. Anketa,
- f. Metoda sociometrike,
- g. Metoda demografike,
- h. Metoda komparative.

Metoda e anketimit është përqendruar në konkluzione precize me qëllim të fitimit të përgjigjeve koncize. Shkaqet bazë të migrimit të shqiptarëve janë rrethanat socio-politike, duke qenë kështu vështirë është të gjendet një metodë e saktë, për arsye se një pjesë e migrantëve shqiptarë në Leverkusen të Gjermanisë përpiqen të anashkalojnë shkaqet socio-politike të migrimit. Ata disi nuk duan të identifikohen me të kaluarën e tyre. Përdorimi i këtyre metodave ka mundësuar që gjatë anketimit apo intervistimit të ketë edhe pyetje shpesh për precizimin e konkluzioneve në mënyrë që të jepet një përgjigje sa më precize. Si është mbrojtur identiteti gjatë proceseve të migrimit, sillen shembuj nga grupe të ndryshme migrantësh të cilët në fillim të viteve 70-ta migruan për shkaqe të ndryshme socio-politike. Nga ana tjetër shpalosen ndjenjat dhe faktorët projektues të vazhdimsisë së identitetit të të parëve, duke pasur parasysh edhe ndikimet e dispozitave ligjore si ndikues në faktorët projektues. Në mënyrë që të ketë besueshmëri dhe korelacion ndaj faktorëve projektues të identitetit, në këtë punim paraqiten karakteristikat e ndërlikohjes së migrantëve shqiptarë me atdheun e tyre dhe ndërlikohjet e tyre me vendin në të cilin jetojnë, (në këtë rast me Gjermaninë), si dhe aspiratat e tyre që të jenë pjesë e Europës së bashkuar.

Migrimi njëherit është edhe një konflikt me vetveten për vendimarrje¹⁹ ndërmjet ballafaqimeve multikulturore duke mos humbur privilegjin e kulturës personale për jetesë të përbashkët. Përmes këtij hulumtimi migranti vërteton se qenia e identitetit është shumë komplekse. Çdo migrant në Leverkusen i ka specifikat, veçoritë dhe karakteristikat e veta të cilat janë të ndryshme nga specifikat, veçoritë dhe karakteristikat e migrantit shqiptar. Identiteti i migrantit shqiptar a rrezikohet me zhbërje apo përkundrazi ngritet dhe ndërtohet edhe më fuqishëm, përmes këtij punimi paraqitet në formë të dilemave duke analizuar se a mundet që migranti shqiptar të ndërrojë identitetin e tij etnik, gjuhësor, kulturor, dhe religjioz.

¹⁹ Regine, Penitsch, *Migration und Identität*, Weißensee Verlag, Berlin, 2003, fq. 18.

Duke marrë parasysh pozitën e migrantëve shqiptarë në qytetin e Leverkusenit hulumtohet se migrantët shqiptarë, a ndjehen në pozitë të pafavorshme dhe të diskriminuar shkakut i identitetit të tyre dhe ata a ngjasojnë me një person „tipik gjerman“. Që të jetë studimi më i tërësishëm dhe më gjithëpërfshirës të anketuarit kanë mundësinë që të përshkruajnë veten dhe identitetin e tyre përmes veçorive në vijim:

- a. Sjellja e migrantëve ndaj gjuhës dhe kulturës së tyre,
- b. Përpjekja e migrantëve për të fshehur identitetin e tyre,
- c. Kontakti i migrantëve me vendin e origjinës,
- d. Simptomët e një identiteti të dyfishtë,
- e. Janë apo jo migrantët shqiptarë në Leverkusen në pozitë të favorshme,
- f. Ndjehen apo jo të huaj migrantët shqiptarë në Leverkusen të Gjermanisë.

Për çdo veçori të potencuar, të anketuarit kanë kërkuar sqarime dhe definime precize për të krahasuar të kundërtën, njëkohësisht përmes kësaj metodologjie është mundësuar anulimi i anketave të cinguara. Anketat dhe intervistat janë realizuar brenda intervalit kohor qershor 2011 deri shtator 2011 në qytetin e Leverkusenit me rrethinë. Rezultatet e të dhënave paraqiten dhe analizohen përmes grafikëve dhe tabelave përshkruese.

Kapitulli I.

SFONDI TEORIK I IDENTITETIT TË MIGRANTIT NË LEVERKUSEN TË GJERMANISË

1. Teoritë klasike për identitetin

Në leksikone dhe enciklopedi botërore teoria e identitetit përceptohet me definicione të gjeneralizuara, me domethënie dhe sqarime shkencore. Duke iu referuar amerikanit Erik Erikson shihet se ai nocionin e identitetit e përdorë më gjërë në shkencat shoqërore dhe arrin të bëj ndryshime radikale në shoqëritë perëndimore.²⁰ Mendimtarët para Sokratit si Herakliti janë preokupuar rreth termit identitet, janë ndjekur pastaj edhe nga Aristoteli, Kanti, Hegeli, etj, të cilët për diskursin mbi vetënjohjen bëjnë përpjekjet e para që bëhen në këtë fushë. Në sociologjinë perëndimore identiteti njihet si një filozofi e Hegelit i cili në periudhë kohore ndërmjet viteve 1801-1806 polemizon me Shelingun duke shqyrtuar problemin e natyrës dhe shpirtit duke i konsideruar ato si një njësi e poleve të realitetit të njëjtë.²¹ Shelingu ka konceptin e vet për identitetin e natyrës dhe shpirtit dhe këtë të vërtetë e përshkruan gjithmonë si “sistem i identitetit absolut”, ky përshkrim kritikohet nga Hegeli²².

Tim Edensor mendon se: identiteti është gjithnjë në proces, dhe i rikonstruar në një proces të varur nga konteksti lokal, social, material, kohor dhe hapësinor. Ndryshueshmëria e identitetit s’do të thotë se aty s’ka koherencë, kjo do të thotë se kjo duhet vazhdimisht të riafirmohet për të qenë i qëndrueshëm.²³ Anthony Smith mendon se etnitë janë pjesë përbërëse të kombit dhe të dyja janë në një ndërvarësi. Tiparet dalluese të kombit prej etnisë janë kultura e përbashkët publike e masës, ekonomia e përbashkët dhe sidomos të drejtat dhe obligimet ligjore për të gjithë pjesëtarët.²⁴ Antony Smith në librin „Identiteti kombëtar“ shqyrton çështjen e identitetit në spektër më të gjërë. Ai precizon se identiteti, qoftë individual ose kolektiv gjithmonë është rezultat i ndryshueshmërisë dhe dallueshmërisë karshi tjerëve. Sipas Smithit identitetin e një personi apo grupi e formësojnë tri kategori:

1. Kategoria gjinore. Kriteri biologjik i identitetit diferencon individin në aspektin gjinor dhe është i përcaktuar. Çështja e përcaktimit të gjinisë së fëmiut që nga kohët e lashta

²⁰ scribd.com, Baliqi, Bekim, *Teoritë mbi Identitetin kombëtar dhe shtetëror*, (23.12.2011).

²¹ textlog.de, *Prinzip der Identität als Prinzip des Systems Schellings*, (23.12.2011).

²² Po aty.

²³ Baliqi, *Teoritë mbi Identitetin kombëtar dhe shtetëror*, (23.12.2011).

²⁴ Po aty.

ka preokupuar njeriun. Mbetet trajtesë bashkëkohore që identiteti në bazë të këtij kriteri është apo jo i ndryshueshëm.

2. Kategoria territoriale. Kriteri gjeografik bazohet në kufijtë lokal dhe regjional, identiteti në bazë të këtij kriteri është i ndryshueshëm.
3. Kategoria klasore, kriteri social. Smith duke klasifikuar identitetin në klasa shoqërore sqaron se nuk nënkupton „klasën“ në kuptimin klasik të Marxit dhe Weberit. Ai thekson se përveç aspektit ekonomik që është i rëndësishëm, hyjnë edhe elementet tjera si vendi, tradita, etj. Në bazë të këtij kriteri klasat shoqërore përkufizojnë marrëdhëniet brenda shoqërore dhe mund të ekzistojnë disa klasa në konkurrencë njëra me tjetrën.²⁵

Identiteti në përgjithësi është një pronë private si: emri, mosha, gjinia, profesioni, përkatësia si dhe kategorizimi.²⁶ Sociologët gjithashtu parashohin aspekte të veçanta të identitetit si; strukturat e personalitetit individual dhe vetënjohja. Në konceptet e veta Bosma parasheh dy vetëpërpjekje të njeriut ndaj identitetit të tij:

1. Njohja e vetvetes,
2. Formësimi dhe ndërtimi i vetvetes.

Vetëkoncepti është tejet ndikues gjatë formimit të identitetit. Në komponentët kognitiv, emocional dhe motivues, Hurrelmann përshkruan vetëkonceptin si tërësi të imagjinatës.²⁷ Ndjenjat religjioze janë poashtu një realitet tjetër i natyrshëm i njeriut që nga lindja e tij. Njeriu në instiktin e tij, siç thotë Ernest Renana në librin e tij “Historia e feve“, orvatet të ngritet mbi botën e materies që të plotësojë nevojat e tij shpirtërore dhe intuitive. Anthony Smith sqaron identitetin religjioz, ai merr shembull rastin e kishës mesjetare në Europë, e cila predikonte për klasa të veçanta dhe në gjuhën latine si gjuhë zyrtare e kishës. Sipas Smithit identiteti religjioz dhe etnik duke qenë në lidhje kauzale kanë rëndësi të veçantë dhe janë faktorë kyç për përcaktimin e identitetit.²⁸

2. Koncepti i identitetit etnik

Autorë të shumtë kanë debatuar rreth perspektivave, definicioneve dhe operacionalizimeve të këtij termi. Të gjithë s’janë të njëjtit mendim kur ka të bëjë me

²⁵ scribd.com, Baliqi, Bekim, *Historia dhe Identiteti*, (24.12.2011).

²⁶ Radchenko, Tatjana, *Bedeutung endogener und gesellschaftlicher Faktoren für die Identität eingebürgerter Migranten*, Universität zu Köln, Köln, 2009, fq.15.

²⁷ Po aty.

²⁸ Baliqi, *Historia dhe Identiteti*, (25.12.2011).

definimin e këtij termi. Një grup autorësh janë të mendimit se termi identiteti etnik është sinonim i termit identiteti racor. Për sociologjinë bashkëkohore nuk ekziston një koncept i qartë i identitetit. Ky term duke u përdorur lirshëm ka për qëllim emërtimin e sensit mbi vetveten, ndjenjat apo idetë mbi vetveten.²⁹ Anthony Giddens etninë e definon me praktikat dhe botëkuptimet kulturore që dallojnë një komunitet të caktuar njerëzish. Për të dalluar grupet etnike nga njëri-tjetri mund të shërbejnë karakteristika të ndryshme, por më kryesoret janë gjuha, historia ose prejardhja (e vërtetë apo e imagjinuar), feja dhe mënyrat e veshjes ose zbukurimeve.³⁰ Ndryshimet fizike në ngjyrën e lëkurës dhe në karakteristikat tjera shpesh quhen raciale. Ndryshimet raciale duhet të kuptohen si ndryshueshmëri fizike që anëtarët e një komuniteti ose shoqërie i konsiderojnë etnikisht të veçanta.³¹

Frable³² diferencon ndërmjet këtyre dy termeve duke përdorur racën në kontekstin e pamjes fizike të individit dhe etnitetin për ndryshim nga karakteristikat kulturore të individit si origjina, gjuha, apo religjioni.³³ Ky term nganjëherë edhe politizohet por edhe instrumentalizohet për qëllime të pa definuara, qëllime këto të cilat mund të prodhojnë kriza, probleme dhe konflikte. Mbetet detyrë dhe punë e sociologëve që të trajtojnë në mënyrë të qartë objektivat dhe reflektimet e këtij termi.³⁴ Duke iu referuar fjalorit sociologjik të Gordon Marshallit sheh se nocioni i identitetit në aspektin historik është i vonshëm. Ndonëse termi „identitet“ ka një histori të gjatë me prejardhje nga rrënja latine idem, çka nënkupton njëjtësi dhe vazhdimësi, përdorimi i tij merr përhapje jo më herët sesa shekulli XX. Tradita sociologjike e teorisë së identitetit lidhet me „ndërveprimin simbolik dhe buron nga teoria pragmatiste mbi vetveten, e përpunuar nga William James dhe George Herbert Mead.³⁵

Pyetjet kryesore rreth identitetit etnik të migrantëve shqiptarë në Leverkusen janë; Kush jam unë? Cili është kombi im? A kam unë atdhe? Cila është gjuha ime? A kam unë kulturën time etnike? Këto janë pyetje përmes së cilave ndërtohet identiteti individual. Identiteti kolektiv formësohet kur këto pyetje shndërrohen në shumës duke thënë; Kush jemi ne? Cili është kombi ynë? Cila është gjuha jonë? A kemi ne kulturën tonë etnike? Duke u bazuar në këto pyetje, vjen në përfundim se koncepti i identitetit të migrantëve shqiptarë në

²⁹ Marshall, *Fjalor Sociologjik i Oksfordit*, fq. 145.

³⁰ Giddens, Anthony, *Sociologjia*, Çabej, Tiranë, 2007, fq. 248.

³¹ Po aty, fq. 250.

³² Radchenko, *Bedeutung endogener und gesellschaftlicher Faktoren für die Identität eingebürgerter Migranten*, fq. 16.

³³ Po aty.

³⁴ Baliqi, *Teoritë mbi Identitetin kombëtar dhe shtetëror*, (26.12.2011).

³⁵ Marshall, *Fjalor Sociologjik i Oksfordit*, fq. 144.

Leverkusen është individual dhe kolektiv. William James dhe George Herbert Mead analizojnë vetveten përmes proceseve „Unë“ dhe „Mua“. Procesi „Unë“ paraqet momentin njohës, të brendshëm, subjektiv, krijues, përcaktues dhe të panjohur. Procesi „Mua“ më së tepërmi është momenti i njohur, i jashtëm, i përcaktuar dhe social.³⁶ Identiteti individual merr kuptim kur është në përputhshmëri me identitetin e caktuar social. Individidi nuk mund të formojë identitet të vetin personal të jetë i pavarur tërësisht nga rrethi shoqëror dhe shoqëria. Sociologu Stuart Hall pohon se identitetet janë emra që u jepen çështjeve të ndryshme për të cilat merret një qëndrim dhe ky qëndrim vjen si pasojë e narracionit të së kaluarës.³⁷

Identiteti personal në bazë të këtyre kriterëve është i ndikuar në masë të konsiderueshme nga shoqëria dhe kultura e cila na rrethon. Sipas Richard Jenkis, identiteti i referohet mënyrës në të cilën individët sikurse dhe kolektivet janë të diferencuara në marrëdhëniet shoqërore me individët dhe kolektivet tjera.³⁸ Identiteti individual përkufizohet si ndjenja e të qenurit unik dhe i veçantë.³⁹ Max Weberi identitetin e karakterizon si një lidhshmëri e një grupi social që ka ndjenja të përbashkëta (Zusammengehörigkeitsgefühl). Dallimet mbi raca njerëzore veçohen në bazë të ngjyrës së lëkurës por edhe përmes vetive biologjike e gjenetike si gjaku, gjenet, etj.⁴⁰ Mund të thuhet se lloji njerëzor ndahet në tri raca të pastra kryesore:

1. Raca e bardhë: Përfaqëson bukurinë, mendimin dhe fuqinë. Të gjitha lëvizjet dhe pasuritë kulturore në histori për të cilat dihet, si psh. kulturat si ajo indiane, egjiptiane, asiriane, greke, romake dhe zhermene, janë vepër e kesaj race.
2. Raca e verdhë: Mund të thuhet se zotëron forcë, kurse si forcë mendore konsiderohet mesatare. Karakteristika kryesore e saj është të vrapuarit pas përfitimit material.
3. Raca e zezë: Në aspekt të dëshirës vullnetit dhe forcës është e dobët; dallon nga te tjerët me talentin për art.⁴¹

Edhe faktorët ekonomik, socio-politik, kulturor, historik, etj. janë me ndikim në formimin e identitetit. Shoqëria e përbërë dhe e ndarë në klasa dhe shtresa faktori apo elementi ekonomik ka rëndësi të veçantë. Kultura duke trasuar vlerat shpirtërore dhe materiale të individit dhe kolektivit ka poashtu rëndësi të theksuar.⁴² Erving Goffman dhe Peter Berger

³⁶ Po aty.

³⁷ Baliqi, *Teoritë mbi Identitetin kombëtar dhe shtetëror*, (26.12.2011).

³⁸ Po aty.

³⁹ Böhm Dietmar, Böhm Regine & Deiss-Niethammer Birgit, *Handbuch Interkulturelles Lernen*, fq. 85.

⁴⁰ Baliqi, *Teoritë mbi Identitetin kombëtar dhe shtetëror*, (26.12.2011).

⁴¹ Bullaç, Ali, *Historia, shoqëria dhe tradita*, Logos-A, Shkup, 2003, fq. 79.

⁴² Baliqi, *Teoritë mbi Identitetin kombëtar dhe shtetëror*, (26.12.2011).

identitetin e cilësojnë si „i mbjellë nga shoqëria, i ruajtur nga shoqëria dhe i transformuar nga shoqëria“⁴³. Për individin dhe kolektivin elementet sentimentale dhe emocionale poashtu janë faktorë me ndikim të rëndësishëm në formimin dhe mbijetesën e identitetit.⁴⁴ Periudha e fëmijërisë duke qenë tejet e ndieshme dhe sentimentale duhet kushtuar kujdes të veçantë për të zgjuar emocionet e tyre dhe për të zhvilluar këtë cilësi. Në fjalorin e gjuhës shqipe, identiteti është definuar si vijon: „Të qenët i veçantë nga të tjerët dhe i njëjtë vetëm me vetveten në disa veçori e tipare që shërbejnë për t’u njohur pa vështirësi si i tillë, të qenët po ai. Identiteti i njeriut (i personit). Dokument (letër, kartë) identiteti dokument, ku janë shënuar tiparet dalluese të një njeriu dhe që shërben për të vërtetuar se është ai vetë“⁴⁵.

3. Dimensionet e identitetit etnik

Gjermanët si element kryesor në komponentët e identitetit etnik parashohin lidhjen e gjakut, historisë, gjuhës dhe kulturës, për dallim nga francezët të cilët në komponentët kryesor të identitetit etnik parashohin përcaktimin individual. Në rastin e parë del se individi është ai që duhet të pranojë identitetin e tij etnik, ndërsa në rastin e dytë del se individi është i lirë në zgjedhjen e identitetit të tij. Bazuar në komponentët e sipërpërmendura identiteti etnik sipas hulumtimeve të Phinney⁴⁶ përmban katër dimensione themelore;

1. Vetë identifikimi etnik. Aspekti qendror i dimensionit të vetë identifikimit etnik përqëndrohet në atë se si individi përshkruan vetveten.
2. Ndjenjat e përkatësisë. Ky dimension përkufizon fuqinë emocionale të ndjenjave të përkatësisë së individit.
3. Komponenti afektiv. Përmes këtij dimensionit individi ka anën emocionale të vlerësimeve pozitive dhe negative.
4. Solidarizimi. Edhe solidarizimi i individit me anëtarët e të njëjtit etnit është një dimension i rëndësishëm.⁴⁷

⁴³ Marshall, *Fjalor Sociologjik i Oksfordit*, fq. 144.

⁴⁴ Baliqi, *Teoritë mbi Identitetin kombëtar dhe shtetëror*, (26.12.2011)

⁴⁵ *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe*, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë-Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë Tiranë, 1984, fq. 44.

⁴⁶ Radchenko, *Bedeutung endogener und gesellschaftlicher Faktoren für die Identität eingebürgerter Migranten*, fq. 16.

⁴⁷ Po aty.

Te migrantët shqiptarë indikatorët tradicional si gjuha, religjioni, veshja tipike, mënyra e banimit dhe ushqimit si dhe forma e organizimit familjar, ndikojnë dukshëm në përcaktimin e dimensioneve të identitetit etnik.

4. Akulturalizimi dhe identiteti etnik

Akulturalizimi në aspektin etnologjik nënkupton ndikimin reciprok apo të njëanshëm të përafrimit të kulturave me prejardhje të ndryshme, për shkak të kontakteve të ngushta si proces i transmetimit të elementeve kulturore nga një kulturë në tjetrën. Studime të detajuara evropiane për qytetari në kohën e globalizimit përqëndrohen në fushën e adaptimit të kulturave të veçanta, në kulturën dominante, ndryshe kjo njihet si asimilim.⁴⁸ Termi akulturim i referohet ritjes graduale të individit në ambientin e tij kulturor përmes edukimit gjatë fazës së adoleshencës, ana tjetër është socializimi i pakontrolluar.⁴⁹ Socializim quhet procesi i përvetësimit të normave shoqërore të grupit nga ana e individit të caktuar, ai paraqet dukurinë e aftësimit të individit për të jetuar bashkë me njerëzit tjerë në shoqëri.⁵⁰ Sipas John W. Berry dallojnë strategjitë e akulturalizimit.⁵¹

Akulturalizimi ka një ndërlidhje komplekse dhe shumë dimensionale me identitetin etnik, bashkëveprimi mes tyre është i vështirë, për të mos thënë i pamundur dhe shikohen të izoluar nga njëri tjetri. Akulturalizimi kuptohet edhe si koncept i gjërë i cili ndryshon në aspektin e sjelljeve, qëndrimeve, vlerave, etj.⁵² Redfield akulturim ka quajtur fenomenet që ndodhin kur grupe të individëve me kultura të ndryshme vijnë në kontakt të vazhdueshëm me ndryshimet e mëvonshme në kulturën e tyre origjinale.⁵³ Kjo mund të shihet në të dy grupet. Anëtarët e vendit pritës ankohen nga ndikimet të cilat shfaqen në mesin e shoqërive të tyre si rezultat i sjelljeve dhe fjalorit të migrantëve. Kjo më së shumti vërehet nëpër shkolla kur adoleshentët fillojnë të imitojnë shokët e tyre nga rradhët e migrantëve.

Akulturimi si pjesë e identitetit etnik është i rëndësishëm kur migrantët në bashkëveprim me një kulturë të re, të huaj, si ndjehen ndaj përkatësisë etnike dhe si sillen ndaj kulturës së vendit pritës. Migrantët për sa i takon procesit të akulturalizimit diametrisht

⁴⁸ Penitsch, *Migration und Identität*, fq. 16.

⁴⁹ Fuchs-Heinritz, Werner, *Lexikon zur Soziologie*, VS Verlag, Wiesbaden, 2011, fq. 22.

⁵⁰ Raimi, Sunaj, “*Sociologjia*”, Kosta Abras-Ohër, 2009, fq. 223

⁵¹ socialnet.de, Familie, *Akkulturation und Erziehung*, (28.12.2011).

⁵² Penitsch, *Migration und Identität*, fq. 18.

⁵³ Radchenko, *Bedeutung endogener und gesellschaftlicher Faktoren für die Identität eingebürgerter Migranten*, fq. 19.

kanë pozicione të kundërta. Ka të tillë që janë ksenocentrist (edhe pse pak në numër) të cilët akulturalizimin e konsiderojnë si rrugë të vetme të integritit suksesiv dhe të shpejtë. Të tillët duke menduar se përmes akulturalizimit u integruan, çalojnë gjatë procesit të akulturalizimit ndaj identitetit fetar. Një pjesë tjetër e migrantëve kanë marrë një mënyrë jetese të ngjashme me të vendit pritës, por megjithatë ende shumë identifikohen me kulturën e origjinës. Gjatë proceseve integruese tek migranti paraqiten dy çështje bazike „identiteti dhe shtetësia“. Migranti shqiptar e di mirë se identiteti etnik lind me lindjen e individit dhe nuk fitohet më vonë, ndërsa shtetësia është dokument administrativ që jepet dhe merret më vonë gjatë jetës.

Prof. Dr. Martin Berisha pedagog i antropologjisë politike në simpoziumin „identiteti dhe shtetësia“ të organizuar në Tiranë do të pyesë: A është Europa „kazan i shkrirjes së identiteteve kombëtare“.⁵⁴ Politologu Reiz Mulita mendon se përmes proceseve të integritit europian nuk zbehen tiparet dalluese të kombit, tradita, kultura, dhe në përgjithësi sjelljet sociale. Ai thotë: „Integrimi në BE parakupton pranimin e tjetrit, të atij që ka një identitet kombëtar të ndryshëm nga i yti, marrjen në konsideratë të traditave, simboleve të çdo grupimi shoqëror si burim bashkëjetese, si burim këmbimi vlerash“.⁵⁵ Të gjithë sociologët dhe politologët nuk ndajnë këtë mendim, një grup i sociologëve pohojnë se përmes proceseve integruese zbehet identiteti kombëtar dhe etnik.

⁵⁴ dw-world.de, *Identiteti në Ballkan*, (29.12.2011).

⁵⁵ Po aty.

Kapitulli II.

IDENTITETI I MIGRANTËVE SHQIPTARË NË LEVERKUSEN TË GJERMANISË

1. Identiteti nacional dhe migracioni

Migrantët në vendin pritës i tejkalojnë kufijt nacional dhe përballen me një tjetër nacionalitet. Tërësia e identitetit të migrantit në këtë mjedis të ri prezantohet përmes një dokumenti që mban emrin pasaportë. Ky dokument për një pjesë të madhe të shqiptarëve është i ndërtuar në bazë të marrëveshjeve dhe kompromiseve politike dhe si i tillë e ka të vështirë që njëkohësisht të prezantojë shtetësinë dhe identitetin nacional. Si bartës të pasaportës maqedone, malazeze dhe serbe janë edhe migrantët shqiptarë në Leverkusen të Gjermanisë. Tani lind pyetja, pse diskutohet aq shumë lidhur me migrimin në aspekt me identitetin nacional?⁵⁶ Konceptet nacionale dhe shtetësia, rëndësia individuale dhe kolektive e kombësisë, shtetësia dhe përkatësia etnike, zhvillimi i të drejtës ligjore për fitimin e shtetësisë së re, dy shtetësia apo shtetësia e shumëfishtë⁵⁷, janë lidhshmëritë kryesore të migrantëve shqiptarë me identitetin e tyre nacional.

Shteti është nocioni më i diskutueshëm në shkencat shoqërore. Ai si fenomen është studiuar nga më shumë disiplina, si: filozofia, sociologjia, ekonomia politike, drejtësia, shkencat politike, etj.⁵⁸ Ndonëse mund të haset në terminologji të shumta ndërkombëtare për shtetin, në praktikën e gjuhës angleze më të përfolur janë termat „state“, „nation“, dhe „country“. Këta terma janë të ngjashëm me emërtimet për shtetin në gjuhën shqipe.⁵⁹ Për të kuptuar më mirë këtë çështje është e arsyeshme të shpjegohet domethënia e termit „nacion“ dhe „komb“. Termi „nacion“ rrjedh nga fjala latine „natio“ që ka kuptimin e „fisit“ dhe „gjinisë“.⁶⁰ Më vonë ky term merr edhe kuptime tjera si; prejardhje, çertifikatë të lindjes. Sipas një teorie, termi „komb“ buron nga gjuha arabe „khaum“⁶¹ që ka kuptimin e „fisit“ apo bashkësinë e „gjakut“.

Dallohen tri lloj definimesh mbi kombin:

1. Definimi filozofik,

⁵⁶ Penitsch, *Migration und Identität*, fq. 17.

⁵⁷ Heckmann, Friedrich, *Ethnic Minderheit, Volk und Nation*, Enke Verlag, Stuttgart, 1992, fq. 200.

⁵⁸ Reka, Blerim, *Kushtetuta e UE-Rubikoni i Supranacionales*, Logos-A, Shkup, 2007, fq. 23.

⁵⁹ Po aty, fq. 23.

⁶⁰ Baliqi, *Teoritë mbi Identitetin kombëtar dhe shtetëror*, (27.12.2011).

⁶¹ Po aty.

2. Definimi politik,
3. Definimi ideologjik.⁶²

Definimin filozofik Immanuel Kant e shpjegon duke marrë parasysh dy tipare kryesore, bashkësinë qytetare të njerëzve dhe prejardhjen e tyre. Me fjalën popullore sipas Kantit nënkuptohet, „masa e bashkuar e njerëzve, përderisa ata e përbëjnë një të përbashkët. Ajo masë ose edhe pjesa e saj, e cila përmes prejardhjes së përbashkët e një veten të bashkuar në një të tërë qytetare, quhet komb“⁶². Benedict Anderson në kuptimin politik e definon kombin si bashkësi politike e përfytyruar, e kufizuar dhe sovrane. Ai është i përfytyruar për shkak se anëtarët edhe të vet kombit më të vogël nuk i njohin shumicën e anëtarëve tjerë, nuk i takojnë kurrë ata ose nuk dëgjojnë kurrë për ta, por në kohën e secilit ekziston, përfytyrohet bashkësi e tyre“.

Të parët që definuan kombin në kuptimin ideologjik janë marksistët. Marksizmi nuk ka një unitet rreth përshkrimit të kombit në kuptimin ideologjik. Marksisi dhe Engelsi duke vënë primatin mbi klasoren para kombëtares, preferuan një formulim fatal për pasuesit e tyre rreth çështjes kombëtare. Komunistët qortohen se duan të zhdukin atdheun dhe kombësinë. Punëtorët s'kanë atdhe, nuk mund t'u heqësh atyre një gjë që nuk e kanë. I këtij mendimi nuk është Lenini dhe Stalini. I pari, Lenini e formulon kombin duke u angazhuar për precizimin e të drejtës së kombeve për vetëvendosje deri në shkëputje, ndërkaq i dyti, Stalini e definon kombin si një bashkësi e qëndrueshme njerëzish, e formuar historikisht, që ka lindur në bazë të bashkësisë së gjuhës, territorit, të jetës ekonomike dhe të formimit psikik, që shfaqet në bashkësinë e kulturës.⁶³ Këtij definimi të Stalinit mbi kombin i përmbahet edhe fjalori i gjuhës së sotme shqipe i cili termin „komb“ e shpjegon në këtë mënyrë; Bashkësi e qëndrueshme njerëzish, e formuar historikisht në bazë të bashkësisë së gjuhës, të territorit, të jetës ekonomike dhe të formimit psikik që shfaqet në bashkësinë e kulturës.⁶⁴

Përcaktimi i migrantëve nga vendi pritës me termat „Gastarbeiter“ (punëtor i huaj), dhe „Fremde“ (të huaj) kah fundi i viteve 80'ta konsiderohet i marginalizuar, kështu që bëhen përpjekje për gjetjen e termave më të përshtatshëm si „ausländische Mitbürger“ (bashkqytetar të huaj) dhe „Zuwanderer“ si dhe „Einwanderer“ (emigrant dhe imigrant). Gjermania duke patur nevojë të madhe për krahun e punës deri në vitet 1970 përgjithësisht ka pasur qëndrim mbështetës për imigrimin dhe ka kërkuar punëtor për të plotësuar kuotat.⁶⁵ Këta individë duke

⁶² beepworld.de, *Nocioni i Kombit*, (25.01.2012)

⁶³ Po aty.

⁶⁴ *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë, 1984, fq. 536.

⁶⁵ Huntigton, Samuel, *Përplasja e qytetërimeve dhe ribërja e rendit botëror*, Logos-A, Shkup, 2009, fq. 227.

u larguar nga atdheu i tyre për të punuar në Gjermani asaj kohe quheshin „Gastarbeiter“. Njerëzit që lënë individualisht ose në grupe vendet e tyre të përhershme dhe vendosen në vende tjera, të paktën për një kohë të gjatë, janë të referuar si imigrant, (mbeten brenda shtetit). Njerëzit që lënë vendet e tyre vullnetarisht apo me dhunë për motive ekonomike, fetare, politike, etj. referohen si emigrant, (dalin jashtë shtetit).⁶⁶ Fjalori i gjuhës së sotme shqipe termin emigrim e definon në këtë mënyrë; „Ai që është larguar nga atdheu i vet për shkaqe politike, ekonomike etj. dhe është vendosur përkohësisht a përgjithmonë në një vend të huaj.⁶⁷ Migrimi shpjegohet edhe në këtë mënyrë:

1. Migrim i brendshëm dhe migrim ndërkombëtar

Migrimi i brendshëm është lëvizja brenda të njëjtit vend, nga një njësi administrative në një tjetër; si p.sh. brenda rajonit, provincës, bashkisë etj. Ndërsa migrimi ndërkombëtar përfshinë kalimin e një apo disa kufijve ndërkombëtarë që çojnë në ndryshimin e statusit të individit në fjalë.⁶⁸ Migrant është një person i cili në mënyrë vullnetare dhe për arsye personale lëviz nga vendi i tij i origjinës në një destinacion të posaçëm pa u detyruar për të bërë një gjë të tillë. Përkufizimi vë theksin tek natyra vullnetare e lëvizjes, si kriter kryesor. Këtu përfshihen edhe personat që lëvizin në mënyrë të rregullt dhe të parregullt, edhe ata që nuk kanë dokumentacionin e nevojshëm si vizë, leje qëndrimi apo leje pune. Migranti mund të jetë imigrant ose emigrant. Për shtetin e origjinës ai konsiderohet si emigrant ndërsa në shtetin pritës ai quhet imigrant.

2. Migrim i detyruar

Migrimi i detyruar është lëvizja jovullnetare e një personi me qëllim që të largohet nga një konflikt i armatosur, një situatë dhune apo dhunimi i të drejtave personale, një katastrofë natyrore apo ngjarje tjetër shkaktuar nga njerëzimi. Ky term përdoret edhe për lëvizjet e refugjatëve dhe shkëmbimet e detyruara të popullsive midis shteteve.⁶⁹

3. Migrant ekonomik

Migrant ekonomik është një person që largohet për t'u vendosur jashtë vendit të tij të origjinës me qëllim që të përmirësojë cilësinë e jetës. Ky term përdoret për t'ju referuar edhe personave që përpiqen të hyjnë në një vend pa leje (në mënyrë të paligjshme) dhe duke përdorur procedurat e azilit. Ky term përdoret për t'ju referuar edhe personave që largohen në periodha të caktuara për punësim sezonal.

⁶⁶ deutsch-werden.de, *Was ist Unterschied zwischen Migranten und Immigranten*, (28.12.2011).

⁶⁷ fjalorshqip.com, *emigroj*, (25.01.2012).

⁶⁸ Ikonimi, Luljeta, *E drejta migratore, Organizata Ndërkombëtare për Migracion*, 2009, Tiranë, fq. 17.

⁶⁹ Po aty.

4. Punëtor migrant

Punëtor migrant është një person që merret me një aktivitet të paguar në një vend i cili është i ndryshëm nga vendi i origjinës. Ky term i referohet edhe migrantëve të parregullt edhe punonjësve të kompanive shumë dimensionale të cilët për nga natyra e punës lëvizin nga një vend në tjetrin sipas kërkesave të kompanisë.⁷⁰

2. Strategjitë e formimit të identitetit tek migrantët

Një ndër temat më të rëndësishme ndër migrantët në shoqëritë e sotme ku ata jetojnë dhe veprojnë është strategjia e formimit të identitetit. Kjo çështje njëherit është edhe temë qendrore e shkencave politike, sociologjike dhe juridike. Në këtë fushë një ndikim të posaçëm kanë edhe shkencat etnologjike, etnografike dhe shumë të tjera. Përcaktimi i identitetit tek migrantët në Gjermani, posaçërisht në qytetin e Leverkusenit është një problematikë që në kuadrin e studimeve profesionale nga rradhët e vet migrantëve pak studjohet. Kjo vërehet edhe më vonë kur trajtohet arsimimi i migrantëve. Emile Durkheim mendon se arsimit e forcon homogjenitetin shoqëror dhe identitetin kolektiv të individëve. Sipas tij kjo gjë arrihet përmes mësimit të vlerave të përbashkëta, gjuhës, terminëve, synimeve dhe në këtë mënyrë krijohet vetëdija kolektive por edhe ndjenja e përkatësisë ndaj bashkësisë dhe rrethit shoqëror.⁷¹ Çështja e përcaktimit dhe strategjitë e formimit të identitetit zënë një hapësirë të konsiderueshme edhe në temat shumë të përfolura të integritimeve dhe multikulturalizmit. Në këtë hapësirë të gjërë, për të patur një orientim më të lehtë, duhet përmendur dy momente:

1. Kush jamë unë, nga vij unë, kush janë të parët e mi, cilat janë rrënjët e mia?
2. Cili është qëllimi i qëndrimit tim në migrim, sa mund të jetë kohëzgjatja e këtij qëndrimi, pse migrova unë?

E pra, kush jemi ne? Për ata që janë rritur në Europë kjo pyetje bëhet gjithnjë e më komplekse. Kjo përfshinë një turmë të madhe të të rinjve që i takojnë gjeneratës së dytë, të tretë e të katërt. Kush përgjigjet? Kush ua rikthen atyre elementet dhe sensin për identitetin e tyre. Kush e rindërton atë ose së paku, u jep atyre disa shenja që u lejon të gjejnë me vetëdije të lirë, rrugën e tyre personale?⁷² Në konceptin e pyetjeve të para vend kryesor dhe të drejtpërdrejtë zë përcaktimi teorik i identitetit personal dhe familjar. Individu a është i vetëdijshëm të kuptojë se ka identitet kombëtar dhe fetar, pastaj këto karakteristika a është në

⁷⁰ Po aty.

⁷¹ Jashari, Hasan, *Sociologjia e arsimit*, Interlingua, Shkup, 2005, fq. 19.

⁷² Po aty.

gjendje t'ua përcjellë pasardhësve të vet. Në konceptin e pyetjeve të dyta vend kryesor zë përcaktimi praktik i individit apo bashkësisë që të kuptojë veten për të kultivuar identitetin kombëtar dhe fetar, poashtu përmes kësaj edhe të vetëdijsohet për karakteristikat identifikuese.

Migranti për t'iu shmangur qëndrimeve reaktive dhe atyre të nënshtruara, është e nevojshme t'u kthehet burimeve dhe t'i studiojë rregullat e përgjithshme në mënyrë që të identifikojë parametrat me të cilët duhet të matë saktësinë e pozitave, interpretimeve dhe zgjidhjeve.⁷³ Gjatë procesit të formimit të identitetit tek migrantët, posaçërisht të gjeneratës së dytë dhe të tretë, ndikim të fuqishëm kanë:

1. Gjuha e vendit pritës dhe gjuha amtare,
2. Kontakti me bashkëatdhetarët dhe me pjesëtarët e etnive dhe kulturave tjera.

2.1. Gjuha e vendit pritës dhe gjuha amtare

Gjithnjë është pranuar nga sociologët se gjuha është themelore për jetën sociale. Kohët e fundit është zhvilluar një pikëpamje që në mënyrë të veçantë merret me mënyrën si njerëzit e përdorin gjuhën në situatat e jetës së përditshme.⁷⁴ Gjuha e vendit pritës e cila njihërit konsiderohet element kryesor në proceset e integritimit nga viti 2006 në Gjermani obligohet për fitimin e shtetësisë apo lejeqëndrimit të rregullt.⁷⁵ Qëndrimi i prindërve në këtë situatë është shumë me ndikim, ngase vet prindët nuk kanë mendime të unjisuara rreth kësaj çështje. Qëndrimet e disa prindërve ndaj gjuhës së origjinës shfaqen kështu:

„Ich will nicht, dass mein Kind Türkisch (Kroatisch, Serbisch, Bosnisch, ...) etc. lernt. Es soll so schnell wie möglich Deutsch lernen“ „Da schadet es nur, wenn es den muttersprachlichen Unterricht auch noch besucht“.⁷⁶ „Unë nuk dua që fëmiju im të mësojë turqisht (kroatisht, sërabisht, boshnjakisht,...) etj. Ai duhet sa më shpejtë të mësojë gjermanishten“. „Është e dëmshme nëse ai akoma ndjekë mësimin e gjuhës amtare“. „Seine Muttersprache kann das Kind ohnehin, die braucht es nicht zu lernen. Die sprechen wir ohnehin in der Familie.“⁷⁷ „Gjuhën amtare ai e di gjithsesi, ai ate nuk duhet ta mësojë. Ne atë e flasim në shtëpi“. Ky është qëndrimi i disa prindërve me etni jo shqiptare.

⁷³ Po aty, fq. 36.

⁷⁴ Giddens, *Sociologjia*, fq. 101.

⁷⁵ aufenthaltstitel.de, *Gesetz über den Aufenthalt, die Erwerbstätigkeit und die Integration von Ausländern im Bundesgebiet*, (25.01.2012)

⁷⁶ Rudolf de Cillia, *Spracherwerb in der Migration*, bm:bwk, Berlin, 2003, fq. 3.

⁷⁷ Po aty.

Arsimtari i gjuhës shqipe pohon se vetëm 50 % e nxënësve shqiptarë ndjekin mësimin e gjuhës amtare në qytetin e Leverkusenit. Mësimi plotësues i gjuhës shqipe në këtë qytet funksionon në formë të organizuar që nga viti 1983/84.⁷⁸ Gjuha amtare ka shumë ndikim në formimin e identitetit të migrantit, çdokush ka të drejtë të ketë gjuhën e vet amtare. Gjuha amtare është gjuha e mendimit dhe e ndjenjave, të cilat ndikojnë në formësimin e identitetit të njeriut në përgjithësi e posaçërisht në këtë rast të migrantit. Gjuha amtare është mjet për ruajtjen e identitetit, kulturës, traditës, etj. Baza e identitetit nacional shqiptar me siguri se është gjuha shqipe së bashku me ndodhitë e përbashkëta historike si një ndër elementet kryesore që bashkon të gjithë shqiptarët.⁷⁹

Gjuha si instrument kryesor i komunikimit të migrantëve shqiptarë në Leverkusen të Gjermanisë me siguri se ka ndryshime nga prurjet e trojeve etnike por ajo nuk mund të ndryshohet në mënyrë arbitrare sipas tekeve apo imponimeve të dikujt, gjuha shqipe ka strukturën e vet, rregullat dhe leksikun që është ngulitur.⁸⁰ Njohuritë e mjaftueshme të gjuhës amtare janë me ndikim pozitiv dhe reciprok në bashkësinë njerëzore. Janë i vetmi mjet komunikimi në familje dhe me të afërmit, poashtu edhe me rrethin ku jetojnë. Gjuha amtare ndihmon njeriun që të aktivizohet në aktivitete shoqërore me vendlindjen, gjegjësisht atdheun, vendin e rrënjëve të veta. Gjuha amtare i shërben edhe në marrëdhëniet e tij gjatë punëve zyrtare në vendlindje. Njeriu duke njohur gjuhën amtare i mundësohet të ndjekë ndodhitë në vendlindje, të përcjellë programet radio-vizuele për tu pasuruar me kulturë dhe ndjenja kombëtare.

Me njohjen e gjuhës amtare zhvillohet edhe interesimi për aftësimin e njeriut që të pajiset me njohuri të mjaftueshme për kulturën e tij personale, të dijë ai se të parët e tij kanë elemente identifikuese, kanë trashëgimi kulturore, etj. Në këtë rast individ i kupton shumëanshmërinë e proceseve dhe njëkohësisht formon bindjen dhe mendimet personale mbi identitetin e vet. Parashtrahet pyetja mërgata, (diaspora) a posedon informata të mjaftueshme mbi rëndësinë e ndikimit të gjuhës në strategjitë e formimit të identitetit dhe a zhvillohet mësimi i gjuhës amtare në Gjermani, gjegjësisht në Leverkusen.⁸¹ Prindët a janë të angazhuar në monitorimin e zhvillimit të mësimin të gjuhës amtare dhe a janë në bashkëpunim me mësuesit dhe shkollat në të cilat organizohet mësimi i gjuhës amtare.

⁷⁸ rrezore.com, *Këshilli i arsimtarëve në Gjermani*, Dumnica, Bajram, arsimtar i shkollës shqipe në Leverkusen.

⁷⁹ klealove.com, *Identiteti shqiptar*, Hatibi, Ervin, (25.01.2012).

⁸⁰ shkelzenmaliqi.wordpress.com, *Kombi në pikën e verbër*, Shkëlzen, Maliqi, (25.01.2012).

⁸¹ rrezore.com, *Këshilli i arsimtarëve në Gjermani*, (25.01.2012).

Dygjuhësia njëherit është edhe ndihmesë për mësimin e gjuhëve të huaja si psh. mësimin e anglishtes, frengjishtes, spanjishtes, etj. Individu i cili përvetëson dy gjuhë është shumë domethënës, ai ndryshe krijon, është elastik dhe ka prirje për përvetësime të koncepteve të reja, kështu ka interesim për një angazhim më të mirë ndaj të gjitha dukurive dhe risive shoqërore.⁸² Një prej synimeve të këtij studimi është hulumtimi i njohurive gjuhësore të migrantëve shqiptarë për gjuhën amtare dhe gjuhën e vendit, gjegjësisht gjermanishtes si gjuhë e punës, komunikimit, shkollimit, etj. Është e rëndësishme të dihet shkalla e përpjekjeve për të mësuar gjuhën e vendit dhe për të kultivuar gjuhën amtare, ngase një prej karakteristikave kryesore me të cilën identifikohen migrantët është gjuha. Përmes statistikave përshkruese në vazhdim mundësohet të kuptohet migrantët shqiptarë ku qëndrojnë me njohuritë e tyre rreth gjuhës amtare dhe gjuhës gjermane.

2.2. Njohuritë e migrantëve shqiptarë ndaj gjuhës gjermane

Gjeneratat e para të migrantëve shqiptarë në Leverkusen kryesisht janë me shkollim të ulët, ndërsa gjeneratat në vazhdim kanë më tepër shkollim profesional. Zotërimi i gjuhës amtare ka ndikim dhe rol të madh në mësimin e gjuhës gjermane, kështu mendojnë edhe vetë gjermanët. Përdorimi dhe njohja e gjuhës gjermane në një fushë të caktuar nuk don të thotë se migranti zotëron tërë gjuhën gjermane, në të vërtetë migranti kur është përgjigjur kësaj pyetje ka pasur parasyshë të gjitha variantet dhe dimensionet gjuhësore. Nga rezultatet e tabelës nr.20 mundësohet të kuptohet se migrantët shqiptarë nga 116 të anketuar në këtë qytet, 33 prej tyre (28,5%) flasin shkëlqyeshëm gjuhën gjermane. 37 prej tyre (32%) lexojnë shkëlqyeshëm. 30 prej tyre (25,8%) shkruajnë shkëlqyeshëm dhe së fundi mund të shihet se 38 nga ata (32,8%) kuptojnë shkëlqyeshëm gjuhën gjermane. Nga 116 të anketuar, 32 prej tyre (27,6%) flasin shumë mirë gjuhën gjermane. 42 prej tyre (36%) lexojnë shumë mirë. 20 prej tyre (17,2%) shkruajnë shumë mirë dhe së fundi 41 prej tyre (35,2%) kuptojnë shumë mirë gjermanisht. Të tjerët me përqindje të përafërt duke filluar nga 18,1% e që ngritet në 34,5% kanë përshtypjen se njohuritë e tyre gjuhësore qëndrojnë mirë. Sinqerisht migrantët shqiptarë janë përgjigjur edhe notës mjaftueshëm të cilën e kanë vlerësuar me 8,6% e që arrin në 20,6% dhe minimalisht me 0,8% e që arrin në 6,3% migrantët shqiptarë mendojnë se do të njohin gjuhën gjermane.⁸³

⁸² *Broshurë informative për prindërit shqiptar*, Claus Drubel, München, 2006, fq. 2.

⁸³ Shih Shtojca, Tabela nr. 20.

2.3. Njohuritë e migrantëve shqiptarë ndaj gjuhës amtare

Niveli i njohurive të gjuhës shqipe në Leverkusen të Gjermanisë për dallim nga generatat e para është në rënie dhe vet komuniteti shqiptar i bartë pasojat për këtë. Sistemi arsimor gjerman i cili ka mundësuar që nga viti 1983 për të funksionuar mësimi i gjuhës shqipe si orë plotësuese, nuk ka gjetur përkrahje të mjaftueshme nga prindërit shqiptarë. Përdorimi dhe njohja e gjuhës gjermane në një fushë të caktuar nuk nënkupton njohjen e tërësishme të gjermanishtes, poashtu edhe përdorimi i gjuhës shqipe në një fushë të caktuar nuk nënkupton njohjen e tërësishme të gjuhës shqipe.

Duke i krahasuar statistikat jepet të kuptohet se gjuha shqipe në fushën akademike, në gjuhën e librit, vlerësohet nga migrantët me shkëlqyeshëm duke patur parasysh variantin e shkollimit të lartë në këtë gjuhë, pra në gjuhën amtare. Rezultatet e tabelës nr.21 për kohën rezultojnë me statistika të pëlqyeshme, nga e cila kuptohet se nga 116 të anketuar, 34 prej tyre (29,3%) flasin shkëlqyeshëm shqip, 45 prej tyre (38,8%) lexojnë shkëlqyeshëm shqip, 40 prej tyre (34,5%) shkruajnë shkëlqyeshëm shqip dhe 52 prej tyre (44,8%) kuptojnë shkëlqyeshëm shqip. Nga të anketuarit kuptohet se shumica prej tyre qëndrojnë shumë mirë me gjuhën shqipe, 54 prej tyre (46,7%) flasin shumë mirë shqip, 45 prej tyre (38,8%) lexojnë shumë mirë shqip, 43 prej tyre (37%) shkruajnë shumë mirë shqip dhe 38 prej tyre (39,6%) kuptojnë shumë mirë shqip.⁸⁴ Në vazhdim duke filluar me 17,2% e që ngritet deri në 19,8 % qëndrojnë mirë me gjuhën shqipe. Migrantët shqiptarë me përqindje të vogël deklarohen se mjaftueshëm njohin gjuhën shqipe, e kjo korespondon me numrin e të lindurve në Gjermani.⁸⁵

3. Kontakti i migrantëve shqiptarë me bashkëatdhetarët e tyre dhe me anëtarët e etnive dhe kulturave tjera

Kontakti me bashkëatdhetarët ka një ndikim të madh në strategjitë e formimit të identitetit. Populli thotë „Trego me cilin rri, të të tregoj se kush je“. Në një të kaluar jo të largët, shqiptarëve ju mungonin shumë elemente identifikuese, gjegjësisht u ndalohej përdorimi i flamurit, shtetit, gjuhës së shkruar, shkollës, universitetit, shkollës fetare, veshjeve kombëtare, etj. Me kalimin e kohës këto elemente identifikuese legalizohen dhe përdorimi i tyre bëhet i rëndomtë. Diaspora kishte një fat të tillë, ngase më herët migrantët shqiptarë identifikoheshin me elementet nacionale jo shqiptare. Te shqiptarët ekziston një fenomen i

⁸⁴ Po aty, Tabela nr. 21.

⁸⁵ Shih Shtojca, Tabela nr. 5.

rrallë, tani kur krejt këto elemente bëhen legale mbushen shumë shpejtë me të gjitha dhe thuhet nuk iu intereson gjë tjetër përveç se vetvetja. Rrethin dhe familjen e duan vetëm sa të mos dëgjojnë apo shofin keq për ta. Për të mos i humbur të gjitha shpresat në kohën e modernizimit ky fenomen i shoqëron edhe kombet tjera. Nga ana tjetër nga ky sindrom nuk janë të prekur vetëm mërgimtarët, por edhe ata që jetojnë në vendlindje. Mentaliteti i mërgimtarit shqiptar, ritmi i dinamikës së jetës në përfundim, përpjekjet për të organizuar një jetë me rrethin më të ngushtë familjar për tu mbrojtur nga asimilimi, detyrojnë të formohet një sjellje indiferente ndaj bashkëvendësve këtu në mërgim.

Rruga e mërgimit është marrë për shkaqe ekonomike, në momentin kur paraqitet diferenca materiale, fillon të lind xhelozia, smira, mosdurimi dhe injoranca. Me paraqitjen e këtyre ndjenjave fillon të humb kontakti mes bashkëatdhetarëve në diasporë. Ardhja në përfundim për shqiptarët në fillim ka qenë një fillim nga zero. Të gjithë kanë patur të njëjtin start, nuk ka mund dikush të dallojë nga dikush tjetër me ndonjë përgatitje intelektuale, profesionale, etj. Uniteti, bashkimi, solidarizimi, kontakti me njëri tjetrin kanë qenë në nivel, elemente këto të cilat kanë patur një ndikim shumë pozitiv në strategjitë e formimit të identitetit të migrantit shqiptar. Në mërgim çdo një takim në rrugë dhe çdo një përshëndetje konsiderohet kontakt i frytshëm. Këto raste janë natyrshëm e migrantëve shqiptarë dhe vazhdojnë të jenë kështu përderisa nuk ndërhyhet në punët e njëri tjetrit për të keq, edhe pse ndërhyrja negative nuk ndodhë shpesh.

Kontakimi i migrantit me familjen, miqtë dhe shokët kanë domethënie të veçantë. Në këtë hulumtim më tepër qasje i është kushtuar përbërjes së shoqërisë së migrantit shqiptar në Leverkusen të Gjermanisë. Migrantit shqiptar duke qenë i ngarkuar me punë të përditshme, brenda këtij hulumtimi është mundësuar të mësohet se sa kohë i kushton kontaktimit me shokët e kulturës së vet dhe të kulturave tjerave.⁸⁶

3.1. Përbërja e shoqërisë së migrantit shqiptar në Leverkusen

Nga rezultatet e tabelës nr.18 mundësohet të kuptohet se 62 (53,5%) migrantë shqiptarë në Leverkusen shoqërinë e tyre e kanë të përbërë me shumicë nga pjesarë të kulturës së tyre kombëtare. Kësaj pyetje i përgjigjen 116 të anketuar. Më pas vërehet se ka migrantë që shoqërinë e tyre tërësisht e kanë kombëtare dhe ka të tillë që kanë pak apo asnjë shok shqiptar.⁸⁷ Migrantët shqiptarë kanë edhe shokë të kulturave tjera (turke, marokene,

⁸⁶ Shih Shtojca, Tabela nr. 18 dhe nr. 19.

⁸⁷ Po aty, Tabela nr. 18,19.

polake, etj.) e që në bazë të rezultateve ata përbëjnë pakicën e shoqërisë së tyre. Kështu deklarohen në këtë hulumtim 61 (70,6%) të anketuar. Në këtë pyetje nga 116 të anketuar marrin pjesë 86 prej tyre, e që haset se ka migrantë shqiptarë që shumicën e shoqërisë së tyre e kanë me shokë të kulturave tjera. Migrantët shqiptarë kanë shokë edhe të kulturës gjermane, në bazë të hulumtimit ata përbëjnë pakicën e shoqërisë së tyre. Kështu deklarohen 41 (51,9%) të anketuar. Kësaj pyetje nga 116 të anketuar i përgjigjen vetëm 79 prej tyre, nga të cilët ka që shumicën e shokëve e kanë të kulturës gjermane.⁸⁸

3.2. Kontakti i migrantëve shqiptarë në Leverkusen me pjesëtarët e kulturës kombëtare dhe pjesëtarët e etnive dhe kulturave tjera

Rezultatet e tabelës nr.19 tregojnë se migrantët shqiptarë në Leverkusen më së shpeshti takohen me pjesëtarët e kulturës së tyre kombëtare. Nga 116 të anketuar, 67 (57,7%) pohojnë se shpesh takohen me bashkëkombasit e tyre. Takimi këtu ka për qëllim vizitat e ndërsjella, bisedimin, debatimin për ndonjë problem në vendlindje, e kështu me rradhë. Migrantët me shokë nga kulturat tjera deklarojnë se takohen rrallë. Kështu pohojnë 29 (35,4%) të anketuar nga 82 sa marrin pjesë në këtë pyetje dhe ndonjëherë takohen 30 (36,6%) të anketuar. Të tjerët me 18,3% takohen shpesh dhe 7,3% shumë shpesh me shokë të kulturave tjera.

Takimi i migrantëve shqiptarë me pjesëtarët e kulturave tjera në këtë rast ka për qëllim takimin në vendin e punës, aktivitetet e përbashkëta, etj. Takimi me pjesëtarët e kulturës gjermane është i përafërt me pjesëtarët e kulturave tjera dhe kjo nga fakti se përsëri i bashkon vendi i punës apo ndonjë shoqëri me aktivitete të përbashkëta. Me pjesëtarët e kulturës gjermane migrantët shqiptarë takohen më së shumti rrallë, këtë e pohojnë 27 (33%) të anketuar nga 82 sa marrin pjesë në këtë hulumtim dhe ndonjëherë takohen 26 (31,6%), të anketuar. Shpesh herë takohen 14 (18%) të anketuar dhe shumë shpesh 13 (16%) të anketuar. Ka migrantë shqiptarë të cilët nuk kanë shokë të asnjë kulture, kjo vërrehet në statistikat e tabelës nr.18.⁸⁹

⁸⁸ Po aty, Tabela nr. 18.

⁸⁹ Po aty, Tabela nr. 18.

4. Shkaqet e migrimit të shqiptarëve në Gjermani

Çdo familje shqiptare pak a shumë është e prekur me migrimin. Migrimi që te shqiptarët njihet edhe me termin „kurbet“, (dheu i huaj, mërgim për bukën e gojës)⁹⁰ është i hershëm dhe përfshinë të gjitha trojet shqiptare. Shqiptarët si synim kryesor kanë patur emigrimin drejt Europës dhe Amerikës. Një fluks i madh i shqiptarëve nga të gjitha trojet etnike është përqëndruar edhe në Gjermani.⁹¹ Ndarja nga familja dhe të afërmit gjithmonë është shoqëruar me pasoja dhe dhimbje, kështu që migrimi mbetet një plagë me pasoja dhe përmasa të gjëra.

Shkaqet e migrimit të shqiptarëve në Gjermani janë me sa vijon:

- a. Humbja e shpresës së zhvillimit ekonomiko-social të vendeve nga vijnë migrantët,
- b. Mungesa e sovranitetit dhe aftësisë profesionale për të bërë një veprimtari,
- c. Mungesa për të bërë një biznes të mirëfilltë,
- d. Mungesa e tregut të lirë dhe konkurrencës së hapur,
- e. Byrokracia në institucionet përkatëse për legalizimin e veprimtarisë përkatëse,
- f. Mungesa e subvencioneve dhe mungesa e bankave financuese,
- g. Mungesa e shkollimit apo shkollimi i dobët, mungesa e mësuesve,
- h. Ekonomia e dobët,
- i. Papunësia,
- j. Kushtet jo të mira,
- k. Bashkimi familjar,
- l. Sëmundja e korrupsionit si fenomen i vendeve të ballkanit,
- m. Dëshira e madhe për të realizuar idealet kombëtare nga mërgimi,
- n. Persekutimet, internimet, burgimet,
- o. Problemet familjare, bashkëshortore,
- p. Lufta e Kosovës, Maqedonisë, Preshevës, Bujanovcit dhe Medvegjës, etj.⁹²

Grinberg, psikoanalistë nga Argjentina, thotë se të migruarit në Spanjë, kanë punuar për të analizuar shkaqet psikoanalitike të migrimit, ata gjithmonë e ndërlidhin migrimin me kriza personale. Te këta psikoanalistë nuk ka rëndësi se në çfarë rrethanash është marrë vendimi për të migruar, por eksperiencia traumatike e detyron njeriun për të migruar, si psh.

⁹⁰ *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë, 1984, fq. 576.

⁹¹ Nuscheler, *Internationale Migration. Flucht und Asyl*, fq. 121.

⁹² Dana, Sonila, *Kthimi nga emigracioni dhe sfidat e riintegrit*, Shoqata „Shpresë për të ardhmen“ Tiranë, 2006, fq. 14.

lufta, dhuna, etj. Nga e gjithë kjo që përmendet më lartë kuptohet se askush nuk largohet nga vendi i tij me dëshirë, çdo emigrim ka një parakusht, një arsye.⁹³

4.1. Largimi nga vendlindja dhe zbarkimi i shqiptarëve në Gjermani

Migranti kur lëshon vendlindjen e tij fillon të fsheh hidhërimin, pikëllimin dhe dhimbjen. Ai fillon në kokën e tij të formojë bindje të reja, sa që fillon edhe vendlindjen ta vlerësojë si të pavlerë dhe të kotë.⁹⁴ Migracioni i një pjese të migrantëve shqiptarë drejt Gjermanisë kishte edhe karakter politik të marrëveshjeve ndërshtetërore⁹⁵. Ky largim arrihej edhe përmes kushtëzimeve dhe presioneve të organizuara, pjesë e së cilës ishte edhe dëbimi i shqiptarëve për në Shqipëri, e më pas përmes marrëveshjeve të fshehta për në Turqi.⁹⁶ Kjo shpërngulje e dhunshme dhe me ngjyra politike karakterizohet me presione, arrestime, konfiskime, dhunë fizike, pengesë shkollimi, ndalim mektebi, cungim i lirisë fetare, etj.

Pas Luftës së Dytë Botërore Gjermania kishte nevojë të madhe për krahun e punës, për të ndërtuar vendin nga shkatërimet e luftës. Një nevojë e tillë më pas është paraqitur në vitet e 60-ta, e më vonë vitet 70-ta shënojnë kulmin e migracionit shqiptar pas krizës ekonomike të krijuar nga rritja e çmimit të naftës në vitin 1973.⁹⁷ Politikat jugosllave përmes enteve të punësimit dërgojnë një numër të madh shqiptarësh në Gjermani.⁹⁸ Deri në ditët e sotme është bërë shumë punë për ruajtjen e identitetit kombëtar dhe religjioz të shqiptarëve në Gjermani, gjegjësisht në Leverkusen, punohet aq shumë që të mbrohet dinjiteti i tyre dhe të dihet saktësisht prejardhja e tyre.

4.2. Ballafaqimi me një mjedis të ri

Me rastin e zbarkimit të shqiptarëve në Gjermani është për tu vlerësuar menaxhimi i suksesshëm i enteve dhe institucioneve përkatëse për vendosjen e migrantëve dhe adaptimin e tyre në mjedisin e ri. Nga këto ente dhe institucione që në fillim u përkrahën nevojat dhe kërkesat kulturore dhe religjioze të migrantëve. Nëpër fabrika dhe uzina organizoheshin festat

⁹³ Grinberg, Rebecca, Grinberg, Leon, *Psychoanalyse der Migration und des Exils*, Internationale Psychoanalysis, München und Wien 1990, *Migrimi nga pikëpamja e psikoanalizës*, fq. 2.

⁹⁴ Po aty.

⁹⁵ Nuscheler, *Internationale Migration. Flucht und Asyl*, fq. 185.

⁹⁶ Braha, Shaban, *Gjenocidi sërbo-madh dhe qëndresa shqiptare*, Lumi-T, Gjakovë, 1991, fq. 493.

⁹⁷ Nuscheler, *Internationale Migration. Flucht und Asyl*, fq. 115.

⁹⁸ Po aty.

kombëtare dhe fetare, ishte punëdhënësi ai që siguronte një hapsirë të posaçme për kryerjen e rriteve fetare, të atyre ditore, javore dhe vjetore. Vitet e 80-ta shënojnë periudhën e ardhjes së familjeve shqiptare në Gjermani⁹⁹, tanimë për bashkim familjar jo për të kërkuar punë. Kjo është periudha e fillimit të një jete mërgimtare ndryshe të organizuar. Migrantët të cilët banonin nëpër konvikte me fillimin e bashkimit familjar sistemohen nëpër banesa private apo të ndërmarjeve. Pas kësaj fillon integrimi i fëmijëve të migrantëve nëpër shkollat fillore dhe të mesme, është koha e organizimit të migrantëve shqiptarë për të themeluar shoqëritë e tyre kulturore dhe fetare nëpër tërë Gjermaninë. Në Leverkusen në vitin 1989 hapet klubi shqiptar „Xheladin Zeqiri“,¹⁰⁰ ndërsa më herët, në vitin 1986 ishte themeluar xhamia shqiptare „Mesxhidi Aksa“.¹⁰¹

Proceset e ballafaqimit të migrantëve me mjedisin e ri janë karakterizuar gjithmonë në shkallë të caktuar të hapjes reciproke ndaj shoqërisë pritëse. Pas fillimit të hapjes së „shoqërive të mbyllura“¹⁰² bëhet një lëvizje pozitive në këtë drejtim, fillimisht me fëmijët e tyre duke ndërtuar shoqëri nëpër shkolla, të cilët më vonë shkëmbejnë edhe vizita. Një ballafaqim i suksesshëm i migrantëve me shoqërinë pritëse është bërë me rastin e aktiviteteve të ndryshme kulturore, sportive, ndërfetare, etj.

Prespektiva shpresohet të arrihet përmes mënyrave të ndryshme të organizimit, të cilat inkurajojnë çdo individ në shoqëritë multikulturore të kultivojë mendimin pa paragjykim.¹⁰³ Çdo vit para fillimit të pushimeve verore në qytetin e Leverkusenit organizohet manifestimi tradicional „Europa fest“ në të cilin migrantët e të gjitha vendeve përfaqësojnë kulturën e tyre etnike, aty prezantojnë edhe shqiptarët. Përmes këtyre aktiviteteve bëhen përpjekje për parandalimin e shfaqjes së shoqërive paralele. Integrimi në jetën publike tentohet të arrihet edhe me dhënie të banesave moderne në qendrat urbane gjithashtu edhe me përfshirjen e migrantëve në punët administrative. Një qasje e tillë është shumë e rëndësishme me rastin e mundësive të barabarta në institucionet arsimore.¹⁰⁴ Shkollat fillore në Leverkusen të Gjermanisë kanë një përqindje të lartë të fëmijëve të migrantëve, duke përfshirë edhe shqiptarët.

⁹⁹ Po aty.

¹⁰⁰ Arhivi i klubit shqiptar „Xheladin Zeqiri“ Leverkusen, *procesverbali i themelimit të klubit*, VR. 1189, 28.02.1989.

¹⁰¹ Arhivi i xhamisë shqiptare „Mesxhidi Aksa“ Leverkusen, *procesverbali i themelimit të xhamisë*, VR. 1286, 19.10.1986.

¹⁰² Kroth, Isabella, *Halbmond-wahrheiten*, Diedrichs Verlag, München, 2010, fq. 13.

¹⁰³ Bartles Ulrike/Heib Claudia/Ristau Daniela, *Deutschland mit anderen Augen*, Horlemann, 2009, fq. 11.

¹⁰⁴ *Parimet e lirisë dhe sigurisë për Gjermaninë*, Fondacioni Konrad Adanauer, Berlin, 2008, fq. 21.

Gjermania si një shtet demokratik dhe social, mundëson që të gjithë qytetarët vendas dhe të huaj të kenë të siguruar plotësisht lirinë dhe punësimin, pamarrë parasyshë gjininë, prejardhjen, racën, gjuhën, konfesionalitetin apo botëkuptimet politike. Në bazë të Kushtetutës Federative të Gjermanisë (Grundgesetz der Bundesrepublik Deutschland), për të gjithë njësoj është e garantuar liria e personalitetit, qarkullimit, mendimit, fjalës, shtypit, informacionit, tubimit politik, bashkimit në shoqata, e drejta e pasurimit, pronësisë dhe trashëgimisë, e drejta për t'u marrë me shkencë dhe art, e drejta e shkollimit dhe e zgjedhjes së profesionit, e drejta në martesë dhe zgjedhja e bashkëshortit.¹⁰⁵

Përvetësimi i gjuhës gjermane është kusht themelor për formimin e opinionit dhe mendimit ndaj vendit pritës, njëherit ndikon në pjesmarjen e migrantin në jetën e përbashkët shoqërore me vendasit, si dhe për shkëmbimin e përvojave reciproke.¹⁰⁶ Kërkesat intensive që migrantët t'iu përshtaten vlerave të shoqërisë vendase janë një temë e gjërë që shtyn të mendohet në seriozitetin e garantimeve kushtetuese.

4.3. Ballafaqimi i migrantëve në Leverkusen me dukuritë si ksenofobia, diskriminimi dhe racizmi

Një tjetër dukuri me rastin e ballafaqimit të migrantëve në shoqërinë pritëse është shfaqja e ksenofobisë përmes shkeljes së ligjeve, diskriminimit dhe racizmit. Përmes ksenofobisë arrihet formimi i mendimit progresiv në proceset shoqërore ku arrihet edhe respektimi i gjyqësorit dhe organeve të rendit. Të gjithë njerëzit në Gjermani janë të barabartë para gjyqësorit, janë të mbrojtur moralisht dhe fizikisht me ligj. Qëndrimi racist, racizmi institucional, racizmi kulturor, racizmi individual dhe kolektiv,¹⁰⁷ ofendimi i qytetarëve dhe keqtrajtimi i tyre fizik ndalohet me ligj. Diskriminimi është në disfavor të proceseve integruese, si i tillë ai përfshinë jetën private dhe shoqërore, dhe përqëndrohet në trajtimin jo të barabartë të personave dhe grupeve që nuk janë të të njëjtës etni, gjuhë, racë, religjion, ideologji, etj.¹⁰⁸ Nga forma diskriminimi mund të shfaqet në dimensione të ndryshme. Kognicioneve të diskriminimit ju paraprinë ndjenjat e njeriut të cilat te çdokush i kanë kufijtë individual. Me diskriminimin mund të përballen edhe anëtarët e të njëjtit etnitet, gjuhë, racë,

¹⁰⁵ *Kushtetuta e Gjermanisë*, nga §1, §2, §3, §4, §5.

¹⁰⁶ Cillia, *Spracherwerb in der Migration*, fq. 4.

¹⁰⁷ Böhm Dietmar, Böhm Regine & Deiss-Niethammer Birgit, *Handbuch Interkulturelles Lernen*, Herder, Freiburg, 1999, fq. 59.

¹⁰⁸ kanzlei-flaemig.de, *Diskriminierung Allgemeines Gleichbehandlungsgesetz*, (21.01.2012).

religjion, kulturë, etj. Nga kjo mund të konstatohet se çdo njeri në ndonjë mënyrë ka hasur në diskriminim.

Migrantët shqiptarë duke qenë pjesë e vogël e një shoqërie multikulturore, automatikisht hasin në diskriminim. Sa ndjehen migrantët shqiptarë në pozitë të pafavorshme dhe të diskriminuar kuptohet nga tabela nr.13.¹⁰⁹ Nga rezultatet e kësaj table mund të vlerësohet se trajtimi diskriminues ndaj migrantëve shqiptarë në Leverkusen varion prej 3% dhe ngritet maksimalisht deri më 33%. Kombet e Bashkuara kanë kritikuar diskriminimin në vazhdim të migrantëve dhe pasardhësve të tyre në Gjermani¹¹⁰ por të dhënat e këtij hulumtimi rezultojnë me statistika deri diku të kënaqshme. Nga 107 pjesëmarrës në këtë anketë, 42 prej tyre (39,4%) nuk ndjehen në pozitë të pafavorshme apo të diskriminuar shkak i etnitetit të tyre. Në vazhdim 25 të anketuar (23,5%) rrallë ndjehen të diskriminuar. 35 të anketuar (32,5%) ndonjëherë kanë hasur në diskriminim. Nëse rastet e më sipërme konsiderohen diskriminim indirekt, së fundi mund të konstatohet se me diskriminim direkt janë përballuar vetëm 5 të anketuar nga 107. 2 prej tyre (1,8%) shpesh dhe 3 të anketuar (2,8%) shumë shpesh.¹¹¹

Çdo shtet demokratik, edhe Gjermania mundohet ti zbatojë ligjet përkatëse kundër diskriminimit. Kur migrantët e rinj nuk do të fshehin origjinën e tyre, mund të thuhet se vendi është i hapur për integrim.¹¹² Migrantët edhe pse kanë rrënjë të huaja, nëse krijojnë familje dhe ndjehen si në shtëpi të vet për një afat të gjatë kohor, atëherë mund të thuan: edhe ne jemi Gjermani.¹¹³ Arsimiti adekuat i migrantëve shqiptarë, ngritja profesionale e tyre, si dhe njohja e ligjeve, me siguri se zbeh diskriminimin në shoqërinë gjermane. Migrantëve shqiptarë nuk ju është bërë pyetje se cilat janë vendet ku ata më tepër diskriminohen, por nga fakti praktik vendet më të dalluara janë si psh. vendi i punës, zyrat administrative, shkollat, etj.

5. Pozita e identitetit të migrantëve shqiptarë në Leverkusen

Sa janë në gjendje migrantët shqiptarë në Gjermani që në shoqërinë civile dhe në angazhimin e tyre politik të prezantojnë dhe shpalosin identitetin e tyre nacional dhe fetar? Kjo është një pyetje e cila thuhet për gjeneratat e para mund të trajtohet vetëm në rrafshin civil. Sa ju takon gjeneratave të dyta, shihet një angazhim minimal në aspektin e organizimit

¹⁰⁹ Shih Shtojca, Tabela nr. 13.

¹¹⁰ Wolfgang Bebedek & Minna Nikolova, *Kuptimi i të drejtave të njeriut*, Manz Crossmedia, Vjenë, 2003, fq. 9.

¹¹¹ Shih Shtojca, Tabela nr. 13.

¹¹² Geiger, Ruth-Esther, *Ihr seid Detschland, wir auch*, Suhrkamp Verlag, Frankfurt, 2008, fq. 21.

¹¹³ Po aty.

të migrantëve që të aktivizohen sadopak përmes „Integrationsrat“ (Këshillit për integrim) në jetën politike për të përfaqësuar identitetin kolektiv të migrantëve shqiptarë.¹¹⁴ Migrantët në qytetin e Leverkusenit përmes „Këshillit për integrim“ kanë mundësi të marrin informatat e para, në web faqen zyrtare të qytetit që i kushtohet „Këshillit për integrim“. Aty mund të lexohen përshëndetjet në shumë gjuhë të botës por mungon në gjuhën shqipe?¹¹⁵ Në kontinentin e vjetër migrantët shqiptarë klasifikohen sipas sjelljeve të tyre.

Gjeneratat e para janë ata të cilat përmenden dhe merren gjithmonë për shembull pozitiv si punëtor të zellshëm, besnik dhe të përkushtuar ndaj atdheut të tyre. Me kalimin e kohës dhe ndryshimin e gjeneratave zbehet imazhi i migrantëve shqiptarë dhe ata disi vazhdojnë të konsiderohen si të padëshiruar në kontinentin e civilizuar.¹¹⁶

Për të patur një pozitë të lakmuar në shoqërinë gjermane sot nevojitet që nga mesi i migrantëve të ketë kuadro dhe profile të kategorive të ndryshme shkencore dhe profesionale. Sot kur është në pyetje pozita e identitetit nacional dhe fetar gjatë proceseve të integritetit ndjehet mungesa kadrovike e prezantimit të shqiptarëve për të mbrojtur dhe shpalosur interesat e identitetit nacional dhe fetar. Nga kjo pranohet se gjendja e pozitës së migracionit shqiptar është e zymtë dhe në bazë të kësaj mohohet mundësia për tu integruar në fushën ekonomike,¹¹⁷ politike dhe fetare në vendin pritës, gjegjësisht në Gjermani.

Për tu pozicionuar identiteti nacional dhe fetar i migrantëve shqiptarë nevojitet edhe një trajtim institucional në nivel ndërshtetëror. Migrantët shqiptarë në Leverkusen të Gjermanisë, janë vizituar për herë të fundit nga delegacionet e vendlindjeve, gjatë luftrave të fundit kur ju duheshin ndihma. Kështu përgjigjen përfaqësuesit e klubit shqiptar „Xheladin Zeqiri“ në Leverkusen. Situata sadopak ndryshon në rrafshin fetar, Bashkësitë Fetare Islame përpiqen që së paku njëherë në vit të vizitojnë përmes delegacioneve të tyre mërgimtarët. Këtë e konfirmojnë përfaqësuesit e xhamisë „Mesxhidi Aksa“ në Leverkusen. Të gjitha këto janë elemente me efekte negative gjatë fazave të formimit të identitetit të migrantëve, njëherit ndikojnë që ndaj vendit të origjinës migranti të ketë një paragjykim negativ.

¹¹⁴ Stadt Leverkusen, *Integrationsrat Wahlergebnis*, SHQIPTARET-Albaner: vota: 247, votues: 10,5 %.

¹¹⁵ leverkusen.de, *Ausländische Mitbürger*, (22.01.2012).

¹¹⁶ Kasimati, Mimoza, *Migracioni shqiptar pas viteve 90 dhe ndikimi i tij në jetën ekonomike dhe sociale të fëmijëve të lënë pas*, UNICEF, Tiranë, 2009, fq. 25.

¹¹⁷ Po aty, fq. 57.

5.1. Identiteti nacional i migrantëve shqiptarë në Leverkusen

Migrantët shqiptarë në Leverkusen të Gjermanisë vijnë nga të gjitha shtetet dhe trojet etnike shqiptare. Ata janë nga Maqedonia, Kosova, Mali i Zi, Shqipëria, si dhe nga Presheva, Medvegja dhe Bujanovci. Konfliktualite midis migrantëve shqiptarë, me siguri se ekzistojnë mbi bazë të një identiteti nacional „zyrtar“ shqiptar. Ky konfliktualitet ndërtohet mbi atë se kush është më kombëtar në mërgim.¹¹⁸ Pa marrë parasysh këtë konfliktualitet, prejardhja e migrantëve shqiptarë nga trojet dhe shtetet e ndryshme nuk ndikon në ndarje lokale, përkundrazi është edhe më përfshirës si shembull i unitetit dhe bashkimit. Kjo konsiderohet pasuri kombëtare shqiptare dhe shembull i ndërtimit të identitetit të shëndoshë nacional të një populli me një kulturë të njejtë dhe histori të përbashkët.

Ndikimet më të rëndësishme të identitetit nacional ndër migrantët shqiptarë vërehen përmes folklorit, organizimit të jetës sociale dhe ndjenjave të njëjta ndaj asaj çka ndodhë në vendin e origjinës, etj. Këto ndikime japin forcë dhe ndikojnë në forcimin e identitetit nacional shqiptar. Sipas kësaj kombi shqiptar në mërgim mundohet me tërë fuqinë e vet të qëndrojë i bashkuar dhe me ndikim pozitiv në botën e civilizuar për të mbajtur marrëdhënie normale me vendin ku jeton. Parashtrohet pyetja, cilat elemente emërtojnë përkatësinë shtetërore-nacionale të një popullate? A janë shqiptarë vetëm ata që kanë shtetësi apo pasaportë të Shqipërisë dhe se nuk janë shqiptarë ata që kanë një shtetësi tjetër, si maqedone, malazeze, serbe, në këtë rast një numër i konsiderueshëm i migrantëve që bartin shtetësi gjermane.

Problematikë e kohës së fundit është edhe definimi i identitetit nacional të shqiptarëve të Kosovës me rastin e pavarësisë së vendit. Emërtimet e komuniteteve etnolinguistike që jetojnë jashta Shqipërisë, tani konsiderohen si shqiptarë të kategorisë dytësore në rrafshin kombëtar, ndërsa të kategorisë parësore aty ku janë kategori kushtetuese.¹¹⁹ Migrantët shqiptarë që me të madhe lëshojnë shtetësinë e vendit origjinë, janë në kategori degraduese, ngase ata në vendet përkatëse nuk quhen as grupe etnolinguistike. Shqiptarët pamarë parasyshë ku jetojnë, në vendin e tyre të origjinës apo në mërgim, ata thjeshtë ndjehen shqiptarë dhe më pak ju intereson emëruesi politik. Migrantët nga intitucionet përkatëse të vendeve ku ata jetojnë gjithmonë pyeten për nacionalitetin, shtetësinë e tyre. Në këtë rast të mjerët, edhe pse janë shqiptarë, duhet të deklarohen si jo shqiptarë, në bazë të shtetësisë apo

¹¹⁸ Maliqi, *Kombi në pikën e verbër*, (23.01.2012).

¹¹⁹ Po aty.

pasaportës që bartin. Me keqardhje duhet të thuhet se edhe shteti amë, Shqipëria, i emëron si maqedonas, kosovar, etj.

5.2. Identiteti fetar i migrantëve shqiptarë në Leverkusen

Religjioni ka qenë dhe vazhdon të jetë preokupimi më madhor i njerëzimit. Nevoja e njeriut për fe mbetet natyrshmëri e kërkesave instiktive që nga kohët e lashta. Askush nuk mund të kuptojë njerëzimin pa kuptuar së pari fenë e tij, sepse feja përfshinë jetën e njeriut prej kohës më të lashtë.¹²⁰ Shqiptarët si popull me tre konfesionë, vazhdojnë më tepër ta kenë fenë e tyre si një trashigimi tradicionale se sa një vlerë shkencore, ideologjike, politike, ekonomike, etj. Feja në shtetet dhe trojet shqiptare, duke qenë ende e paorganizuar institucionalisht, ka një qasje të ndërlikuar në të gjitha sferat e jetës. Bartës të jetës dhe institucioneve fetare në shtetet dhe trojet shqiptare, por edhe në mërgim, janë vetëm bashkësitë përkatëse fetare.

Shqiptarët edhe pse përkatësinë fetare e kanë më tepër trashigimi tradicionale, ajo vazhdon të ketë ndikim qytetëruar, kulturor dhe kombëtar. Feja te shqiptarët avancohet nga të gjitha shtresat e popullit. Populli shqiptar nuk humbi asnjëherë identitetin e tij fetar (pos që u zbeh pak në kohën e diktaturës) por me shumë fanatizëm e mbrojti ate duke e trashëguar gjeneratë pas gjenerate. Fetë monoteiste te shqiptarët zhvillohen dhe praktikohen që nga kohët e lashta. Detyrë parësore e tyre deri në ditët tona mbetet toleranca ndërfaqetare dhe ndikimi i tyre në formësimin e identitetit fetar.¹²¹ Toleranca fetare buron nga njohja pozitive se është plotësisht e pavlerë një uniformitet i shtrënguar fetar, se me vlerë mund të jetë vetëm besimi fetar, që pranohet lirisht. Ai shpie drejt respektimit të çdo besimi të ndershëm dhe çon drejt respektit për individin dhe mendimin e tij.¹²² Mbetet detyrë e intelgjencës, në këtë rast të asaj shqiptare, të gjejë kodin ku bashkohen këto besime. Rruga e vetme për këtë është ruajtja e religjionit nga interpretimet politike ose instrumentalizimet e tij për qëllime jashtëreligjioze.¹²³

Fetë monoteiste bartin vizionin për të vërtetën dhe njëshmërinë e Krijuesit. Parimet fetare japin mundësinë për kompletimin e ndërfaqetare, mësojnë durimin, qëndrueshmërinë, sakrificën dhe pranimin e fatit jetësor. Feja e mëson njeriun si duhet të adhurohet Krijuesi,

¹²⁰ Morina, Qemal, *Identiteti fetar i shqiptarëve*, Edukata islame, BIK, Prishtinë, 2003, fq. 6.

¹²¹ Po aty.

¹²² Popper, Karl, *Për filozofinë dhe shkencën*, Fan Noli, Tiranë, 2009, fq. 28.

¹²³ Xhaferi, Arbën, *Dialogu mes civilizimeve, Tribunë e përbashkët e përfaqësuesve të religjioneve dhe grupeve etnike*, Logos-A, Shkup, 2003, fq. 35.

përmes praktikës fetare njeriu edukohet si të solidarizohet me njëri tjetrin. Ndër shekuj solidarizimi te shqiptarët ka pasur ndikime pozitive në afrimin dhe unitetin mbarë kombëtar.¹²⁴ Udhëzimi fetar i kushton rëndësi të veçantë formësimit individual, familjar dhe shoqëror.

Në formimin e karakterit ndikon familja si mjet kryesor, nëpërmjet të cilit formimi psikik i fëmijës orientohet kah shoqëria që e rrethon. Zhvillimi i karakterit lidhet me përshtatjen e strukturës shoqërore; në fillim përmes familjes dhe pastaj përmes kontaktit të drjetpërdrejtë me jetën shoqërore.¹²⁵ Respektimi i prindërve, i më të moshuarve, lehtësimi i brengave, mbajtja e premtimeve janë vlera sublime të karakterit fetar. Religjionet ndërmjet veti kanë elemente dalluese dhe të përbashkëta. Në të kaluarën njerëzimi më tepër është përqëndruar në dallimet mes religjioneve, ndërsa tani më tepër i kushtohet rëndësi elementeve të përbashkëta të tyre. Fetë monoteiste kanë shumë elemente dhe rrënjë të ngjashme.¹²⁶ Ngjashmëritë më të theksuara janë: Besimi në Zot, kuptimi i njeriut, ardhmëria e përbashkët, shpallja e librave të shenjtë nga Zoti, ndalesat e njëjta, fillimi i përbashkët, etj.¹²⁷

Religjionet monoteiste duke u thirrur në profetin Ibrahim, pohojnë se kanë një fillim të përbashkët dhe mund të bashkohen në një pikë të përbashkët. Ky realitet ka sjellë shumë suksese në tavolinat dialoguese dhe ka shkaktuar një afrim të rëndësishëm, posaçërisht në mes të krishterëve dhe muslimanëve. Kur'an i bën me dije se muslimanët i ftojnë ithtarët e Librit (të krishterët dhe çifutët) të bashkohen në një bazë të përbashkët.¹²⁸ Thuaju (o i dërguar): *"O ithtarë të librit (Tevrat e Inxhil), ejani (të bashkohemi) te një fjalë që është e njëjtë (e drejtë) mes nesh dhe mes jush: të mos adhurojmë tjetër pos All-llahut, të mos i shoqërojmë Atij asnjë shok, të mos konsiderojmë njëri - tjetrin zotër pos All-llahut!..."*¹²⁹

Bazuar në parimin se fetë monoteiste janë të karakterizuara si universale që kanë për synim prioritar mbrojtjen e njeriut dhe vlerat themelore njerëzore,¹³⁰ lindja dhe perëndimi, sidomos në epokën e mbrojtjes nga destruktioni masiv, duhet ti tregojnë njëri tjetrit më tepër tolerancë për tu mbrojtur paqja botërore. Më së miri është që perëndimi të nis të kuptojë

¹²⁴ Morina, *Identiteti fetar i shqiptarëve*, fq. 6.

¹²⁵ Fromm, Erich, *Nëntë skica psikologjike, Dy Lindje dhe dy Perëndime*, Tiranë, 2005, fq. 182.

¹²⁶ Mojzes, Poll & Svidler, Leonard, *Ndërtimi i besimit përmes dialogut ndërmjet kishave dhe bashkësive fetare në Maqedoni*, Philadelphia, 2004, Shkup, 2004, fq. 121.

¹²⁷ Po aty, fq. 122.

¹²⁸ Po aty.

¹²⁹ Kur'an, 3:64.

¹³⁰ Gyndyz, Shinasi, *Dhuna fetare*, BIK, Prishtinë, 2005, fq. 13.

islamin, e islami perëndimin.¹³¹ Ka arsye për shpresë, sepse sot religjionet nuk janë si dikur të kthyer nga vetvetja dhe shumë prej tyre kërkojnë mirëkuptim reciprok.¹³² Shqiptarët të pajisur me këto cilësi, gjithmonë kanë kultivuar dhe manifestuar një zhvillim suksesiv të jetës së përbashkët ndërfaqetare duke mos patur asnjëherë zënka dhe konflikte ndërfaqetare. Vetëdija toleruese ndërfaqetare te shqiptarët gjithmonë është kurrorëzuar me arritje të mëdha në rrafshin politik dhe kjo vetëdije ka ndikuar në integrimin brenda shqiptar. Shqiptarët i përkasin fesë islame, katolike dhe ortodokse. Në Shqipëri, Maqedoni, Kosovë, Preshevë, Medvegjë, Bujanovcë dhe Çamëri shqiptarët me shumicë janë të besimit islam, ndërsa në Mal të Zi janë me shumicë të besimit krishterë. Migrantët shqiptarë në Gjermani poashtu kanë identitete fetare të ndryshme, ndërsa në Leverkusen ata janë me shumicë absolute të identitetet fetar islam.¹³³

Mbrojtja e besimit dhe e spiritualitetit islam, sigurimi i një ushtrimi real, të denjë e të vazhdueshëm të islamit pa kufizime, promovimi dhe mbrojtja e familjes dhe e vlerave të lidhura me të, garantimi i arsimimit fetar dhe shekullar, ofrimi i mjeteve të ligjshme për të punuar dhe fituar, ju mundëson atyre të bëhen të pavarur dhe jo barrë e shoqërisë. Përmes proceseve integruese paraqiten përparësitë më bazike për të cilat duhet gjetur zgjidhje.¹³⁴ Kjo tregon se është me rëndësi të punohet njëkohësisht në disa fusha të ndryshme fetare, sociale dhe arsimore, por edhe të përfshihet në politikë dhe ekonomi. Të mbrohen të drejtat e qytetarëve në përgjithësi dhe të muslimanëve në veçanti kur janë në pikëpyetje liria, puna, tregtia e të ngjashme.¹³⁵ Njëra prej sfidave më domethënëse intelektuale, me të cilën ndeshen shoqëritë muslimane sot, është të ecin në një hap me përparimin shkencor të kohës sonë.¹³⁶ Të promovohet e të mbrohet një pjesëmarrje e këtyllë në shoqërinë perëndimore nuk është diçka e re dhe e vështirë, por kërkon që disa çështje juridike dhe çështje etike të prekshme të marrin si parakushte esenciale, përgjigje dhe zgjidhje të qarta.¹³⁷

¹³¹ Hofmann, Murad, *Islami si alternativë*, Furkan ISM, Shkup, 2000, fq. 23.

¹³² Bucaille, Maurice, *Bibla, Kur'ani dhe shkenca*, Sh.K.B. Shpresa e Kosovës, (pa vit botimi) Gjakovë, fq. 130.

¹³³ radiokosovaelire.com, Nurellari, Adri, *Shkombëtarizimi i shqiptarëve dhe roli i komuniteteve fetare*, (11.12.2011)

¹³⁴ Ramadan, Tarik, *Të jesh musliman Evropian*, Logos-A, Shkup, 2011, fq. 70.

¹³⁵ Po aty.

¹³⁶ Açıkgenç, Alparslan, *Mendimi shkencor dhe barrët e tij*, Logos-A, Shkup, 2006, fq. 13.

¹³⁷ Ramadan, *Të jesh musliman Evropian*, fq. 70.

Kapitulli III.

DIMENSIONET E IDENTITETIT TË MIGRANTIT SHQIPTAR DHE INTEGRIMI I TIJ NË SHOQËRINË E LEVERKUSENIT TË GJERMANISË

1. Migranti shqiptar dhe gjendja e identitetit të tij në procesin e integrimit në shoqërinë e Leverkusenit

Shoqëritë perëndimore si bazë të standarteve të larta demokratike përqendrohen në kujdesin e respektimit të bashkësive etnike, kulturore, fetare dhe sociale.¹³⁸ Jeta multikulturore tani më është përditshmëri në shoqërinë gjermane. Shoqëritë multikulturore edhe pse kanë histori, tradita dhe përvoja të ndryshme, mundohen të ndërtojnë marrëdhënie normale për bashkëjetesë. Konjuktura strategjike e migrantëve tash është përqendruar në respektimin e vlerave dhe normave multietnike.

Në kohën e globalizimit, të drejtat multietnike dhe multikulturore kanë marrë përmasa ndërkombëtare në shoqëritë e zhvilluara demokratike, veçanërisht në Gjermani. Edhe shoqëritë shqiptare janë pjesë e këtij demokratizimi ngase jeta e përbashkët multietnike dhe multikulturore është realitet i shoqërive nga vijnë migrantët shqiptarë. Shqiptarët njëherit janë edhe shembulli më unik për politikën perëndimore në projektimin e jetës kolektive dhe individuale. Nga fakti se shqiptarët jetojnë me përmasa të konsiderueshme në shtetet europiane, gjegjësisht në Gjermani, janë pjesë e kombit të cilët ruajnë dhe kultivojnë identitetin e tyre duke realizuar të drejtat e tyre përmes standardeve të diasporës apo komunitetit me identitet të ndryshëm kulturor¹³⁹, kombëtar, etnik dhe fetar.

Shqiptarëve, për të mbrojtur identitetin e tyre, ju ka ndihmuar shumë respektimi i kulturave tjera. Toleranca, respektimi i kulturave tjera dhe pranimi i tjetrit, shqiptarëve ua ka mundësuar që të jenë shumë të kuptueshëm dhe të pranuar nga perëndimi. Për të siguruar dhe manifestuar të drejtat demokratike në vendet nga ato vijnë por edhe aty ku jetojnë. Ajo që karakterizon debatin politik gjatë proceseve të integrimeve europiane me siguri është diskursi i identitetit të popujve të cilët duan të integrohen. Në këtë rast më pak shikohet identiteti etnik e më tepër ai fetar dhe ate te popujt e mëdhenj.¹⁴⁰ Për integrim të mirëfilltë në strukturat europiane duhet përgatitur dhe adaptuar shumë aspekte të organizimit shoqëror. Nganjëherë duke prekur këto aspekte vlerat kombëtare dhe fetare shndërrohen në të dhimbshme.

¹³⁸ Seyran, Ates, *Der Multikulti-Irrtum*, Ullstein Verlag, Berlin, 2007, fq. 7.

¹³⁹ Gashi, Osman, *Mësimdhënia e letërsisë dhe perspektivat e multikulturalizmit*, Blendi, Prishtinë, 2009, fq. 9.

¹⁴⁰ Po aty.

Qytetërimi perëndimor me një dinamikë të fuqishme të lëvizjes, ia vështirëson atij që jeton në Europë të përcakëtojnë se çfarë është ai ose ajo. Mediat, kultura popullore, muzika, kinemaja, etj. shërbejnë për proklamimin e koncepteve mbi shoqërinë, individin, moralin dhe lirinë.¹⁴¹ Këto proklamime spontanisht depërtojnë në zemrën dhe mendjen e migrantit duke ja bërë gjithnjë e më komplekse përgjigjen në pyetjen; kush jemi ne?¹⁴² Një pjesë e migrantëve thonë: „Po, ne jemi pjesë e Perëndimit“ një pjesë tjetër thonë: Jo, ne kemi kulturën tonë të veçantë“.¹⁴³ Sociologë dhe antropologë, ndër ta Max Weberi, Emile Durkheim, etj. kanë analizuar qytetërimet duke krijuar një literaturë të mjaftueshme për të krahasuar konceptet e qytetërimeve të shumta. Mendimtarët gjermanë të shekullit nëntëmbdhjetë kanë dalluar termin qytetërim nga ai kulturë. Sipas tyre qytetërimi përfshinë mekanikën, teknologjinë dhe gjithë faktorët materialë, ndërkaq kultura përfshinë vlerat, idealet dhe cilësitë e larta intelektuale, artistike e morale të shoqërisë.¹⁴⁴

Për mendimin e Bordelit, qytetërimi „është një hapësirë, një zonë kulturore“. Sipas Dowsonit, qytetërimi është produkt i një „procesi origjinal të veçantë krijimtarie kulturore që është vepra e popullit të caktuar“. Durkheim dhe Mauss, qytetërimin e karakterizojnë me „një lloj mjedisi moral, që rrethon një numër të caktuar kombesh, e secila kulturë kombëtare është vetëm formë e veçantë e së tërës“. Edhe pse ka ndryshime ndërmjet këtyre definicioneve rreth qytetërimit megjithatë ekziston një „përputhje e arsyeshme“. Për mendimin e Huntigtonit qytetërimet kryesore të sotme janë: Qytetërimi Sinik, qytetërimi Japonez, qytetërimi Hindu, qytetërimi Islamik, qytetërimi Ortodoks, qytetërimi Perëndimor, etj.¹⁴⁵

Nëse analizohet aspekti kulturor si një element bazë për integritime europiane, gjenden artikulime të formave të ndryshme. Krijohet një antipati për vlerat e trashëguara kulturore duke i konsideruar si të papërshtatura apo të vjetëruara për integrim. Për tu arsyetuar ky qëndrim gjenden arsye nga më të ndryshmet, psh. kjo nuk është e pastër shqiptare, ka prejardhje të huaj, kjo kulturë pengon proceset, etj. Mbase me të drejtë mund të thuhet se adaptimi i kulturave ka për qëllim shkrirjen e kulturave të vogla në të mëdhat, ngase kjo shkurton rrugën drejt integritimit e që njëherit konsiderohet edhe katalizatorë për ndryshime pozitive. Është më se e vërtetë se shqiptarët akoma nuk bëjnë dallime në mes të aspekteve kulturore që ndërlidhen me vlerat kombëtare dhe fetare si trashëgimi kulturore dhe standardeve kulturore europiane si kusht për integrim. Nuk kërkohet tjetërsimi i kulturës

¹⁴¹ Ramadan, *Të jesh mysliman Evropian*, fq. 18.

¹⁴² Po aty.

¹⁴³ Huntigton, *Përplasja e qytetërimeve dhe ribërja e rendit botëror*, fq. 44.

¹⁴⁴ Po aty, fq. 38.

¹⁴⁵ Po aty, fq. 42.

familjare, por përmirësimi i kulturës institucionale, nuk kërkohet tjetërsimi i historisë por përmirësimi i cilësisë së arsimit, nuk kërkohet tjetërsimi i ekonomisë familjare por përmirësimi i ekonomisë vendore.

Përmes këtyre shembujve kuptohet se shqiptarëve për tu integruar ju duhet që kulturën ta fusin në sistem. Përveç aspektit të kulturës, aspektet tjera që kanë të bëjnë me gjendjen e shqiptarëve gjatë proceseve të integrimit janë edhe:

- Transformimi i brendshëm,
- Projektimi i politikave të avancuara demokratike,
- Gjuha dhe shija e dialogut,
- Plotësimi i shprazëtirave të krijuara nga sistemi i kaluar,
- Shërimi i plagëve që pengojnë proceset e integrimit,
- Dallimi mes botëkuptimeve orientale dhe oksidentale.

Çdo përpjekje normale dhe e pangarkuar ideologjikisht kundër filozofisë së integritimeve europiane është e dobishme në proceset integruese. Ky objektivi politiko-ekonomik i shqiptarëve është dëshirë serioze dhe e kahmotshme. Pak ka nevojë për koncepte të reja me qëllim të përfitimeve politike nga politikanët sezonal që duan të përfitojnë kredo politike. Më tepër ka nevojë për realizim të koncepteve të hartuara që më herët.

Në vitin 1906 shkrimtari, dijetari dhe teologu i shquar shqiptar Rexhep Voka, hartoi konceptet e përparimit dhe të asaj që sot i thuhet plotësim i standardeve për integritime europiane. Ky dijetar kishte një ëndërr, që të sheh popullin e vet të përparuar dhe të integruar. Sa për ilustrim do të përmendim me sa vijon:

A nuk po na shohin sytë se tërë bota hyri në kadife e në mëndafsh,

E ne... e ne s'jemi kah vejmë në trup brekë e këmishë.

Tani, ne që jemi popull shqiptarë, duke qenë në këtë vend më shumë,

Më të fortë dhe më të vjetër, sot, mos Zot më keq! Kemi mbetur

Pa mësim e arsimim, nga të gjithë tjerët më të fundit jemi.

Nuk duan të na njohin dhe të na pranojnë se jemi gjallë,

As popujt që i kemi këtu brenda, as Evropa.¹⁴⁶

¹⁴⁶ Voka, Rexhep, *Mendime*, K,B,I, Tetovë, 1991, fq. 11.

2. Faktorët ndikues në mbrojtje të identitetit

Deri në ditët tona me një traditë shekullore është ushtruar një ndikim qenësor në mbijetesën dhe formësimin e identitetit. Faktet historike dëshmojnë për tendencat e njëpasnjëshme të pushtuesve me qëllim asimilimin e elementeve të identitetit kombëtar dhe fetar. Rol të rëndësishëm për mbrojtjen e identitetit kanë luajtur disa faktorë të cilët duhet potencuar dhe argumentuar me fakte dhe burime të sakta, në këtë punim veçohen këta faktorë:

2.1. Emancipimi kombëtar si faktor në mbrojtjen e identitetit

Bota e civilizuar në kohën e globalizimit ka specifika moderne. Edhe pse shumë popuj kanë zgjedhur problemet e tyre kombëtare, ka të tillë që akoma rreth çështjes kombëtare kanë dilema, objektivisht specifikat moderne preokupojnë edhe shqiptarët. Ecuritë e proceseve ekonomike, politike dhe diplomatike ndikojnë në proceset e emancimit kombëtar. Kjo ndodhë si rezultat i dëshirës për depërtim në tregun global përmes popujve të mëdhenj dhe më me famë.¹⁴⁷ Këtë e vërteton rasti i migrantëve shqiptarë të cilët preferojnë shtetësinë e re.

Okupimi klasik i shqiptarëve dhe shtypja shekullore ka shkaktuar daljen në skenë të dëshirave, appetiteve të tilla. Status-quoja e një pjese të kombit shqiptar e cila nga dita në ditë veç sa thëllon hendekun e hutisë kombëtare paraqet rreziqe të reja që mund të lindin nga momenti në moment. Integrimet europiane nuk mund ti ngopin appetitet ballkanike.¹⁴⁸ Intelejjenca kombëtare shqiptare e din se janë të pazgjidhura shumë çështje madhore, të pazgjidhura janë edhe të drejtat elementare të një pjese të kombit. Të pazgjidhura janë edhe e drejta për shtetësi, shtetësi të dyfishtë, pakënaqësitë e migrantëve nga administrata e vendit të origjinës janë aq të mëdha dhe shqetësuese sa që në moment ndikojnë për marjen e një vendimi frustrues.

Në vazhdim paraqiten disa elemente më ndikuese për emancipimin kombëtar të migrantëve si faktorë mbrojtës të identitetit:

1. Integrimi i brendshëm. Ka për qëllim integrimin e migrantëve duke ju dhënë mundësi për formim profesional dhe përgatitje të mëtejme. Synimi është që kjo të jetë një paketë e plotë duke përfshirë të dy gjinitë në integrimin e brendshëm profesional,

¹⁴⁷ Aliu, Bashkim, *Karakteristikat e sistemit ekonomik islam*, Furkan ISM, Shkup, 2005, fq.110.

¹⁴⁸ Pirraku, Muhamet, *Kthenia kombit shqiptar atë që i takon nga natyra-për hirë të paqes në ballkan*, Ftesa, nr. 13, Gostivar, 1999.

social dhe kulturor. Prgatitja profesionale ndikon në zhvillimin emocional dhe psikologjik të migrantit.

2. Krijimi i organizmave me karakter kombëtar. Një numër i madh organizatash të njohura ndër migrantët me emrin „shoqata“, tanimë janë mbyllur apo nuk kanë një rol të rëndësishëm për koordinimin e migrantëve. Mbetet detyrë e intelektualëve jashtë atdheut për tu angazhuar në themelimin e organizatave, shoqatave, fondacioneve, etj. me karakter kombëtar. Këto organizata duhet të koordinojnë veprimtaritë për integrimin e migrantëve shqiptarë në shoqërinë përkatëse, njëherit duhet të përfaqësojnë interesat e tyre në vendlindje.
3. Riparimin e qëndrimeve ndaj politikave të vendit të origjinës. Veprimet e politikës publike në vendet e origjinës në shumicën e rasteve nuk pëlqehen nga migrantët. Kjo vjen si rezultat i krahasimit të politikës së vendit pritës me atë të origjinës. Në këtë drejtim mungon edhe komunikimi i mirëfilltë i politikës së origjinës me migrantët.
4. Zhdukjen e lokalizmave. Lokalizmi duke qenë sjellje e një kulture etnocentrike shpie drejtë një fenomeni i cili lind paragykime. Paragykimet shtyejnë njerëzit e një kombi, të një gjuhe dhe të një gjaku të formojnë sjellje diskriminuese. Migrantët preokupim kryesor kanë mbrojtjen nga shfaqja e lokalizmit në mesin e tyre.
5. Akceptimi i vlerave të përbashkëta kombëtare. Migrantët shqiptarë kudo që jetojnë dhe veprojnë duhet më tepër të vetëdijësohen dhe ndërgjegjësohen ndaj vlerave të përbashkëta madhore të kombit. Në 100 vjetorin e pavarësisë së kombit duhet të nderohen dhe akceptohen përpjekjet dhe sakrificat e kombit shqiptar që nga Lidhja e Prizrenit e deri më sot.¹⁴⁹

2.2. Emancipimi fetar si faktor në mbrojtjen e identitetit

Shqiptarët si popull tre konfesional me një shkallë të lartë emancipimi rezistuan ndaj pushtuesve të cilët dëshironin ti asimilonin. Duke qenë fillimisht shqiptarët popull me besim pagan, kalojnë në krishterizëm për të gjetur faktorë dhe elementë të cilët do ti mbronin nga tjetërsimi. Gjatë kohës së tranzicionit, te një popull i cili akoma nuk është formësuar dhe kompletuar si duhet, lehtë ndodhin ndryshime të pa kontrolluara të cilat më vonë kanë ndikime negative në aspektin kombëtar dhe fetar. Shqiptarët duke pranuar islamin si fe masovikisht në kohën e Perandorisë Osmane, ngrenë vetëdijen kombëtare dhe fuqizojnë

¹⁴⁹ Ballkanweb.com, *100 vjetori i Pavarësisë, viti i të vërtetave historike*, (13.02.2012).

identitetin e tyre. Kështuqë përmes besimit fillon edhe emancipimi intelektual, kulturor, social, etj.

Implementimi i plotë i dispozitave fetare krijon rrethana të përshtatshme për një edukim të mirëfilltë dhe mbron nga ngecja transformuese. Implementimi i këtyre dispozitave shpëton popullatën nga indoktrinimi i së drejtës zakonore. Rezultati i këtyre provave jepet me rastin e transformimit real të shqiptarëve në vetëdijësimin kombëtar, fetar dhe kulturor. Me këtë realitet nuk pajtoheshin të gjitha programet politike shqiptare. Kishte të tilla rryma politike „sllavofile“ shqiptare¹⁵⁰ që do të bashkëpunonin me shtetet fqinje mbi këtë bazë: „Armiku kryesor i shqiptarëve është Perandoria Osmane, propagandë e politikës serbe për ti futur shqiptarët në luftë me Perandorinë Osmane për përfitime të nacionalizmit serb“.¹⁵¹ Shqiptarët e kësaj kohe, të cilët ishin me shumicë të besimit islam, edhe pse e kundërshtonin administratën e Perandorisë Osmane, ata më tepër shfaqnin kundërshtimin për bashkëpunimin me kristianët.¹⁵²

Emancipimi i drejtë fetar i mërgatës shqiptare krijon një lëvizje indpendente me synim afirmimin e identitetit kombëtar në rrethin e gjërë europian të shoqërisë gjermane të stërm bushur me patriotizëm kombëtar dhe fetar. Duke analizuar me kujdes përpjekjet e personaliteteve shqiptare të mërgatës, kuptohen vështirësitë organizative të cilat duhet kultivuar në mënyrë që të ketë një ekuilibër mes transformimit të brendshëm dhe integritit të jashtëm.

Migrantët shqiptarë të cilët poashtu iu përkasin feve të ndryshme, përmes tolerancës mundësojnë realizimin e projekteve unike për integrim në shoqërinë gjermane, gjegjësisht të asaj në Leverkusen. Barrën kryesore të këtyre projekteve unike për integrim në shoqërinë gjermane e bartë vetë mërgata shqiptare dhe elita intelektuale e saj, që në rastin e Leverkusenit janë të besimit islam. Përpjekjet e migrantit për të mbrojtur identitetin dhe për të zgjeruar të drejtat tradicionale, përballen me programe reformiste përmes së cilave nganjëherë kërkohet imponimi i elementit vendas. Kjo më së miri mund të shihet me rastin e festave fetare kristiane, nëpër të cilat në emër të integritit kërkohet edhe pjesmarrja e migrantit, posaçërisht shkollarëve.

Vendi ku migranti shqiptar mund t'i realizojë këto projekte me siguri për momentin është thuajse vetëm xhamia, vend ky ku tubohen më së shumti mërgimtarët në diasporë. Emancipimi i drejtë fetar ka një rëndësi të madhe për të ruajtur migrantin nga asimilimi, ngase

¹⁵⁰ Feraj, Hysamedin, *Skicë e mendimit politik shqiptar*, Logos-A, Shkup 1999, fq.125.

¹⁵¹ Po aty, fq.125.

¹⁵² Po aty, fq.126.

mësimet fetare, gjegjësisht islame dallojnë formësimin kombëtar nga ai fetar ashtu si edhe i dallojnë simbolikat e tyre.¹⁵³

2.2.1. Statistikat përshkruese të njohurive fetare te migranti shqiptar në Leverkusen

Gjërësia e këtij punimi përfshinë edhe hulumtimin rreth gjendjes fetare të migrantit shqiptar. Tabela nr.11 jep të kuptohet se migrantët shqiptarë në Leverkusen nga 116 të anketuar, 108 (93,1%) prej tyre deklarohen se janë të besimit islam. Nga ky fakt edhe statistikat përshkruese pasqyrojnë njohuritë fetare islame të migrantit shqiptar.¹⁵⁴ Debati politik dhe shoqëror ndaj fesë islame është bërë objekt polemikash nganjëherë edhe të ashpra¹⁵⁵, kryesisht ndërmjet konservatorëve të djathtë dhe ekstremistëve të djathtë, e që shfrytëzohet për përdorime propagandistike, migrantin shqiptar e bëjnë edhe më të bindur ndaj identitetit të tij fetar. Në bazë të arriturave nga ky hulumtim fillimisht mund të konstatohet se ka të bëjë me një koncept të shëndoshë të të anketuarve ndaj identitetit fetar. Për dallim nga vlerësimi me notë i njohurive gjuhësore, njohuritë fetare u vlerësuan me attribute sasiore të cilat në vete përmbajnë edhe atributet cilësore. Me këtë rast paraqitet nga të anketuarit se njohuritë fetare në krahasim me njohuritë gjuhësore qëndrojnë më mirë, sidoqoftë dimensionet e njohurive fetare të migrantit shqiptar në Leverkusen rezultojnë me këto statistika përshkruese.

Migrantët shqiptarë dimensionit të njohurive për obligimet fetare i dhanë këto vlerësime: nga 116 të anketuar, 63 prej tyre (54,3%) vlerësuan se shumë i njohin obligimet fetare (konceptin e legjislacionit fetar, konceptin e dogmës, konceptin e adhurimit, konceptin e perfeksionit, etj.)¹⁵⁶ Njohuri mesatare për obligimet fetare kanë 49 të anketuar (42,2%) dhe vetëm 4 të anketuar (3,5%) kanë njohuri minimale për obligimet fetare. Praktikimi i obligimeve fetare është vlerësuar më tepër me mesatarisht 69 të anketuar (59,5%), më pas me shumë e kanë vlerësuar 35 të anketuar (30,1%) dhe së fundi 12 të anketuar (10,4%) pohojnë se fenë e praktikojnë minimalisht.

¹⁵³ Roald A. Hysa, Eduart Thartori, *Integrimi i shqiptarëve në Evropë dhe vlerat që Islami i përcjell në këtë integrim*, Forumi Musliman i Shqipërisë, Tiranë, 2008, fq. 10.

¹⁵⁴ Shih Shtojca, Tabela nr. 11.

¹⁵⁵ Ibn Warraq, Taslima Nasreen: *Warum ich kein Muslim bin (Pse nuk jam musliman)*, Matthes & Seitz Berlin, Berlin, 2004, fq. 33.

¹⁵⁶ Shih Shtojca, Tabela nr. 22.

Migranti shqiptar në Leverkusen ka mundësi të praktikojë fenë islame njëjtë si në vendlindje. Thuhet kështu ngase ai posedon edhe xhaminë reprezentative të ndërtuar prej themeli nga dora e vet migrantit, njëherit edhe e para e këtij lloji në diasporën perëndimore.¹⁵⁷ Përkrahja ka një dimension krejtësisht tjetër, ajo nuk ka të bëjë me dimensionin e njohurive dhe praktikës fetare. Përkrahja denjësisht bazohet në ngritjen e vetëdijes së identitetit fetar. Nga këto rezultate del në shesh se 85 të anketuar (73,2%) e përkrahin fenë e tyre shumë. 29 të anketuar (25%) e përkrahin fenë e tyre mesatarisht dhe vetëm 2 të anketuar (1,8%) ndajnë mendimin se fenë e tyre e përkrahin minimalisht.¹⁵⁸ Përmes dimensionit të përkrahjes fetare migranti shqiptar nënkupton përkrahjen morale dhe materiale për mirëmbajtjen e institucioneve arsimoro-fetare, jo vetëm në diasporë por edhe në vendin e origjinës.

3. Shqiptarët dhe modeli i identitetit të tyre

Globalizimi marramendës i botës në një formë krijon kriza për identitetin kombëtar dhe fetar, në anën tjetër globalizimi i botës vazhdon të këpusë lidhjet ndërmjet identiteteve dhe kulturave lokale. Sipas Gylenit, në kulturën e ditëve tona, nuk është e lehtë të dëshmohet një inteligjencë e thellë për këto ndjenja dhe vlera njerëzore, nuk mund të gjenden lehtë në mendimin grek apo latin dhe në filozofinë perëndimore.¹⁵⁹ Globalizimi ka një kuptim ideologjik. Dikush e sheh të jetë një imperializëm klasik me një emër tjetër, sidoqoftë globalizmi ka shkaktuar një ndryshim fundamental në shumë fusha, nisur nga ato ekonomike, shkencore, politike, ligjore, etj. Gjegjësisht globalizimi ka vulgarizuar pasurinë, teknologjinë, pluralizmin demokratik, prodhimin si dhe konsumin. Janë globalizuar edhe ndotja ekologjike, armët e shkatërrimit në masë, terrorizmi dhe violenca.¹⁶⁰

Duke qenë këto probleme të qytetërimit modern që çojnë në mbështetje të tezave të konflikteve, janë bërë dhe bëhen përpjekje serioze për të vënë në përputhje shoqëritë me kultura dhe qytetërime të ndryshme, e kjo mëton të realizohet përmes demokracisë, dialogut dhe tolerancës.¹⁶¹ Migrantët shqiptarë globalizimi mund ti shpie në zbehjen e vlerave kombëtare dhe fetare për shkak të transformimit të brendshëm shoqëror dhe kulturor.

¹⁵⁷ Nga ky moment shfrytëzoj rastin që edhe të falenderoj në emër të migrantëve shqiptarë të gjitha entet komunale dhe përfaqësuesit komunal si dhe politikën që mundësuan lejimin e ndërtimit të këtij kulti, që i shërben pa dyshim në rradhë të parë mundësisë për praktikim të fesë por edhe proceseve integruese.

¹⁵⁸ Shih Shtojca, Tabela nr. 22.

¹⁵⁹ Gülen, Fethullah, *Drejt një qytetërimi botëror me dashuri & tolerance*, Prizmi, Tiranë, 2007, fq. 37.

¹⁶⁰ Po aty, fq. 15.

¹⁶¹ Po aty, fq. 16.

Zëvendësimi i vlerave dhe normave kulturore sjellë një atmosferë të zymtë në organizimin kulturor të mërgatës shqiptare. Nuk ka dyshim se në këtë situatë identiteti shqiptar nuk është pa probleme dhe ndikime të jashtme.¹⁶²

Parapëlqimi i modeleve të huaja sociale, gjegjësisht modelin social të shoqërisë kontaktuese, konceptin e identitetit personal e shndrojnë në dytësorë, kështu fillojnë të shfaqen modele të shumta në një shoqëri me një trashëgimi kulturore të bujshme dhe shumë të pasur. Aplikimi i standardeve të dyfishta apo të trefishta ndikon në formimin e një identiteti tanimë të ndryshëm nga ai ekzistues. Kjo nuk ndodh vetëm me bashkësinë shoqërore të mërgatës shqiptare por edhe me atë të vendit të origjinës. Pa mos akuzuar dikend me plotë të drejtë mund të thuhet se synohet të krijohet një identitet alternativ, drejt realizimit të këtij synimi, por për momentin në shoqëritë e mërgatës mungon personaliteti karizmatik për tërheqjen e masave të njerëzve. Në emër të integritetit punohet për përgatitjen e terrenit për çdo formë të mundshme që këto metoda të bëhen legjitime.

Migrantët janë të përgatitur për kundër përgjigje në bazë të logos „integrim po, asimilim jo“. Migrantët shqiptarë edhe pse përfaqësohen me modele të ndryshme ata për shkak të kësaj nuk ndeshen me identitetin bazë të unitetit kombëtar dhe fetar, përkundrazi një shtrirje e tillë ata i çon drejt integritetit më të shpejtë. Modeli i identitetit të migrantit shqiptar është i ndërtuar mbi vlerat kombëtare, fetare dhe ndikimeve të huaja, në rastin e migrantëve shqiptarë në Gjermani po pëlqehet edhe elementi gjerman.¹⁶³ Modeli i identitetit kombëtar tek migrantët shqiptarë e merr formën nga eksperiencia e trashëgimisë kombëtare dhe vlerave të trashëguara familjare dhe shoqërore, ndërsa modeli i identitetit fetar formësohet nga parimet e konfesionit gjegjës.¹⁶⁴ Fakti që te migrantët shqiptarë shfaqet edhe modeli i identifikimit me vlerat dhe kulturën gjermane ka trajtën e identitetit individual.

4. Modeli tre dimensional i identitetit të shqiptarëve në procesin e integritetit

Dimensionet e modelit të identitetit të migrantit shqiptar në procesin e integritetit european paraqiten më tepër si fenomen religjioz. Edhe pse shqiptarët janë të përfaqësuar me tre fe, ata më tepër në shoqërinë gjermane njihen si musliman, kështuqë edhe në qytetin e Leverkusenit shqiptarët janë vetëm të konfesionit islam. Ajo e cila hulumtohet në këtë punim është gjetja e baraspeshës mes modeleve të identitetit të migrantit shqiptar, në mënyrë që të

¹⁶² beepworld.de, *Identiteti kosovar nuk është identitet kombëtar*, (26.10.2012).

¹⁶³ Hysa & Thartori, *Integriteti i shqiptarëve në Evropë dhe vlerat që Islami i përcjell në këtë integrim*, fq. 17.

¹⁶⁴ Po aty, fq. 17.

ketë harmoni në manifestimin e tyre shoqëror duke i ruajtur tiparet dhe karakteristikat e çdonjërit model. Migrantët shqiptarë identitetin e tyre e prezantojnë përmes modeleve të cilat identifikohen me:

- Kulturën kombëtare
- Kulturën gjermane
- Kulturën fetare

4.1. Identifikimi i migrantëve shqiptarë me kulturën kombëtare

Është kënaqësi të identifikohesh me kulturën kombëtare për ti siguruar vetes dhe familjes, shoqërisë dhe kombit një privilegj dhe reputacion ndërkombëtar. Krahas këtyre përpjekjeve të vazhdueshme në të gjitha sferat e jetës, avancojnë mundësi për ngritje standardesh në të gjitha fushat e jetës si ekonomike, politike dhe civilizuese. Me një përpjekje të tillë edhe kombi i civilizuar shqiptar hyn në përfaqësimin kulturor të kulturave oksidentale dhe orientale.

Secili popull ka të kaluarën e vet, të tashmen dhe të ardhshmen, mbi këtë koncept për realitetin e migrantit shqiptar ka shtresime me kuptime të shumta. Një pjesë e migrantëve edhe pse kanë pasur një të kaluar të vështirë dhe me varfëri të skajshme, ata ndaj saj kanë një vështrim serioz duke patur premisa të shëndosha si pikëmbështetje për të ardhmen. Një popull me objektiva të qarta, i emancipuar, i edukuar, konstrukton të tashmen dhe të ardhmen e vet dhe të fëmijëve mbi bazë të kulturës së vet kombëtare, prandaj edhe realiteti i migrantit shqiptar duhet të jetë i tillë. Për një konstruktiv të tillë pengesat janë të natyrave të ndryshme si ato psikologjike, politike, ekonomike dhe kulturore. Transformimet esenciale në këtë rast hapin debate të brendshme familjare duke u ballafaquar gjeneratat mes veti. Ajo me të cilën gjeneratat mes veti ballafaqohen në fakt është modernizmi që ka shtënë egoizëm në qeniet njerëzore. Modernizmi nxit individualitetin, materializmin dhe instiktet vetjake të njerëzve në kundërshtim me shoqërinë. Kështuqë i largon njerëzit nga gjithçka që ata mbajnë të shenjtë, humane dhe etike.¹⁶⁵

Gjatë debateve të ballafaqimit të brendshëm familjar, rol vendimtar kanë vlerat dhe normat kulturore kombëtare si dhe ndërlidhshmëria me të gjitha ngjarjet e dhimbshme nëpër të cilat ka kaluar kombi. Këto debate përcaktojnë dukshëm vullnetin e migrantit për tu identifikuar me kulturën kombëtare. Debati i përcaktimit të ardhmërisë kombëtare në migrim është problem qenësor i së tashmes në përcaktimin kulturor dhe përmbushje e obligimeve

¹⁶⁵ Gülen, *Drejt një qytetërimi botëror me dashuri & tolerance*, fq. 17.

familjare ndaj shtresimeve të identitetit. Opinioni i përgjithshëm kohëve të fundit ka aktivizuar një debat rreth identifikimit me kulturën kombëtare. Diskutohet rreth trajtimit të çështjes si përplasje të identifikimeve që janë shfaqur në shoqërinë gjermane. Kësaj teme të „nxehtë“ dhe shumë delikate nuk mund ti shpëtojë edhe migranti shqiptar i cili për nga numri është i treti në qytetin e Leverkusenis. Shqiptarët edhe pse janë europian duhet një gjë të tillë ta argumentojnë, argumentimi i identitetit europian të shqiptarët natyrisht se ka pengesa.

Orientimi perëndimor i shqiptarëve ballafaqohet me shumë sfida, nganjëherë edhe të pa definuara. S'ka dyshim se sfida më e vështirë nuk ka të bëjë me të drejtën, qytetarinë dhe pjesëmarrjen shoqërore, por me thellësitë e qenies dhe kjo del si shtesë e përkufizimit të identitetit.¹⁶⁶ Nëse ka ide dhe mendime të shumta, pjesëtarë të shoqërive dhe kulturave të ndryshme, akoma mendojnë që nuk mund të arrihet në konkluzione të përbashkëta për shumë çështje, megjithëse të gjithë jetojnë në këtë botë dhe udhëtojnë në të njejtën anije.¹⁶⁷

Migrantët shqiptarë në Gjermani gjatë identifikimit të tyre ndeshen me dy kultura diametralisht të kundërta njëra me tjetrën. Ndodhitë historike kanë ndikuar që në tokën shqiptare të bashkohen kultura perëndimore dhe lindore, që në realitet shënojnë dimensionet e identitetit qytetëruar të shqiptarëve. Megjithatë për mendimin e Kadaresë dhe Qosjes shqiptarët nuk kanë konfuzione rreth dimensioneve të identitetit të tyre. Shqiptarët kanë kulturën etnike, qytetërimin etnik, civilizimin etnik,¹⁶⁸ dhe me këtë identifikim diskutojnë seriozisht për të ardhmen e përbashkët europiane. Për ti bërë qejf dikujt, shqiptarët, posaçërisht migrantët më pak kanë kohë që të merren me deshifrimin e strukturës së kulturës etnike.

Hipoteza e parë bazohet mbi qëndrimin e migrantëve shqiptarë në Leverkusen të Gjermanisë ndaj identifikimit të tyre me kulturën kombëtare. Pyetjet e hipotezës së parë janë përpiluar në atë mënyrë që migranti të ketë mundësi reale të shfaqë lirshëm identifikimin e tij me kulturën kombëtare. Për këtë arsye anketa është realizuar me shkrim dhe në mënyrë anonime, njëherit i anketuari ka dërguar anketën edhe përmes postës me qëllim që anonimiteti i tij të jetë edhe më sekret. Testi i hipotezës së parë përmban në vete ndikimet pozitive që të migranti sjellë kultura kombëtare.

Sot, kur kultura kombëtare në Gjermani përballë me kulturën perëndimore, nevojitet përpjekje maksimale për mbrojtjen e saj. Shqiptarët nga dëshira e madhe për integrim nganjëherë në mënyrë të verbër ndjekin modelet e huaja, e njejtat ndodhë edhe me një pjesë të migrantëve të cilët disi parapëlqejnë një kulturë tjetër. Sa është kjo reale dhe e vërtetë, sa janë

¹⁶⁶ Ramadan, *Të jesh mysliman Evropian*, fq. 290.

¹⁶⁷ Gülen, *Drejt një qytetërimi botëror me dashuri & tolerance*, fq. 87.

¹⁶⁸ *Identiteti kosovar nuk është identitet kombëtar*, (26.10.2012).

migrantët shqiptarë ksenocentrist shihet në rezultatet e anketës.¹⁶⁹ Në zemër të Europës të krenohesh me kulturën kombëtare është përmbajtja tjetër e hipotezës së parë. Për të manifestuar kulturën kombëtare në rradhë të parë duhet të jesh krenar që je pjesëtar i saj, përmes krenarisë migrantit i mundësohet mos ndikimi i kulturës së huaj. Nëse flitet për krenarinë si dukuri njerëzore, ajo është më e përhapur te shoqëritë e kufizuara se sa te ato të zhvilluara. Shoqërive të kufizuara gjithmonë ju është dashur që të mobilizohen individualisht si nevojë e kërkesave të kohës, kjo problematikë është justifikuar edhe te shqiptarët, gjegjësisht migrantët. Megjithatë duhet potencuar se komoditeti me kulturën kombëtare nuk ka munguar, e që njëherit konsiderohet edhe element organik i krenarisë kombëtare. Sa janë komod migrantët me kulturën e tyre kombëtare është trajtesë dhe pjesë e hipotezës së parë.

Hipoteza e parë teston lidhshmërinë e migrantit shqiptar me kulturën kombëtare. Ai nuk heziton gjatë kontakteve të veta me pjesëtarët e kulturave tjera të shfaqë tiparet e lidhshmërisë së tij me kulturën personale. Këtë një pjesë e migrantëve derisa komunikojnë me kolegë, shokë, dhe bashkëatdhetarë nuk e praktikojnë, disi ju duket edhe e vjetëruar, në raste të tilla justifikohet varfëria kulturore e personave të tillë.¹⁷⁰ Bazuar në ate se një pjesë e madhe e kombit jeton dhe vepron në mërgim ku shkëmben përvojat kulturore, kryesishtë përmes kontakteve dhe prezantimeve normale ai jep dhe merr nga kultura. Sa ndjehet krenar migranti shqiptar të identifikohet me kulturën e tij kombëtare poashtu është një detyrë e hipotezës së parë që ta justifikojë. Duke marrë nga kultura e vendit pritës dhe duke anashkaluar praktikimin e kulturës kombëtare mund të shihen dallimet në shoqëritë shqiptare të diasporës. Sot vërehen dallime të dukshme, pavarësisht sa janë ato të kërkuara dhe të nevojshme për integrim në shoqërinë përkatëse. E veçanta e hipotezës së parë është përcaktimi i identitetit kombëtar.

Shqiptarët edhe pse ndjehen pjesë integrale e vendeve pritëse ata vështirë mund të relativizojnë identitetin e tyre kombëtar. Kombi dhe shtetësia për migrantët shqiptarë nuk janë e njëjta gjë, te shqiptari dallon identifikimi me kombin dhe shtetin¹⁷¹. Migrantët shqiptarë edhe pse janë të ndërlidhur me kulturën gjermane¹⁷² ata zhvillojnë mënyra të shumta për ruajtjen e identitetit kombëtar shqiptar. Të bazuar në elemente dhe simbole të kulturës kombëtare shqiptare, migrantët janë të lidhur ngushtë me vendin e origjinës së tyre¹⁷³ dhe me krenari ndjehen shqiptarë. Mërgata shqiptare në vendet ku jeton ka si detyrë të përcjellë gjeneratë pas gjenerate të gjitha tiparet dhe vlerat e kombit. Një ndër vlerat më kryesore që

¹⁶⁹ Shih Shtojca, Tabela nr. 9.

¹⁷⁰ Po aty.

¹⁷¹ Selaci, Gëzim, *Për shqiptarët e Kosovës, kombi dhe shteti nuk janë njësoj, blog personal*, (23.11.2011).

¹⁷² Shih Shtojca, Tabela nr. 10.

¹⁷³ Po aty, Tabela nr. 12.


duhet kultivuar është edhe gjuha shqipe si mjet komunikimi në familje apo më gjërë. Sa mirë flasin, shkruajnë dhe kuptojnë shqip migrantët shqiptarë¹⁷⁴ është poashtu trajtesë e hipotezës së parë.

Komunikimi shqip dhe mësimi i gjuhës shqipe lidhet me identitetin dhe ardhmërinë e kombit. Mësuesit e gjuhës shqipe në vendet ku veprojnë, përpiqen me përkushtim që brezi i ri të mësojë gjuhën shqipe. Gjermania,¹⁷⁵ gjegjësisht qyteti i Leverkusenit dhe shtetet e origjinës kanë mundësuar një gjë të tillë përmes mësimit plotësues të gjuhës shqipe. Ajo që duhet bërë është që mbarë komuniteti shqiptar të vetëdijsohet për këtë çështje madhore.

4.1.1. Statistikat përshkruese të identifikimit të migrantit shqiptar me kulturën kombëtare

Qasja kryesore statistikave përshkruese të identifikimit me kulturën kombëtare i kushtohet analizimit funksional që përfshinë hulumtimin e gjendjes së identitetit në teren, si dhe analizimin e rezultateve në bazë kualitative dhe kuantitative. Statistikat në këtë hulumtim përshkruhen si shumë të rëndësishme për strategjitë dhe zhvillimin e identitetit kombëtar ndër mërgimtarë. Rezultatet e tabelës nr.9 ndërtojnë këtë figurë:¹⁷⁶

Figura 1: Migrantët shqiptarë dhe kultura kombëtare



¹⁷⁴ Po aty, Tabela nr. 12.

¹⁷⁵ bildung.koeln.de, *Angebote für Kinder und Jugendliche aus Familie mit Migrationshintergrund*, (25.11.2011).

¹⁷⁶ Shih Shtojca, Tabela nr. 9.

Identifikimi i migrantit shqiptar me kulturën kombëtare në Leverkusen të Gjermanisë përmes këtij diagrami varion mes 62% (72 përcaktime) deri 90% (104 përcaktime). Migrantët shqiptarë përshkruajnë vetveten e tyre duke vlerësuar se kultura kombëtare ka shumë ndikim pozitiv në jetën e tyre. Nga cilësia e përgjigjeve të dhëna në tabelën nr.9, shihet se nga 116 të anketuar, 79 prej tyre (68,1 %) përcaktohen se kultura kombëtare ka shumë ndikim pozitiv në jetën e tyre. Sa janë krenar migrantët shqiptarë me kulturën e tyre kombëtare konstatohet nga ajo se nga 116 të anketuar, 86 prej tyre (74,1%) konkludojnë se janë krenar me kulturën kombëtare. Duke u ballafaquar migrantët shqiptarë në përfundim me kultura të ndryshme, vlerësojnë se komoditetin e kulturës kombëtare nuk mund ta krahasojnë me ndonjë kulturë tjetër. Nga 116 të anketuar, 72 prej tyre (62%) konstatojnë se ndjehen komod me kulturën kombëtare.

Mes këtyre konkluzave vend të theksuar zë edhe lidhshmëria me kulturën kombëtare me 77 përgjigje pozitive (66,4%) nga 116 të anketuar. Konkludim shumë pozitiv të ekzistimit të ndjenjave krenare të identifikimit me kulturën kombëtare shprehin 87 të anketuar (75%) nga 116 të anketuar. Gjendja edhe më serioze në aspektin pozitiv shfaqet me rastin e përcaktimit kombëtar ku me 104 përgjigje pozitive (90%) nga 116 të anketuar përcaktohen se ndjehen dhe janë shqiptarë. Duke përfunduar me statistikat përshkruese të identifikimit me kulturën kombëtare nga rezultatet e anketës kuptohet se identiteti kombëtar në Leverkusen është në nivel të duhur, por mbetet mister fakti pse 12 të anketuar, (10 %), nuk e ndiejnë veten shqiptarë.

4.2. Identifikimi i migrantëve shqiptarë me kulturën gjermane

Elementi i parë me të cilin identifikohen shqiptarët me kulturën gjermane është gjuha. Gjuha gjermane i takon gjuhëve perëndimore, është gjuhë e folur në Unionin Europian, poashtu konsiderohet edhe gjuhë botërore.¹⁷⁷ Me mësimin e gjuhës gjermane si nevojë e domosdoshme për integrimin e migrantëve në shoqërinë vendëse, nuk duhet humbur gjuhën amtare. Normat që kërkojnë mësimin e gjuhës gjermane nuk detyrojnë humbjen e gjuhës amtare. Të identifikohesh me gjuhën gjermane është një fakt të cilin s'mund ta kontestojë askush, në veçanti kjo lidhet me brezat e rinj, dhe vlen për të gjithë migrantët pa marrë parasyshë nga e kanë origjinën: nga Algjeria, Maroku, Turqia, Pakistani ose India.¹⁷⁸ Këta të

¹⁷⁷ Michels, Eckard, *Informationen, Kultur und Interkulturelle Kommunikation*, Von der Deutschen Akademie zum Goethe-Institut. Sprach- und auswärtige Kulturpolitik 1923-1960, München, 2005.

¹⁷⁸ Ramadan, *Të jesh mysliman Evropian*, fq. 288.

rinj kanë një raport ndryshe nga të prindërve me shoqërinë dhe mjedisin. Mënyra e qenësimit, e shprehjes së vetvetes dhe të kuptuarit të së vërtetës, imagjinimi, madje edhe humori kanë marrë trajtë të qartë europiane.¹⁷⁹

Gjermanët janë popull solidarë, janë fisnikë, të drejtë dhe principiellë, janë të disiplinuar në punë dhe në jetën kolegjiale, cilësi këto me të cilat identifikohet edhe migranti shqiptar. Kjo në fakt nuk do të quhej identifikim i shqiptarëve me kulturën gjermane, por më tepër një edukatë dhe emancipim i përbashkët. Identifikimi i migrantëve shqiptarë me kulturën gjermane gjatë viteve të fundit është i ndërlidhur ngushtë me marrjen e shtetësisë gjermane. Me marrjen e shtetësisë se re migrantët shqiptarë identifikohen me kulturën gjermane dhe me kulturën e origjinës. Gjermania është prej shteteve që nuk lejon mbajtjen e dy shtetësive, prandaj shumica e migrantëve kërkojnë që një gjë e tillë të lejohet. Për momentin kjo nuk është e mundur ngase kërkohet që shteti i origjinës ta lirojë qytetarin nga nënshtetësia e vjetër. Humbja e shtetësisë së vjetër ka pasoja në të drejtën e trashigimisë dhe në të drejtën për tu varosur në vendlindje, nga ky fakt migrantët hezitojnë të identifikohen përmes shtetësisë gjermane. Sipas të dhënave shtetësinë gjermane e parapëlqejnë më tepër të rinjtë shqiptarë që jetojnë në Gjermani, konkretisht ata të gjeneratës së dytë, sepse kanë vendosur të jetojnë në Gjermani, njëherit dëshirojnë të identifikohen me jetën e shtetësisë së re.

Mes popullit shqiptar dhe gjerman gjatë historisë në asnjë fushë nuk ka patur armiqësi. Vet fakti se civilizimi gjerman dhe shqiptar nuk është implikuar në luftra dëshmon për afërsinë e këtyre dy popujve. Në këtë kontekst mund të trajtohet identifikimi i shqiptarëve me kulturën gjermane, me rastin që ata u detyruan gjatë sundimeve moniste të strehohen në Gjermani. Tani Gjermania pa dyshim është shtëpia dhe atdheu i dytë i shqiptarëve.

Migrantët shqiptarë jetojnë në miqësi dhe harmoni me fqinjët gjerman, ata ju përgjigjen ftesave familjare, kolegjiale dhe shoqërore. Përmes këtij akti migrantët ndajnë me fqinjët e tyre gjerman gëzimet dhe hidhërimet. Kjo argumenton një qytetërim të migrantëve e njëherit shfaqë edhe shenjat e identifikimit me kulturën gjermane. Marrëdhëniet mes migrantëve shqiptarë dhe popullit gjerman nga dita në ditë kultivohen dhe intensifikohen në sfera të shumta të bashkëpunimit kulturor. Ky bashkëpunim është garant i paqes dhe sigurisë e njëherit rruga më me prespektivë për integrim në këtë shoqëri. Migrantët identifikohen me kulturën gjermane edhe përmes arritjeve të tyre në ekonomi, arsim, sport dhe kulturë. Ndiham gjermane që ju ofrohet migrantëve gjithmonë është qëllimmirë, prandaj shqiptarët duke i

¹⁷⁹ Po aty.

pasur dyert e hapura për këto arritje mundohen me interes të veçantë për forcimin e mardhënieve me Gjermaninë dhe popullin gjerman.

Edhe gjermanët kanë shfaqur respekt dhe interes për të studjuar dhe hulumtuar për popullin shqiptar. Albanologë gjerman si: Frans Bop, Georg Han, Gustav Majer, Paul Kreçmer, Nobert Jokl, Klaus Hebler, Wilfrid Fidler, Oda Buhlc, Armin Hecer, Johan Knobloch, Gerda Ulrish,¹⁸⁰ etj. me seriozitet kanë hulumtuar për:

- Historinë shqiptare,
- Origjinën shqiptare,
- Traditën, zakonet shqiptare,
- Mentalitetin shqiptar,
- Trojet etnike shqiptare,
- Gjuhën, gramatikën, dialektet dhe fjalorin shqip,
- Besimet e popullit shqiptar.¹⁸¹

Reciprociteti shkencor dhe kulturor mes popullit shqiptar dhe gjerman, kontribuon edhe më tepër për ndërtimin e ardhmërisë së përbashkët. Në kongresin "Integrimi përmes arsimimit në shekullin e 21" kancelarja gjermane (Merkel) në Berlin flet për partneritet. Shteti dhe ekonomia private duhet të kuptojnë përgjegjësinë e tyre të përbashkët për integrimin. Fëmijët dhe të rinjtë, pavarësisht me çfarë prejardhje janë, duhet të kenë shansin për arsimim të njëjtë në shkollë fillore, në shkolla të larta dhe në profesion. Kjo vlen edhe për ata që vijnë nga familjet e emigrantëve."¹⁸²

Hipoteza e dytë bazohet mbi qëndrimin e migrantëve shqiptarë në Leverkusen të Gjermanisë ndaj identifikimit të tyre me kulturën gjermane. Pyetjet e hipotezës së dytë janë të ngjajshme me pyetjet e hipotezës së parë. Kultura gjermane identifikohet përmes sjelljeve të matura dhe të logjikshme që ka populli apo masa në përgjithsi. Kështu së paku propagandohet dhe kështu mendojnë migrantët duke potencuar përmes hipotezës së dytë se kultura gjermane ka ndikim në jetën e tyre.

Migrantët shqiptarë motiv kryesor të zbarkimit në Gjermani kanë patur përmirsimin e gjendjes së dobët materiale. Kërkesa dhe nevoja më të ekzagjuruara nuk kanë patur, tani me kalimin e viteve dhe ndryshimin e gjeneratave gjërat rrjedhin ndryshe. Gjermania është një shtet i mundësive të shumta, të shkollimit, të biznesit por edhe të një pune të thjesht për të siguruar jetesën. Gjatë testit përmes hipotezës së dytë sfida kryesore përqendrohet në atë se

¹⁸⁰ shkupiress.posterous.com, *Shqiptarët dhe studiuesit gjermanë*, (27.12.2011).

¹⁸¹ Po aty.

¹⁸² Deutsche Welle, *Integrim përmes arsimimit*, (28.12.2011).

migrantët shqiptarë vështirë e kanë të identifkohen me kulturën gjermane. Një numër i vogël i të testuarve nga rradhët e migrantëve shqiptarë janë krenar dhe ndjehen komod me kulturën gjermane.¹⁸³

Kultura gjermane është e mrekullueshme, por ajo nuk mund të zëvendësojë kulturën kombëtare, gjegjësisht të vendoset mbi të. Migrantin shqiptar kultura gjermane përkundrazi e ka mësuar që të fokusohet në kulturën e tij kombëtare dhe fetare. Migrantin shqiptar edhe pse është i ndërlidhur me tokën gjermane përmes vendit të punës me interval kohor shumë të gjatë, njëherit edhe përmes pronës të cilën posedon, lidhjet e tij me vendin e origjinës janë më të forta dhe më emocionale. Duke kaluar më tepër se gjysmën e jetës në Gjermani, gjegjësisht në Leverkusen,¹⁸⁴ migranti shqiptar është formuar si individ i përgjegjshëm për rolin dhe obligimet e tij qytetare. Ai duke u ballafaquar me kultura të ndryshme të cilat tubohen në metropolet europiane vjen në përfundim se lidhjet me njerëzit e identitetit të vet dhe me atdheun janë pasuri e pakompenzueshme.¹⁸⁵ Migrantët shqiptarë janë qytetarë të vërtetë në shtetin në të cilin jetojnë, ata si gjithë qytetarët tjerë, janë të obliguar të respektojnë kushtetutën dhe ligjin e shtetit gjegjës.

Çdo shtet europian ka kornizën e vet ligjore që kryesisht i referohet kushtetutës kombëtare (grundgesetz-ligji themeltar) që përbën tërësi ligjesh dhe jurisprudence specifike. Kushtetuta dhe ligjet veprojnë si një kornizë referuese dhe si strukturë që përbën shtyllën kurrizore të kombit dhe shtetit. Kjo kornizë ligjore përcakton statusin e veçantë të qytetarëve, të banorëve, të të huajve ose turistëve.¹⁸⁶ Shumica e migrantëve edhe pse nuk ndjehen të huaj në Gjermani¹⁸⁷ ata nuk mund të humbin nostalgjinë ndaj atdheut dhe të afërmeve, miqve dhe shokëve. Sado që kanë përparuar mjetet e komunikimit dhe sado që janë modernizuar mjetet e komunikacionit, nostalgjinë për vendlindjen nuk mund ta zëvendësojnë.

Një tjetër fenomen i hipotezës së dytë paraqitet me rastin se migrantët shqiptarë edhe pse nuk ndjehen në pozitë të pafavorshme dhe të diskriminuar¹⁸⁸ shkak i etnitetit të tyre ata shprehin se nuk ngjasojnë aspak me një person „tipik gjerman“.¹⁸⁹ Diskriminimi si problem social është prezent në të gjitha vendet e botës pamarë parasyshë se ka të bëjë me raporte të të njëjtit identitet apo të kundërt. Trajtimi ndryshe i punëtorit, nxënësit, studentit, kolegut, etj.

¹⁸³ Shih Shtojca, Tabela nr. 10.

¹⁸⁴ Po aty, Tabela nr. 5.

¹⁸⁵ Po aty, Tabela nr. 12.

¹⁸⁶ Ramadan, *Të jesh mysliman Evropian*, fq. 236.

¹⁸⁷ Shih Shtojca, Tabela nr. 15.

¹⁸⁸ Po aty, Tabela nr. 13.

¹⁸⁹ Po aty, Tabela nr. 14.

më tepër shikohet si motivim konkurent për arritje më të mëdha se sa një trajtim diskriminues apo racist.

Me kënaqësi, migrantët shqiptarë identifikohen me ndërmarrjet e tyre, duke qenë të bindur se edhe pse ka një dozë diskriminimi, më tepër stabilitet dhe imazh të mirë kanë arritur në bashkëpunim me identitetin e kundërt se me atë të njejtin. Përgatitja profesionale,¹⁹⁰ preciziteti dhe korrektësia në detyrë, sjellja kolegjiale janë preventivat që veprojnë kundër dukurisë së diskriminimit apo racizmit. Përveç këtyre elementeve kontratat, normat ligjore dhe ligjet antidiskriminuese, posaçërisht tani gjatë proceseve integruese, detyrojnë trajtimin e barabartë. Njohja e gjuhës gjermane për migrantët paraqet një mundësi për trajtim të ngjashëm. Në realitet migrantët sado mirë që ta njohin gjuhën gjermane¹⁹¹ përsëri në raste të shumta ka vend për kritika, tanimë kritikata për mos njohjen e gjermanishtes në nivel janë vetëm pretekst për paragjykime. Për gjeneratat e para s'ka qenë shumë e rëndësishme njohja e gjuhës dhe shkrimit gjerman, por puna dhe proceset kanë rrjedhur në përputhshmëri me çdo normë.

Shoqërimi i migrantëve shqiptarë në Leverkusen të Gjermanisë me etnitete dhe identitete tjera është një trajtesë tjetër e hipotezës së dytë. Sigurisht se nuk ka shoqëri e cila mund të konsiderohet etnikisht e pastër, 32,92% e popullsisë së përgjithshme në Leverkusen janë me origjinë të huaj.¹⁹² Ky është fakti i cili përcakton diversitetin kulturor të përbërjes së shoqërisë në këtë qytet ku gravitojnë edhe migrantët shqiptarë. Shoqërimi i migrantëve shqiptarë me gjermanët,¹⁹³ shpjegon nivelin e pranimit nga shoqëria vendëse e që lidhet me emancipimin kulturor të shoqërive që kanë më tepër se katër dekada jetë të përbashkët kolegjiale. Sigurisht akoma shumë duhet bërë në kuadër të arritjes së integritimit të mirëfilltë politik, kulturor, medial, ekonomik, etj. për të cilin shqiptarët bëjnë përpjekje reale, por në përgjithësi marrëdhëniet ndërmjet komunitetve në qytetin e Leverkusenis janë të kënaqshme.

¹⁹⁰ Po aty, Tabela nr. 4.

¹⁹¹ Po aty, Tabela nr. 20.


¹⁹² Stadt Leverkusen, *LIGA.NRW* (Mikrozensus 31.12.07).

¹⁹³ Shih Shtojca, Tabela nr. 18.

4.2.2. Statistikat përshkruese të identifikimit me kulturën gjermane

Qasje serioze i kushtohet përcaktimit të migrantëve shqiptarë ndaj vlerësimit dhe përshtatjes me kulturën gjermane në segmente të caktuara, statistikave përshkruese të identifikimit me kulturën gjermane. Në këtë hulumtim me rezultatete kualitative dhe kuantitative u kontribuojnë migrantët shqiptarë. Rezultatet e statistikave në këtë hulumtim mund të përshkruhen si shumë të rëndësishme për përpjekjen serioze të migrantëve që të integrohen në shoqërinë vendëse, për të krijuar fqinjësi të mirë. Rezultatet e tabelës nr.10 ndërtojnë këtë figurë:¹⁹⁴

Figura 2: Migrantët shqiptarë dhe kultura gjermane



Identifikimi i migrantit shqiptar me kulturën gjermane në Leverkusen të Gjermanisë përmes këtij diagrami varion mes 1,7% (2 përcaktime) deri 65% (76 përcaktime). Për të jetuar në harmoni me konceptin e jetës së vendit pritës, në rradhë të parë duhet njohur kulturën, gjuhën, ligjet. Në një mënyrë duhet adaptuar me shumë procese të cilat ndërlidhen ngushtë me procesin e integrimi evropiane. Për tu integruar në një shoqëri të huaj, migrantët shqiptarë kanë prirje, ata dinë të vlerësojnë kulturën e vendit pritës dhe t’ju përmbahen normave të kulturës së origjinës. Këtë më së miri e vërteton cilësia e përgjigjeve të dhëna në tabelën nr.10.

Në këtë tabelë shihet se nga 116 të anketuar, (ngjajshëm si në tabelën nr.9) 76 prej tyre (65,5%) përcaktohen përafërsisht njëjtë si me kulturën kombëtare duke konkluduar se kultura gjermane ka ndikim pozitiv në jetën e tyre.¹⁹⁵ Një rrënie e madhe shihet me rastin e

¹⁹⁴ Po aty, Tabela nr. 10.

¹⁹⁵ Po aty.

statistikave përshkruese të konkluzave në vijim, jashtëzakonisht bie numri dhe përqindja me rastin se vetëm 15, nga 116 të anketuar (12,9%) nga mesi i migrantëve shqiptarë krenohen me kulturën gjermane. Gjendja paraqitet e ngjashme në vazhdim, ku shihet se 27 të anketuar (23,2%) ndjehen komod me kulturën gjermane. 14 prej tyre (12 %) janë të ndërlidhur ngushtë me kulturën gjermane. 7 nga të anketuarit (6%) ndjehen krenar të identifikohen me kulturën gjermane.

Brenda këtyre konkluzave shihet një stabilitet edhe më serioz ndaj identitetit kombëtar dhe fetar me rastin se migrantët shqiptarë edhe pse preferojnë shtetësinë gjermane, vetëm 2 nga 116 të anketuar (1,7%), ndjehen se janë gjerman.¹⁹⁶ Duke analizuar statistikën përshkruese në tabelës nr.10 bie në sy një dallim shumë i madh mes qëndrimeve të migrantëve ndaj kulturës gjermane. Nga njëra anë ata janë të entuziazmuar për ndikime pozitive të kulturës gjermane në jetën e tyre, nga ana tjetër falenderues ndaj popullit gjerman për gjithçka. Migrantët shqiptarë të ndikuar nga fushata propagandistike e të djathtëve ekstrem ndaj të huajve, posaçërisht në kohën e proceseve të integrimi europian rezervohen për tu solidarizuar apo adaptuar me të gjitha konkluzat e tabelës nr.10. Nën trysinë e kësaj njëherit shfaqet ksenofobia dhe bjen kualiteti i përpjekjeve serioze për integrim. Nga kjo formësohet një izolim dhe kufizim nga arsyeja se migrantët shqiptarë thuhet janë i vetmi komunitet pa ndonjë lidhje institucionale me vendin e origjinës.

4.3. Identifikimi i migrantëve shqiptarë me kulturën fetare

Identifikimi i shqiptarëve me kulturën fetare bazohet mbi vlerat e moralit, etikës, karakterit dhe standardeve normative të cilat përfshijnë sferën individuale, familjare dhe shoqërore. Këto janë standarde përmes së cilave dëshirohet të arrihet një sjellje kulturore dhe e ndershme, në mungesë të së cilave shfaqet amoraliteti, ataraksioni¹⁹⁷, si dhe shumë antivlera. Vlerat morale dhe etike studjohen edhe nga shkolla të shumta të filozofisë, ekonomisë, politikës, medicinës, etj. ngase tendenca e të gjitha këtyre shkollave është përsosja e njeriut në vlerat e tij. Etika shpesh kufizohet si fokusim në atë çka duhet të jetë. Nuk ka konsensus të qartë për ndonjë tërësi të plotë rregullash etike që duhen ndjekur gjatë kërkimeve që kanë të bëjnë me subjekte njerëzore, ndonëse ekzistojnë disa linja orientuese profesionale përgjithsisht të pranuar.¹⁹⁸

¹⁹⁶ Po aty, Tabela nr. 10.

¹⁹⁷ trendet.net, *Filozofia dhe etika epikuriane*, (22.12.2011).

¹⁹⁸ Marshall, *Fjalor Sociologjik i Oksfordit*, fq. 87.

Studimet sociologjike mbi fenë ende janë nën ndikimin e fortë të tre teoricienëve „klasik“ të sociologjisë: Marksit, Durkheimit dhe Weberit.¹⁹⁹ Marksit asnjëherë nuk e studioi fenë në mënyrë të detajuar, idetë e tij burojnë kryesisht nga shkrimet e teologëve dhe filozofëve të ndryshëm të shekullit XIX. Feja sipas Marksit është „zemra e një bote pa zemër“, një formë justifikimi i ashpërsisë së jetës së përditshme. Feja ka një element ideologjik të fortë: besimet dhe vlerat fetare shpesh sigurojnë justifikimet për pabarazitë e pasurisë dhe të fuqisë.²⁰⁰ Për dallim nga Marksit, Durkheim studimit të fesë i kushtoi një rëndësi më të veçantë, ai u përqendrua tek feja e shoqërive të vogla tradicionale. Durkheim nuk e lidhi fenë me pabarazitë sociale ose shtetin, por me natyrën e përgjithshme të institucioneve të një shoqërie. Durkheim thekson me forcë faktin se fetë nuk janë vetëm çështje e besimit.

Të gjitha fetë përfshijnë veprimtari ceremoniale dhe rituale të rregullta, të cilat një grup besimtarësh i përjetojnë së bashku. Ceremonia dhe ritualet, sipas pikëpamjes së Durkheimit, janë esenciale për lidhjen e anëtarëve të grupeve. Ai arsyeton se ceremonitë kolektive riafirmojnë solidaritetin e grupit në një kohë kur njerëzit janë të detyruar t'iu përshtaten ndryshimeve më të rëndësishme në jetën e tyre. Feja nuk është një varg sentimentesh dhe aktiviteteve, ajo në të vërtetë kushtëzon mënyrat e të menduarit të individëve në kulturat tradicionale.²⁰¹

Për dallim nga Marksit dhe Durkheimi, Weberi u angazhua në një studim masiv të feve në shkallë botërore. Ai u përqendrua në atë që e quante fe botërore, ato fe të cilat kanë tërhequr një numër më të madh të besimtarëve të cilët kanë ndikuar në mënyrë vendimtare në rrjedhën e historisë botërore. Weberi duke studjuar Protestantizmin argumenton se ishte burim i perspektivës kapitaliste të krijuar në Perëndimin modern. Protestantizmi në zhvillimin e Perëndimit është pjesë e një përpjekjeje të gjithanshme për ta kuptuar ndikimin e fesë në jetën sociale dhe ekonomike në kultura të ndryshme.²⁰²

Sipas Weberit, feja ofron çelësin për ta kuptuar këtë veçori të orientimit modern karshi jetës së përditshme. Feja përfshinë një zgjedhje vlerash të mbrame, të cilat nuk mund të përliqjen nga pikëpamja racionale. Sidoqoftë, pasi ka vlera të tilla ato mund të ndiqen me mjete racionale: ka kuptim të flitet për mënyra racionale e irracionale të realizimit të një vlere të mbrame.²⁰³ Marksit, Durkheimi dhe Weberi identifikuan karakteristikat e përgjithshme të fesë dhe në disa aspekte pikëpamjet e tyre plotësojnë njëra tjetrën. Tri fetë monoteiste, më me

¹⁹⁹ Giddens, *Sociologjia*, fq. 437.

²⁰⁰ Po aty.

²⁰¹ Po aty, fq. 440.

²⁰² Po aty, fq. 441.

²⁰³ Marshall, *Fjalor Sociologjik i Oksfordit*, fq. 88.

ndikim dhe më me influencë në historinë e njerëzimit janë: Judaizmi, Krishtërimi dhe Islami.²⁰⁴ Feja te shqiptarët si popull tre konfesional ka një rol të rëndësishëm posaçërisht në kushtet aktuale të integriteteve europiane. Në këto rrethana me theks të veçantë shikohet bashkëpunimi mes islamit dhe krishterizmit. Pjestarët dhe prijësit fetarë në ditët e sotme kanë obligime të përbashkëta kundrejt fenomeneve të shoqërisë moderne të cilat shfaqen me rastin e zbehjes së vlerave dhe tejkalimit të kufijve të moralit. Si rrjedhim i këtij bashkëpunimi vjen dialogu ndërfaqor mes këtyre komuniteteve fetare, me qëllim zgjerimin dhe koordinimin e bashkëpunimit.

Fetë bartin një pjesë të përgjegjësisë për mbizotërim të paqes, bashkëjetesës dhe sigurisë. Qëndrimi dhe sjellja e besimtarëve është përcaktuar në përputhje me shkallën në të cilën gjendet besimi i tyre. Rrethanat e përcjella me dialog do të jenë në gjendje të gjejnë terrenin e përshtatshëm në vendin tonë dhe kudo në botë.²⁰⁵ Të gjithë besimtarët nuk reflektojnë vlera universale, ato ndryshojnë nga besimi përkatës, vendi dhe koha. Rrethanat shoqërore dhe kulturore poashtu kanë ndikim në formësimin e identitetit fetar. Migrantët shqiptarë si musliman, të krishterë dhe ortodoks proporcionet identifikuese morale, etike dhe kulturore nuk i kanë të njëjta. Kushtet që këta besimtarë jetojnë në vende të civilizuarra dhe më pak të civilizuarra ndikojnë në reflektimin e identifikimit të tyre fetar.

Konceptet për ekzistencën e Zotit, të profetëve, librave të shpallura, engjijve, normat mbi martesën, familjen, pasurinë, etj. nuk trajtohen njëjtë nga të gjitha besimet monoteiste me të cilat identifikohet migranti shqiptar. Vlerat morale dhe etike me siguri janë elementet bazë me të cilat identifikohet kultura fetare. Këto vlera sa janë „lindore“ janë edhe „perëndimore“ pra janë universale për mbarë njerëzimin si bazë e mesazhit hyjnor.²⁰⁶ Diversiteti fetar është dëshiruar nga Zoti dhe Ai i ka dhënë Mesazh të veçantë secilit popull. Këto Mesazhe Hyjnore, me rrjedhën e historisë, në një dorë apo tjetër, janë modifikuar dhe ndryshuar nga dora e njeriut. Kjo ka ndodhur në atë masë sa që çdo Shpallje e mëvonshme është dashur ta ndreqë atë që është shtrembëruar dhe falsifikuar në shpalljen e mëparshme.²⁰⁷

Sferat e vlerave civilizuese fetare të shqiptarëve në fakt duhet trajtuar si tejet të rëndësishme në mbarë hapësirat shqiptare, por edhe në diasporë. Vlerat fetare me të cilat identifikohen migrantët shqiptarë formësojnë përkatësinë e tyre në qarqet e civilizimit europian, në anën tjetër thejnë të gjitha pengesat e kombit për të parë dritën e integritimit.

²⁰⁴ Giddens, *Sociologjia*, fq. 460.

²⁰⁵ Gülen, *Drejt një qytetërimi botëror me dashuri & tolerance*, fq. 124.

²⁰⁶ Hysa & Thartori, *Integrimi i shqiptarëve në Evropë*, fq. 30.

²⁰⁷ Ramadan, *Të jesh mysliman Evropian*, fq. 92.

Migrantët kanë filluar tani me ndonjë paraqitje reale para publikut gjerman të plasojnë identifikimin e tyre me kulturën fetare në saje të zhvillimeve civilizuese. Paraqitjet e migrantëve në Leverkusen kundrohen në kontekstin e identitetit fetar islam. Pa marrë parysishë këto ecure pozitive, gjendja është ndërlikuar dhe nuk është aq pozitive.²⁰⁸

Migrantët shqiptarë në Gjermani identifikohen edhe me objektet e tyre të kultit. Ata ushtrojnë besimin e tyre në objekte moderne fetare të ndërtuara në vende publike, përmes ligjeratave në gjuhën amtare, ku ata ruajnë edhe trashëgiminë gjuhësore shqipe. Ngjarjet e rezultuara nga ndryshimet pozitive të dy dekadave të fundit kanë mundësuar që shqiptarët të identifikohen lirshëm me kulturën e tyre fetare. Janë mundësuar transformime esenciale për debate demokratike brenda shqiptare për një modalitet të ri me ndryshime nga i vjetri, këto ngjarje kanë mundësuar një harmoni edhe më solide brenda shqiptare.

Hipoteza e tretë bazohet mbi qëndrimin e migrantëve shqiptarë ndaj identifikimit të tyre me kulturën fetare. Pyetjet e hipotezës së tretë janë të ngjajshme me pyetjet e hipotezës së parë dhe të dytë. Sikurse në vendet e origjinës edhe në mërgim bie në sy diversiteti kulturor i migrantëve, dallimet janë të ndikuara edhe nga kultura fetare e migrantëve shqiptarë si popull tre konfesional. Shqiptarët kultura fetare i përfshinë në jetën sociale, familjare, kolektive, fisnore, etj.²⁰⁹ Me siguri se ka mospërputhje të rezultateve midis hipotezave, por më e rëndësishmja është se dallimet ndërmjet hipotezës së parë dhe të tretë janë minimale rreth faktit të identifikimit me kulturën kombëtare dhe fetare të migrantëve.

Vrojtimit serioze në fushën e cilit do pjesëtar të komuniteteve fetare dëshmojnë stabilitetin e identifikimit me kulturën fetare përkatëse, në këtë rast të migrantëve shqiptarë në Leverkusen të cilët masovikisht identifikohen me kulturën fetare islame.²¹⁰ Vlerat thelbësore të individit apo komunitetit me siguri përcaktohen edhe nga ndikimet fetare.²¹¹ Në tokën shqiptare ndikimet fetare shihen në fushën shoqërore, ekonomike, por nganjëherë edhe në ate politike. Përmes identifikimit me kulturën fetare migranti shqiptar shfaqë njohuritë, praktikimin dhe përkrahjen për identitetin e tij fetar.²¹² Ai nuk ndjehet i brengosur dhe me komplekse për ate se i takon një konfesionit, e njëherit çmon dhe ndjehet i privilegjuar përmes identifikimit të tij me kulturën fetare.²¹³ Në Gjermani, gjegjësisht në tokën e NRW-së, (Nordrhein-Westfalen) janë duke u bërë përgatitjet e fundit për mundësinë e fillimit të lëndës

²⁰⁸ Po aty, fq. 172.

²⁰⁹ Morina, *Identiteti fetar i shqiptarëve*, fq. 7.

²¹⁰ Shih Shtojca, Tabela nr. 11.

²¹¹ Po aty.

²¹² Po aty, Tabela nr. 22.

²¹³ Po aty, Tabela nr.11.

së mësim-besimit islam në shkollat e Gjermanisë.²¹⁴ Përmes intergrimit të kësaj lënde nxënësve të migrantëve shqiptarë të cilët me shumicë i përkasin fesë islame do t'ju mundësohet marja e diturive elementare për fenë dhe kulturën e tyre fetare. Mungesa e diturive fetare e detyron migrantin të ndjehet indiferent për përkatësinë e tij fetare,²¹⁵ këta individ për këtë arsye mund edhe të tjetërsohen në një kulturë apo sekt tjetër fetar.

Migranti shqiptar është krenar dhe i lumtur me fenë e tij, përmes kësaj hipoteze shihet sa e praktikon fenë e tij,²¹⁶ përkundër tendencave të shumta destruktive, në kuptimin tradicional ritualet dhe praktika fetare për migrantin mbeten të njejta. Praktika fetare e cila dallon nga njëra tjetra, mundohet që raportet shoqërore pak të tendosura në kohën e modernizmit ti harmonizojë, lidhjet familjare ti ripërtrijë dhe gradualisht përmes kësaj praktike migranti të bëhet më i socializuar. Islami duke u renditur krahas krishterimit dhe hebraizmit si pjesë e historisë së tashme të Gjermanisë (Presidenti i Gjermanisë, Wulf) migrantëve ju mundësohet realizimi i praktikës fetare në formën më të përshtatur.

Hipoteza e tretë trajton edhe përkrahjen e fesë nga migrantët shqiptarë. Debatu fetar ka përfshirë tërë Gjermaninë dhe është futur në të gjitha institucionet. Ky debat duke u implikuar ekonomikisht, politikisht dhe akademikisht si pjesë garimi ka vënë edhe migrantin. Identifikimi i drejtë përmes elementeve të kulturës fetare dhe përkrahja serioze shihet qartë tek migranti shqiptar.²¹⁷ Migranti nuk pretendon të identifikohet me një kulturë fetare që në sfond ka tendencë të kundërt me kulturën kombëtare. Duke qarkulluar në media terminologjitë si: ekstremist, fundamentalist, vehabist, modernist, sekularist, etj. migranti shqiptar vazhdon të ndjek dhe përkrahë tradicionale të artë.

4.3.3. Statistikat përshkruese të identifikimit me kulturën fetare

Konkluzat e identifikimit me kulturën fetare janë të ngjashme si ato të identifikimit me kulturën kombëtare dhe gjermane. Përmes gjashtë konkluzave të parashtruara migrantët shqiptarë kanë patur mundësinë të reflektojnë ndjenjat e konceptit fetar. Qëndrimet dhe perceptimet ndaj kulturës fetare nxjerrin në shesh një fuqi tjetër të identitetit të migrantit shqiptar në Leverkusen të Gjermanisë. Statistikat në këtë hulumtim përshkruhen si shumë të

²¹⁴ wdr.de, *Koordinationsrat der Muslime soll in Beirat mitwirken, Islamunterricht ab 2012 in ganz NRW.* (12.11.2011).


²¹⁵ Shih Shtojca, Tabela nr. 11.

²¹⁶ Po aty, Tabela nr. 22.

²¹⁷ Po aty.

rëndësishme dhe me ndikim pozitiv në jetën e përgjithshme të migrantit. Rezultatet nga tabela nr.11 ndërtojnë këtë figurë:

Figura 3: Migrantët shqiptarë dhe kultura fetare



Identifikimi i migrantit shqiptar me kulturën fetare në Leverkusen të Gjermanisë përmes këtij diagrami varion mes 69,8% (81 përcaktime) deri 93,1% (108 përcaktime).²¹⁸ Identike rezultojnë gjendja e identifikimit me kulturën kombëtare që fillon me 72 përcaktime, (62%) dhe ngritet në 104 përcaktime (90%). Të dhënat e këtij hulumtimi rezultojnë një opinion paralel brenda koncepteve të konkluzave të identitetit kombëtar dhe fetar. Të anketuarit shfaqin ndjenja pothuajse të barabarta ndaj identifikimit me kulturën kombëtare dhe fetare. Duke u bazuar në të dhënat e tabelës nr.11, dimensionin e identitetit fetar të migrantëve shqiptarë shpalos cilësi të shëndosha të kulturës fetare. Nga kjo tabelë rezultojnë se nga 116 të anketuar, 90 prej tyre (77,5%) pohojnë se kultura fetare ka ndikim shumë pozitiv në jetën e tyre.²¹⁹

Personalitetin e migrantit shqiptar e karakterizojnë të veçantat në sjelljen dhe edukatën e vazhdueshme për të arritur kënaqësinë e Krijuesit. Përmes krenarisë me kulturën fetare 91 përcaktime (78,4 %) e të anketuarve konfirmojnë nënshkrimin e plotë dhe serioz ndaj besimit të tyre. Migrantët shqiptarë me 81 përcaktime (69,8%) ndjehet komod me kulturën fetare dhe ky komoditet aspak nuk i bjen telashe që të ndjehet i relaksuar në shoqërinë perëndimore. Përkundrazi i mundëson që të jetë edhe më i ndërlidhur me kulturën fetare gjatë proceseve të integrimi në kohën e konkurrencës kulturore. Këtë e shfaq migrantët shqiptarë duke u deklaruar me 84 përcaktime (72,4%) se është i lidhur ngushtë me kulturën fetare.

²¹⁸ Shih Shtojca, Tabela nr. 11.

²¹⁹ Po aty.

Feja njeriut ia mundëson të jetë i rehatuar në këtë jetë si besimtar dhe atdhetar. Migrantët shqiptarë me 93 përcaktime (80,1%) ndjehen krenar të identifikohen me kulturën fetare. Nga tabela nr.11 mësohet se migrantët shqiptarë në qytetin e Leverkusenit nga 116 të anketuar, 108 prej tyre (93,1%) përcaktohen se i përkasin konfesionit islam. Me siguri se ndër migrantët shqiptarë në këtë qytet ka edhe të konfesioneve tjera, por në hulumtim kjo nuk figuron. Mbetet mister fakti i 8 të anketuarve (6,8%) se cilit konfesion i takojnë apo ndoshta janë ateist.²²⁰

5. Rrjedha e hulumtimit

Anketa iu shpërnda 120 migrantëve shqiptarë prej të cilëve 116 iu përgjigjën hulumtimit pozitivisht. Katër prej tyre nga fakti se nuk iu përgjigjen sondazheve nuk e kanë pa të arsyeshme të marrin pjesë në këtë hulumtim. Anketa përfshinë 20% të totalit të familjeve të migrantëve shqiptarë në këtë qytet me rrethinë. Të anketuarit për pyetjet e paqarta janë paraqitur për të marrë informata shtesë në lidhje me hulumtimin të cilëve në formë vëzhguese ju është dhënë përgjigje. Në këtë mënyrë mund të argumentohet se ky punim përfshinë një përqindje të mjaftueshme për një hulumtim të sukseshëm duke mundësuar të ketë një parafytyrim të qartë të realitetit të gjendjes së identitetit të migrantit. Janë përfshirë struktura të ndryshme nga rradhët e mërgimtarëve. Të dhënat janë origjinale dhe të pandryshuara, mund të verifikohen përmes instrumentit të anketës i cili me numër të koduar posedohet në origjinal për çdonjërin migrant të intervistuar.

I anketuari për ndonjë pyetje ka patur mundësi të paraqet më tepër se një qëndrim. Ai ka patur mundësi të mbetet edhe indiferent, ndërsa disa pyetjeve nuk ka mundur të mos ju përgjigjet. Të anketuarit që kanë dhënë përgjigje (shumica e të cilëve janë gjenerata e dytë) janë të punësuar apo vetëpunësuar dhe banojnë në shtëpitë e tyre private, të blera apo të ndërtruara. Anketimi ka përfshirë të gjitha moshat, të dy gjinitë, të gjitha nivelet arsimore, shumicën e profesioneve, kohëzgjatjen e migracionit, llojin e lejeqëndrimit, përqindjen e jetës së kaluar në mërgim si dhe migranti nga cilat troje shqiptare vjen. Gjenerata e dytë ka rëndësi nga fakti se është bartëse e proceseve integruese dhe garancë e mbrojtjes së identitetit.

²²⁰ Po aty, Tabela nr. 11.

5.1. Mostra e hulumtimit dhe analizimi i të dhënave

Ky hulumtim sociologjik i kushton rëndësi realizimit të një mostre të drejtë të përfshirjes së përkatësisë gjinore dhe territoriale të të anketuarve. Poashtu përfshinë edhe nivelin arsimor të mesatarizuar dhe profesionin. Moshja e të anketuarve ka rëndësinë e vet nga fakti që në mostër shihen ndryshimet dhe karakteristikat e gjeneratave. Një rëndësi të veçantë ka edhe kohëzgjatja e qëndrimit të migrantit në mërgim, vendlindja, vendi i origjinës dhe lloji i lejeqëndrimit. Analizimi i të dhënave bazohet në rezultatet e anketimit me qëllim të përputhjes së tij me synimin e studimit.

Shtrirja nacionale e subjekteve të anketimit shërben dhe jep mundësi për të analizuar më afër problematikën e identitetit të migrantit dhe integrimin e tij në Gjermani. Një fenomen tjetër i migracionit, i cili nuk është përfshirë në këtë anketim, është se shumica e migrantëve vijnë nga vendet rurale dhe periferike të trojeve shqiptare, e më pak nga ato urbane. Anketa është formatuar duke dhënë mundësi që identiteti i migrantit shqiptar të analizohet në të gjitha nivelet dhe dimensionet e identitetit kombëtar dhe fetar.

5.2. Pjesëmarrja e të anketuarve sipas moshës dhe gjinisë së tyre

Nga tabela nr.1 del rezultati se nga 116 pjesëmarrës 10 subjekte (8,6%) janë të moshës ndërmjet 18 deri 25 vjeç. 81 subjekte (70%) janë të moshës 26 deri 45 vjeç, 9 subjekte (7,7%) janë të moshës 46 deri 60 dhe 16 subjekte (13,7%) janë të moshës mbi 60 vjeçare.²²¹ Nga tabela nr.2 del rezultati se nga 116 pjesëmarrës 29 subjekte (25%) janë të gjinisë femërore dhe 87 subjekte (75%) janë të gjinisë mashkullore.²²²

Familja patriarkale sipas normave shoqërore ka përgjegjësi për të siguruar mjetet materiale të jetesës për vete dhe për familjen. Për këtë arsye edhe është marrë rruga e migrimit nga popullata shqiptare. Struktura gjinore dhe mosha përbëjnë pjesën më të madhe të migracionit si potencial i disponuar për të punuar jashtë vendit.²²³ Proceset e integrimi evropiane përfshijnë të dy gjinitë dhe të gjitha moshat, por vetvetiu gjinia mashkullore dhe moshat mesatare mbeten bartëse të proceseve sociale dhe shoqërore. Në praktikën e këtij studimi është përfshirë vetëdijshëm se anketimi është i balancuar dhe krijon mundësi për të qenë përfaqësues dhe në përputhje me strukturën dhe përbërjen gjinore dhe moshore të

²²¹ Shih Shtojca, Tabela nr. 1.

²²² Po aty, Tabela nr. 2.

²²³ Mustafa, Muhamet, *Diaspora dhe politikat e migracionit*, Forum 2015, Prishtinë, 2007, fq. 30.

mërgatës shqiptare në qytetin e Leverkusenit.²²⁴ Këto të dhëna vlerësohen të drejta dhe të sakta në përputhje me perceptimin social të migrantëve shqiptarë në këtë qytet.

Ndjeshmëria e gjinisë mashkullore dhe reagimi i moshave mesatare është më i dukshëm dhe në shkallë më të lartë në sensibilizimin dhe perceptimin e dukurive të migrimit. Moshat rinore të përfaqësuara me 8,6 % më pak interesohen për çështjet e identitetit dhe me çdo kusht veten e shohin të integruar në shoqërinë vendore. Gjeneratat e moshuara të përfaqësuara me 13,7% janë pensionist apo para pensionit. Ata kanë bindjen se me kalimin e kohës dhe me ndërrimin e gjeneratave serioziteti i identitetit do të zbehet.²²⁵ Kjo shkallë e perceptimit dhe bindjes nuk është e njëjtë dhe e barabartë në moshat e mesme të përfaqësuara në këtë punim me 70%. Treguesit sasiorë të rezultateve të anketimit në krahasim me grupmoshat tjera japin të kuptohet një realitet krejtësisht tjetër i cili bazohet mbi interesimin e madh dhe shumë serioz të kësaj moshe për sundimin e vetëdijes kombëtare dhe fetare.²²⁶

Është e interesit madhor analiza e rezultateve të moshave dhe gjinive të migrantëve shqiptarë për çështjen e identitetit dhe integritetit, pasi fillon me tregues të ulët në moshat e reja, rritet me interes shumë të madh në moshat e mesme, dhe fillon ti humb shpresat me moshat e larta. Nuk ka dyshim se moshat e reja ende nuk perceptojnë faktin çka do të thotë mbrojtja dhe zhvillimi i identitetit. Tek kjo moshë e të dy gjinive, ndjehet një thyerje e kufive kulturor dhe disi në mungesë të kultivimit të identitetit kolektiv nga kjo moshë në Leverkusen fillon të dominojë një mentalitet alternativ. Ndonjëherë ata e harrojnë origjinën dhe fenë e tyre dhe mundohen t'i fshijnë dallimet me të tjerët. Me qëllim të fshehjes në shoqëri të bëhen sa më të padukshëm që të jetë e mundur, të bëhen një prej tyre, një evropian autentik.²²⁷ Shqetësim personal dhe kolektiv, interesim të duhur për çështjen e identitetit pa dyshim përbën mosha mesatare e të dy gjinive, në shoqëri dhe në familje, e cila rrit dhe edukon brezat e ri. Kjo moshë krijon dhe mban lidhjet me vendin e origjinës, ka të mbjellur në shpirt normat morale dhe emocionale, është kjo mosha e konkurrimit të identiteteve në tregun e botës së civilizuar.

²²⁴ Shih Shtojca, Tabela nr. 1 dhe 2.

²²⁵ Po aty, Tabela nr. 1 dhe 2

²²⁶ Po aty.

²²⁷ Ramadan, *Të jesh mysliman Evropian*, fq. 18.

5.3.Pjesëmarrja e të anketuarve sipas nivelit arsimor dhe profesionit të tyre

Nga tabela nr.3 del rezultati se nga 116 pjesëmarrës 1 subjekt (0,86%) është me shkollë fillore katër vjeçare. 29 subjekte (25%) janë me shkollë fillore 8-të vjeçare. 37 subjekte (31,8%) janë me shkollë të mesme profesionale. 33 subjekte (28,4%) janë me shkollë të mesme të përgjithshme dhe vetëm 16 subjekte (13,8%) kanë të kryer fakultet.²²⁸

Nga tabela nr.4 del rezultati se nga 116 pjesëmarrës 18 subjekte (15,5%) punojnë në një ndërmarrje si puntorë të pakualifikuar. 45 subjekte (38,9%) punojnë në një ndërmarrje si punëtorë të kualifikuar. 7 subjekte (6,4%) punojnë në një ndërmarrje si nëpunës zyrtar. 9 subjekte (7,7%) punojnë në një institucion si nëpunës, mësues, etj. 10 subjekte (8,6%) kanë një ndërmarrje private. 7 subjekte (6,4%) janë student. 11 subjekte (9,5%) janë pensionist. 6 subjekte (5,2%) janë amvise dhe 3 subjekte (2,6%) nuk kanë një profesion.²²⁹

Niveli arsimor i migrantëve shqiptarë mundëson vlerësimin dhe kuptimin e rëndësisë së identitetit duke tentuar të gjejë nivelin e pikëlidhjes mes vendit të origjinës dhe migrimit. Të gjejë barazinë mes identitetit kombëtar dhe fetar duke respektuar kulturat tjera të çmojë kulturën personale. Është e pamundur që përmes rezultateve të këtij anketimi të jepen konkluzionet e fundit rreth nivelit arsimor dhe profesionit të subjekteve të hulumtimit në qytetin e Leverkusenit. Duhet mbajtur në konsideratë se të dhënat janë reale dhe interesante për të analizuar shtresat e ndryshme të shoqërisë shqiptare në mërgim.

Duke i analizuar rezultatet e anketës duket se shtresa me shkallë arsimit të mesëm profesional me 31,8% i prinë sensibilitetit dhe emancipimit të shoqërisë shqiptare në Leverkusen. Pason shtresa me shkallë arsimit të mesëm të përgjithshëm me 28,4% duke u ndjekur nga shkalla me arsim fillor me 25% dhe së fundi vjen shkalla e subjekteve me shkollim të lartë të pëfaqësuar me 13,8%.²³⁰ Duhet të theksohet se jo të gjithë migrantët kanë të kryer arsimin e mesëm dhe të lartë në Leverkusen. Disa prej tyre arsim të mesëm të përgjithshëm dhe të lartë kanë kryer në vendin e origjinës, në vendlindje.

Sa më i arsimuar që të jetë migranti shqiptar aq më shumë përcepton proceset integruese dhe problemet identifikuese. Atij përmes nivelit arsimor i bëhet e mundur edhe gjetja e një vendi të punës i cili konsiderohet prej prestigjeve të integritetit si; punëtor i kualifikuar që në këtë studim ka afër 39%, punonjës zyrtar prej të cilëve ka vetëm 6,4%,

²²⁸ Shih Shtojca, Tabela nr. 3.

²²⁹ Po aty, Tabela nr. 4.

²³⁰ Po aty, Tabela nr.3.

punonjës në një institucion të përfaqësuar në këtë studim ka vetëm 7,7%.²³¹ Aty ku bazohet shpresa e ngritjes intelektuale të mërgatës shqiptare është se jo më tepër se 6,4% janë studentë nga të cilët pritet një nivel i lartë arsimit dhe shkollimi. Në Leverkusen nuk ka ndonjë subjekt që ka të kryer studime pasuniversitare, kjo kategori nuk është përfshirë në mostrën e anketimit. Është shumë pozitive se pa marrë parasyshë nivelin arsimor dhe profesionin e migrantëve të anketuar, përceptimi i tyre për identitetin kombëtar dhe fetar është shumë i ngritur.²³² Kjo është struktura e nivelit arsimor dhe struktura e profesioneve të migrantëve shqiptarë në Leverkusen të Gjermanisë, për të cilën mund të thuhet se i përshtatet nivelit të përgjithshëm të migrantëve dhe është akoma larg realitetit të shoqërisë vendëse.

5.4. Pjesëmarrja e të anketuarve sipas kohëzgjatjes së qëndrimit të tyre në migrim

Nga tabela nr.5 del rezultati se nga 116 pjesëmarës 9 subjekte (7,8%) janë lindur në Gjermani. 36 subjekte (31%) qëndrojnë deri 15 vjet. 50 subjekte (43,2%) qëndrojnë deri 30 vjet. 21 subjekte (18%) qëndrojnë deri 50 vjet dhe nuk ka një subjekt i cili qëndron në Gjermani mbi 50 vjet.²³³ Nga këto rezultate vërrehet se migrantët shqiptarë në Leverkusen figurojnë që para 40 viteve. Sipas statistikave gojore të vetë migrantëve në këtë qytet shqiptari i parë ka ardhur në vitin 1964. Në mënyrë të organizuar dhe masovike shqiptarët janë zbankuar në këtë qytet në vitet 1968-1972. Vlen të theksohet se 44 subjekte (38%) kanë kaluar jetën e tyre 70% në mërgim. Pasonë 41 subjekte (35,3%) që kanë kaluar jetën e tyre në mërgim ndërmjet 25-50%. 20 subjekte (17,2%) kanë kaluar më pak se 25% në mërgim dhe 11 subjekte (9,5%) kanë kaluar tërë jetën e tyre në mërgim.²³⁴

5.5. Pjesëmarrja e të anketuarve sipas llojit të lejqëndrimit dhe prejardhjes

Nga tabela nr.6 del rezultati se nga 116 pjesëmarës, 24 subjekte (20,7%) kanë shtetësi gjermane. 7 subjekte (6%) kanë lejqëndrimi të kufizuar dhe 85 subjekte (73,3%) kanë lejqëndrimi të pakufizuar.²³⁵ Nga tabela nr.8 del rezultati se nga 116 pjesëmarës, 2 subjekte

²³¹ Po aty, Tabela nr. 4.

²³² Po aty, Tabela nr. 9 dhe 11.

²³³ Po aty, Tabela nr. 5.

²³⁴ Po aty, Tabela nr. 7.

²³⁵ Po aty, Tabela nr. 6.

(1,7%) janë nga Shqipëria. 16 subjekte (13,9%) janë nga Kosova. 95 subjekte (81,8%) janë nga Maqedonia dhe 3 subjekte (2,6%) janë nga trojet etnike shqiptare.²³⁶

Leja e qëndrimit në përputhje me ligjin në Gjermani është e ndërlidhur kryesisht me vet kohëzgjatjen e qëndrimit në këtë vend. Tanimë emërtimet me tituj: „Aufenthaltsebefugnis“, „Aufenthaltsbewilligung“, „Aufenthaltsurlaubnis“ i kufizuar ose i pakufizuar në kohë (befristet dhe unbefristet) dhe „Aufenthaltsberechtigung“ janë të përmbledhura në dy lloj vizash qëndrimi të cilat do të analizohen më poshtë. Leja e qëndrimit për migrantët shqiptarë në shumicën e rasteve është ndërlidhur edhe me vendin e punës dhe në lidhje me këtë qëllim janë përpiluar ligjet në §16 deri 38a. Përveç qëllimit të punës, migrantët shqiptarë kanë përfituar edhe nga qëndrimi për qëllime arsimit (§16 deri 17), qëndrimi për arsye humanitare dhe politike (§22 deri 26), qëndrimi për arsye familjare (§ 27 deri 36) etj.²³⁷ Me ligjin e ri për të huaj të miratuar nga presidenti i shtetit me 30.07.2004 u janë bërë ndryshime të konsiderueshme lejeve të qëndrimit. Me këtë ligj kërkohet zbatimi i kurseve të integritimit, ndërsa leja e qëndrimit do të quhet leja e banimit.

Emërtimet e lejeve të vjetra me këtë ligj do të reduktohen në dy:

1. „Aufenthaltsurlaubnis“ (i kufizuar në kohë),
2. „Niederlassungserlaubnis“ (i pakufizuar në kohë).²³⁸

Nga viti 2000, kush është lindur në Gjermani edhe nëse të dy prindët nuk i ka gjerman ai automatikisht fiton shtetësinë gjermane. Nëse njëri nga prindërit ka shtetësi tjetër fëmiu mund të ketë dy shtetësi, por nëse fëmiu ka marrë edhe shtetësinë e prindërve ai në moshën 18 vjeçare njëherë duhet ta lëshojë.²³⁹ Nëse fëmijëve të lindur në Gjermani shtetësia iu jepet automatikisht, të tjerët nëse kanë jetuar për tetë vite me leje të rregullt qëndrimi mund të parashtrajnë kërkesë për natyralizim. Natyralizimi realizohet përmes testit përkatës të përpiluar me pyetje nga fusha e njohurive mbi ligjet e vendit, njohuri për temat sociale, njohuri fetare, etj. Ky test është përgatitur nga ekspertët e universitetit „Humboldt“ të Berlinit të cilët kanë përgatitur një listë me 310 pyetje nga e cila nxirren 33 pyetje dhe nëse 17 prej tyre kanë përgjigje pozitive testi konsiderohet i kaluar.²⁴⁰

Me fuqizimin e këtij ligji u ndryshuan edhe disa emërtime të cilat sadopak konsideroheshin diskriminuese për të huajt si psh. „Ausländerbeiräte“ (Entet për të huaj), tanimë quhen „Migrations und Integrationsräte“ (Entet për migracion dhe integracion). Nga

²³⁶ Po aty, Tabela nr. 8.

²³⁷ bamf.de, *Enti për Migracion dhe Refugjat*, (26.11.2011).

²³⁸ Po aty

²³⁹ *Das Neue Staatsbürgerschaftsrecht*, 01.01.2000, (23.11.2011).

²⁴⁰ *Deutsche Welle, publikuar më*, 19.07.2011 (23.11.2011).

tabela nr.6 shihet se 21% e migrantëve shqiptarë në qytetin e Leverkusenit kanë shtetësi gjermane dhe tendencat janë në rritje për marrjen e shtetësisë. Pjesa dërmuese e të anketuarve 73% kanë lejebanimi të rregullt „Niederlassungserlaubnis“ (i pakufizuar në kohë) ndërsa vetëm 6% akoma kanë leje banimi „Aufenthaltserlaubnis“ (i kufizuar në kohë).²⁴¹

Qyteti i Leverkusenit sipas statistikave të datës 31.12.2007²⁴² ka 162.878 banorë, prej tyre 18.878 janë të huaj. Nga numri i përgjithshëm i të huajve 1.767 rezulton të jenë nga Maqedonia prej të cilëve 957 janë të gjinisë mashkullore²⁴³. Nga numri i migrantëve me shtetësi të Maqedonisë 95% janë shqiptarë. Nga kjo konkludohet se migrantët shqiptarë në këtë qytet zënë vendin e tretë pas turqve me 4.163 banorë dhe italianëve me 2.416 banorë.²⁴⁴ Nga tabela nr.6 shihet se pjesa më e madhe e migrantëve shqiptarë në qytetin e Leverkusenit janë nga Maqedonia që përbëjnë 81,8% të anketuarve. Pasonjë shqiptarët nga Kosova me 13,9%, pastaj nga trojet etnike (Presheva, Bujanovci dhe Medvegja) me 2,6% dhe nga Shqipëria me 1,7%.

5.6. Ngjasimi i migrantit shqiptar me një vendës dhe të ndjenjurit i huaj në Gjermani

Përceptimi apo kognicioni përfshinë të menduarit, kujtesën, të ëndërruarit (imagjinatën), etj. Mills Charles Wright sociolog amerikan imagjinatën e përshkruan si një mënyrë e të vështruarit të botës që mund të gjejë lidhje ndërmjet problemeve në dukje private të individit dhe çështjeve të rëndësishme sociale.²⁴⁵ Këto përceptime tek migranti vëzhgohen me një sy krejtësisht tjetër. Duke qenë larg vendlindjes, familjes, miqve dhe shokëve, të menduarit, kujtesa dhe të ëndërruarit përcepton ndryshe. Migranti shqiptar që ka lindur apo ka kaluar më tepër se gjysmën e jetës në mërgim,²⁴⁶ akoma e ka vështirë të adaptohet. Nga tabelat nr. 14, 15, 16 dhe 17 dalin këto rezultate:

²⁴¹ Shih Shtojca, Tabela nr. 6.

²⁴² leverkusen.com, Ka statistika edhe më të reja të vitit 2010, por detaljet e vitit 2007 janë më të precizuara, dhe numri i popullatës së përgjithme ka rënie në 161.132 prej të cilëve 18.586 janë të huaj, (24.11.2011)

²⁴³ Po aty, *Stadt Leverkusen, Statistische Kurzberichte*, (23.11.2011).

²⁴⁴ Po aty, *Bevölkerung*, (23.11.2011).

²⁴⁵ Marshall, *Fjalor Sociologjik i Oksfordit*, fq. 250.

²⁴⁶ Shih Shtojca, Tabela nr. 5 dhe 7.

5.7. Dimensionet e përceptimit të migrantëve shqiptarë

Konstatohet përmes rezultateve se të qenurit ndryshe të migrantët shqiptarë është shprehur haptazi. Migrantët të qenurit ndryshe e ndërlidhin me shumë elemente, një ndër elementet kryesore është që migranti të mos jetë i ndikuar nga mendimi i huaj. Duke qenë migrantët shqiptarë të ndërlidhur ngushtë me kulturën e tyre kombëtare dhe fetare kanë krijuar aleancë të fuqishme. Këto vlera janë në gjendje të mbrojnë edhe nëse të gjithë janë kundër tyre, njëkohësisht të qenurit ndryshe është të kuptosh vetveten dhe të dish të komunikosh me të tjerët.

Përmes këtij hulumtimi vërehet haptas se nga 116 të anketuar, 114 migrantë shqiptarë në Leverkusen të Gjermanisë përcaktohen se sa ngjasojnë me një person „tipik gjerman“. Rezulton se nga 114 të anketuar, 77 prej tyre (67,5%) aspak nuk ngjasojnë me një person „tipik gjerman“. 20 prej të anketuarve (17,2%) pohojnë se nuk janë të ngjashëm.²⁴⁷ Nga këto statistika ngjashëm rezultojnë 16 të anketuar (14,5%) dhe shumë ngjashëm 1 i anketuar (0,8%). Rezultatet e tabelës nr.15, mundësojnë të kuptohet se nga 116 të anketuar, 75 prej tyre (64,6%) ndjehen të huaj në Gjermani, ndërsa 41 të anketuar (35,4%) nuk e ndiejnë veten të huaj në Gjermani.²⁴⁸

5.8. Migrant shqiptar mund apo jo të bëhet gjerman

Bazuar në rezultatet e tabelës nr.16 konstatohet se migrantët shqiptarë të anketuar në këtë hulumtim për pyetjen se „kur do të ishte njeriu gjerman“, të formuluar me 16 konkluzë, japin këto rezultate. Nga 116 të anketuar, 60 prej tyre (51,7%) konsiderojnë se njeriu është gjerman nëse prindërit i ka gjerman. 41 prej tyre (35,3%) mendojnë se migranti asesi nuk mund të bëhet gjerman. 21 prej tyre (18,1%) mendojnë se nëse migranti ndjehet si gjerman ai atëherë do ishte gjerman. 14 prej tyre (12 %) janë të mendimit se nëse migranti identifikohet me Gjermaninë ai atëherë mund të jetë gjerman.²⁴⁹

Rezultatet e konkluzave tjera nuk janë relevante dhe variojnë nga 9,4% nëse është i akceptuar nga gjermanët ashtu si është deri 0,8% nëse një kohë të gjatë ka jetuar në Gjermani apo nëse ka pamje gjermani. Migrantët shqiptarë të pyetur se kjo që deklaruan më sipër në tabelën nr.16, a ka të bëjë edhe me ju, prej 116 të anketuarve, 61 prej tyre (52,5%) deklarojnë

²⁴⁷ Po aty, Tabela nr. 14.

²⁴⁸ Po aty, Tabela nr. 15.

²⁴⁹ Po aty, Tabela nr. 16.

se kjo ska të bëj me mua. 35 prej tyre (30,2%) deklarojnë se kjo më përket mua. 15 prej tyre (13%) përgjigjen se kjo më përket mua pjesërisht dhe në fund nga 116 të anketuar, 5 prej tyre (4,3%) mbeten indiferent për sa i takon kësaj pyetje.²⁵⁰

5.9. Besueshmëria dhe vlera e statistikave përshkruese

Përmes rezultateve të mësipërme konstatohet se statistikat kontribuojnë për tubimin, analizimin, interpretimin dhe shpalosjen e ndjenjave identifikuese të migrantit shqiptar. Rezultatet janë shumë të besueshme dhe cilësore ngase rrjedhin nga vetë migrantët shqiptarë në Leverkusen. Të dhënat statistikore në këtë punim kanë mundësuar reflektimin e seriozitetit të identitetit kombëtar dhe fetar në shoqërinë shqiptare të këtij qyteti. Këto statistika ndikojnë në hartimin dhe planifikimin e eksperimenteve dhe mostrave të duhura për mbrojtje, zhvillim dhe kultivim të mëtejshëm të identitetit. Koleksioni i të dhënave statistikore në këtë punim është i dobishëm për migrantët shqiptarë ngase përshkruan qëndrimet reale të konkluzioneve të hipotezave të studimit. Duke qenë konkluzionet të vërteta arrihet qëndrueshmëria dhe besueshmëria e statistikave përshkruese.

²⁵⁰ Po aty, Tabela nr. 17.

6. Verifikimi dhe diskutimi i hipotezave

Grup statistika e parë, përfshinë totalin e përcaktimit të migrantëve shqiptarë në Leverkusen rreth identifikimit të tyre me kulturën kombëtare, gjermane dhe fetare.

Hipoteza / Konkluz ²⁵¹	1	2	3	4	5	6	Gjithsej
Identifikimi me kulturën kombëtare	79	86	72	77	87	104	505
Identifikimi me kulturën gjermane	76	15	27	14	7	2	141
Identifikimi me kulturën fetare	90	91	81	84	93	108	547
Gjithsej	245	192	180	175	187	214	

Grup statistika e dytë, përfshinë totalin e përcaktimit të migrantëve shqiptarë në Leverkusen rreth përbërjes dhe strukturës së shoqërisë së tyre.

Hipoteza/Konkluz ²⁵²	1	2	3	4	5	Gjithsej
Shokë të kulturës kombëtare	3	5	13	62	33	
Shokë të kulturave tjera	2	61	16	7	0	
Shokë të kulturës gjermane	3	41	20	15	0	
Gjithsej	8	107	49	84	33	281

Grup statistika e tretë, përfshinë totalin e përcaktimit të migrantëve shqiptarë në Leverkusen rreth kontaktimit me pjesëtarët e këtyre kulturave.

Hipoteza/Konkluz ²⁵³	1	2	3	4	5	Gjithsej
Takimi me pjesëtarët e kulturës kombëtare	1	3	13	67	32	
Takimi me pjesëtarët e kulturave tjera	2	29	30	15	6	
Takimi me pjesëtarët e kulturës gjermane	2	27	26	14	13	
Gjithsej	5	59	69	96	51	280

²⁵¹ Shih Shtojca, Tabela nr. 9, 10 dhe 11.

²⁵² Po aty, Tabela nr. 18.

²⁵³ Po aty, Tabela nr. 19.

6.1. Hipoteza e parë

Informacionet e mbledhura përmes këtij hulumtimi shkencor, kanë mundësuar që të ketë një pasqyrë më të qartë mbi gjendjen e identitetit dhe integritit të migrantit shqiptar në Gjermani, gjegjësisht në qytetin e Leverkusenit. Çdo informacion i plasuar brenda këtij studimi shkencor konsiderohet i vërtetë, por njëherit mund edhe të verifikohet. Migrantët shqiptarë të anketuar përmes pyetjeve të ndërlidhura me hipotezën e parë shfaqin vlera serioze rreth identifikimit të tyre me kulturën kombëtare. Dimensionin e identitetit kombëtar në radhë të parë ka nxjerrë në shesh seriozitetin e identitetit të migrantëve shqiptarë nga të gjitha trojet.

Prej kategorive të pyetjeve të ndërlidhura me këtë hipotezë është konstatuar se të anketuarit duke potencuar me 505 përcaktime (thënie), verifikojnë bindshëm vlerat e identitetit të tyre kombëtar, (grup statistika e parë). Nga ky hulumtim veçori më pozitive verifikohet vërtetimi përmes korelacionit „unë jam i ndërlidhur me atdheun tim“, kjo veçori është përcaktuar me 108 thënie.²⁵⁴ Si veçori pozitive ka dalë edhe përcaktimi se „unë ndjehem dhe jam shqiptar“ me 104 përcaktime nga 116 të anketuar. Përmes kësaj verifikohet testi i hipotezës së parë për ndikimet pozitive që sjellë kultura kombëtare për mbrojtjen e identitetit në kohën e përplasjeve kulturore gjatë proceseve integruese.²⁵⁵

Kjo hipotezë verifikon se migrantët shqiptarë nuk janë ksenocentrist. Ata dinë të vlerësojnë kulturën kombëtare dhe respektojnë atë gjermane, poashtu janë krenar dhe ndjehen komod me kulturën e tyre kombëtare. E gjithë kjo qartë mund të verifikohet edhe përmes tabelës nr.9 ku ka mundësi të shihet se migrantët shqiptarë kanë qëndrime pozitive me veçori identike për çdo konkluzë duke filluar të vlerësojnë me 62% e që ngritet deri më 90%.²⁵⁶

Verifikimi i hipotezës së parë bazohet në atë se migranti shqiptar nuk heziton gjatë kontakteve të veta me pjestarët e kulturës së vet dhe të kulturave tjera të shfaqë tiparet e lidhshmërisë së tij me kulturën personale. Kjo verifikohet përmes grup statistikës së dytë dhe të tretë në të cilën shihet se migranti është shprehur me 280 gjegjësisht 281 thënje për të vlerësuar se i kushton rëndësi kontaktimit dhe përbërjes shoqërore. Verifikohet në aspektin negativ se një përqindje minimale e migrantëve nuk kontaktojnë me shokë dhe bashkatdhetarë, të njejtit duke justifikuar varfërinë atdhedashëse mendojnë të jenë integruar paraprakishtë.

²⁵⁴ Po aty, Tabela nr. 12.

²⁵⁵ Po aty, Tabela nr. 9.

²⁵⁶ Po aty, Tabela nr. 9.

Hulumtimi përmes kësaj hipoteze verifikon se migrantët shqiptarë ndjehen pjesë integrale e shoqërisë vendëse në qytetin e Leverkusenit dhe minimalisht ndjehen të diskriminuar dhe në pozitë të pafavorshme.²⁵⁷ Ata me 77 konfirmime pohojnë se aspak nuk ngjasojnë me një person „tipik gjerman“²⁵⁸ dhe me 75 konfirmime pohojnë se ndjehen të huaj në Gjermani.²⁵⁹ Përmes kesaj hipoteze verifikohet se kombi dhe shtetësia për migrantët shqiptarë nuk janë e njëjta gjë. Duke pasur për momentin 20,7% migrantë shqiptarë me shtetësi Gjermane verifikohet vetëvetiu e vërteta përceptuese e të anketuarve se „njeriu do të ishte gjerman nëse prindët i ka gjerman“. Kështu vlerësojnë 51,7% të intervistuar.²⁶⁰ Një ndër vlerat më kryesore që verifikon kjo hipotezë është aspekti i trajtimit pothuajse paralel të gjuhës shqipe dhe gjermane si mjet komunikimi në familje apo më gjërë. Kjo hipotezë verifikon se 34 me 33 të anketuar në dobi të shqipes flasin shkëlqyeshëm shqip, gjegjësisht gjermanisht. 45 me 37 në favor të shqipes lexojnë shkëlqyeshëm. 40 me 30 poashtu në favor të shqipes shkruajnë shkëlqyeshëm dhe së fundi 44 me 38 fatmirësisht në favor të shqipes akoma kuptojnë shkëlqyeshëm.²⁶¹

Termi kulturë përfshinë një fushë të gjërë antropologjike e cila përmbledh norma dhe vlera kulminante përmes së cilave rregullohen dhe trajtohen shumë aspekte jetësore, qofshin individuale, familjare apo kolektive. Antropologjia kulturore orientohet në studimin e vlerave religjioze, mitologjike, gjuhësore, etike, etj.²⁶² Përmes këtij hulumtimi është tentuar që në mesin e mërgimtarëve nga të gjitha trojet etnike të analizohet elementi i identitetit kombëtar në frymën kulturore si një terminologji tejet e përfolur gjatë proceseve integruese. Në literaturë dhe në disa shkenca janë në përdorim terma të shumta që ndërlidhen me integrimin, si: proceset integrative, integrimi ekonomik, integrimet etnike, integrimet ndërkombëtare, rajonale, shpirtërore. Përdoret edhe termi integriteti cerebral, integriteti i personalitetit dhe termi akti integrativ. Gjendet edhe kjo terminologji; edukata integrale, integrimi i sistemit në arsim, integrimi në shkollë, etj.²⁶³ Bazuar në këto terma, integrimi i ndërlidh njerëzit dhe popujt e strukturave të ndryshme etnike, fetare dhe sociale, kulturave, gjuhëve dhe zakoneve

²⁵⁷ Po aty, Tabela nr. 13.

²⁵⁸ Po aty, Tabela nr. 14.

²⁵⁹ Po aty, Tabela nr. 15.

²⁶⁰ Po aty, Tabela nr. 16.

²⁶¹ Po aty, Tabela nr. 21.

²⁶² Qahili, Reshat, *Antropologjia filozofike*, Tetovë, 2007, fq.11.

²⁶³ Rexhepagiq, Jashar, *Përparësitë, fushat e veprimit dhe kufijtë e ndikimit të proceseve integrative*, Edukata islame, BIK, Prishtinë, 2003, fq. 197.

të ndryshme dhe të nivelit të ndryshëm të zhvillimit, me të përparohen marrëdhëniet ndërnjerëzore.²⁶⁴

Një analizë më e përafërt e integrimit në sferat e jetës shfaqet përmes krijimtarisë kulturore, shkencore, industriale, në komunikimin midis njerëzve, etj. Migranti është krijues apo ndikues në krijimin e kulturave të reja të cilat në këto procese bartin konceptet e multikulturalizmit. Njeriu, gjegjësisht migranti si qenie kulturore përballet edhe me efektet e ndryshimeve kulturore të cilat nganjëherë domosdoshmërisht duhet ti gëlltisë.²⁶⁵ Hipoteza e parë jep të kuptohet se migrantët shqiptarë në Leverkusen gjenden në gjendje natyrore dhe origjinale brenda konditave të vlerave të identitetit kombëtar. Kjo mundëson të konstatohet se tendencat integruese nganjëherë shihen si kërcënim ndaj identitetit. Migrantët shqiptarë cilësi parimore rezulton të kenë mburrjen dhe krenarinë kombëtare, në veçanti lidhshmërinë me ndjenjat dhe kulturën kombëtare e cila ka inspiruar edhe shkrimtarët dhe patriotët e të gjitha kohërave.

Në bazë të të arriturave të këtij hulumtimi virtyt më i potencuar i migrantit shqiptar rezulton të jetë vlera, „krenaria e identifikimit me kulturën kombëtare“, si një ndër cilësitë më të rëndësishme të identitetit individual dhe kolektiv. Problem i shoqërisë shqiptare në mërgim mbetet aftësia e reflektimit të vlerave, traditave dhe normave kulturore në fushën akademike. Kjo për momentin është pasojë e mungesës së kuadrove me ngritje universitare. Në këtë drejtim shoqëria shqiptare në mërgim, gjegjësisht në Leverkusen karakterizohet në nivel të lartë organizativ përmes investimeve emocionale për manifestimet kulturore me rastin e festave të ndryshme kulturore dhe kombëtare. Në anën tjetër kualifikimi dhe aftësia profesionale ka ndikuar që populli vendës të krijoj një opinion pozitiv ndaj migrantëve, gjegjësisht kulturës kombëtare shqiptare. Për tu integruar me popujt tjerë duhet një përpjekje serioze me angazhim dhe mund të madh që në rradhë të parë të arrihet mëkëmbja ekonomike si gjenerator i realizimit të të gjitha synimeve. Ky studim tregon se migrantët shqiptarë më tepër se gjysmën e jetës së tyre e kanë kaluar në mërgim. 70% e të anketuarve ishin të moshës deri 45 vjeçare nga të cilët 43% ishin deri 30 vjet në mërgim.

Me kalimin e kohës jetesa e gjatë larg atdheut shkakton shumë pasoja të cilat ndikojnë edhe në parimet dhe vlerat kulturore kombëtare. Një e vërtetë me tipare të mungesës së vetëbesimit apo nismave individuale dhe shoqërore reflektohet nga ky studim se nuk përkon me gjendjen e identitetit kombëtar të migrantit. Vazhdon të mbetet tejet tipike shqiptare ajo se ata që janë lindur në Gjermani nuk e kanë këtë simptom. Gjatë proceseve të integrimi

²⁶⁴ Po aty, fq. 201.

²⁶⁵ Po aty, fq. 202.

europiane kërkohet „përshtatja ndaj popullatës shumicë“ e cila ka për qëllim identifikimin me kulturën e shoqërisë gjermane. Ndër migrantët shqiptarë kjo trajtohet si diçka që duhet respektuar në masë të duhur, por jo të përngjarë me një kulturë tjetër. Këtë e potencojnë 84,7% e migrantëve.²⁶⁶ Duke trajtuar këtë hipotezë për nga numri i popullsisë së përgjithshme të këtij qyteti, është theksuar më herët se 32,92% e popullsisë së përgjithshme në këtë qytet janë me origjinë të huaj²⁶⁷ në të cilën gravitojnë edhe shqiptarët.

Shqiptarët si komuniteti i tretë më i madh nga rradhët e të huajve në Leverkusen, (pas turqve dhe italianëve) paraqesin fuqinë për të ndikuar në krijimin e jetës më të begatshme multikulturore. Atyre u jepet mundësia për realizimin dhe sigurimin e të drejtave të tyre legjitime përmes „entit për integrim“ pjesë e të cilit figurativisht janë edhe migrantët shqiptarë. Realizimi i anketës me shkrim dhe në mënyrë anonime ka mundësuar që i anketuari lirshëm të shpalosë ndjenjat e veta kombëtare. Kjo që duhet diskutuar jo vetëm brenda këtij punimi por edhe më gjërë është fakti se ka të bëjë me fillimin e paraqitjes së simptomave të para tjetërsuese. Gjatë verifikimit kuptohet se nga 116 të anketuar vetëm 104 prej tyre përcaktohen se janë shqiptarë, 12 migrantë shqiptarë nuk deklarojnë identitetin e tyre kombëtar. Duke u ngritur ky numër në 10% detyron të debatosh seriozisht për këtë fenomen që veç ka filluar t’i jep sinjalet e para.²⁶⁸

Me siguri se nuk ka humbje më të madhe për një komb se të humbë njerëzit e vet. Humbja e njerëzve të kombit shqiptar historikisht ka ekzistuar si pasojë e sundimeve të huaja, por ajo që tani duhet debatuar në kohën e përparimeve demokratike është si ky fenomen të minimizohet. Ndoshta smundet që ky fenomen të diskutohet vetëm nga prizmi i të papërcaktuarve kombëtarisht, ngase përqindja e migrantëve shqiptarë që bartin shtetësi gjermane është më e madhe, e që shkon në 20,7%.²⁶⁹ Ndikimet pozitive të kulturës kombëtare fenomeni „varfëri“ i shfuqizon dhe i degradon. Kjo ndikon që një pjesë e migrantëve shqiptarë të parapëlqejnë kulturat e huaja duke menduar se ajo ua ka larguar varfërinë. Shqiptarët edhe pse kanë patur varfëri, komoditeti me kulturën kombëtare shumicës nuk ju ka munguar, njëherit është konsideruar si elementi më organik i krenarisë kombëtare. Kështu mendojnë 72 të anketuar.²⁷⁰

Migranti shqiptar identifikohet me kulturën kombëtare edhe përmes lidhshmërisë dhe kontakteve të vazhdueshme me vendlindjen, gjegjësisht vendin e origjinës si nevojë themelore

²⁶⁶ Shih Shtojca, Tabela nr. 14.

²⁶⁷ leverkusen.com, *Stadt Leverkusen, LIGA.NRW*, Mikrozensus 31.12.07, (23.11.2011).

²⁶⁸ Shih Shtojca, Tabela nr. 9.

²⁶⁹ Po aty, Tabela nr. 6.

²⁷⁰ Po aty, Tabela nr. 9.

që rrjedh nga ekzistenca njerëzore.²⁷¹ Këtë migranti shqiptar vazhdon ta kultivojë me nostalgji në formën më të mirë. Një nga nevojat themelore është nevoja për bashkim, një nevojë e kundërt me narcizoizmin. Sipas mendimit të Fromit, njeriu edhe sikur t'í plotësojë të gjitha nevojat fiziologjike, ne saje të asaj që posedon arsye dhe imagjinate, ndien nevojë të bashkohet me të tjerët.²⁷² Dëshira për lidhje ndërpersonale, për Fromin, është përpjekja më e fuqishme te njeriu, pasi ajo është pasioni më themelor, përkatësisht është forca e cila mban të bashkuar racën njerëzore, fisin, familjen, shoqërinë.²⁷³

Duke ndryshuar në të mirë gjendja materiale e shqiptarëve që është pretekst për përparime më të mëdha, shihet se në të kundërtën në disa raste lind xhelozia. Kur shihet njeri nga anëtarët e familjes, apo një bashkatdhetar që është ngritur në një nivel më të lartë, fillon përdorimi i disa sjelljeve dhe rrugëve të cilat përfundojnë në ftohje apo nganjëherë edhe në ngrirje të kontakteve. Me rastin e kontaktimit dhe shkëmbimit kulturor migranti shqiptar përmes kësaj përvoje normalisht se jep dhe merr nga kulturat tjera. Tanimë ka raste që kanë të bëjnë me fillimin e formimit të miqësive ndërfamiljare. Ky ndryshim sociokulturor reflektohet minimalisht edhe në shoqërinë shqiptare të mërgatës.

Shoqëria, familja shqiptare tradicionale e cila me xhelozin ruante dhe trashigonte vlerat dhe normat që ndikonin në krijimin e bashkëshortësive, me ndërrimin e gjeneratave ka filluar të ketë një trajtim tjetër. Martesat e përziara që dikur bëheshin vetëm nga meshkujt, tani bëhen edhe nga femrat. Martesa e përziara janë bashkëshortësitë me origjinë etnike dhe fetare të ndryshme. Sa i përket mërgatës shqiptare në Leverkusen të Gjermanisë ka të bëjë me raste të rralla të cilat nuk formojnë përqindje. Konkluzionet e para të thjeshta janë se me kalimin e kohës, brenda një gjenerate, komunitetet e migrantëve do të ishin asimiluar, së paku në qëndrimin e tyre ndaj kombit dhe fesë. Disa vëzhgues sugjeronin se në veçanti martesat e përziara ishin një faktor i madh në këtë proces të pritur të asimilimit.²⁷⁴ Duke marrë nga kultura e vendit pritës dhe duke anashkaluar praktikimin e kulturës kombëtare mund të shihen dallimet në shoqëritë shqiptare të mërgatës.

Sot vërehen disa dallime në familje apo traditë, pavarësisht sa janë ato të kërkuara dhe të nevojshme për integrim në shoqërinë përkatëse. Në vendet ku jetojnë migrantët shqiptarë kanë për detyrë të përcjellin gjeneratë pas gjenerate të gjitha tiparet dhe vlerat e kombit, një ndër vlerat më kryesore që duhet kultivuar është tradita dhe gjuha shqipe si mjet komunikimi

²⁷¹ Qahili, Reshat, *Mendimi antropologjik i Erih Fromit*, Vatra, Shkup, 2008, fq. 82.

²⁷² Po aty.

²⁷³ Po aty, fq. 83.

²⁷⁴ Ramadan, *Të jesh mysliman Evropian*, fq. 12.

në familje dhe më gjërë. Të qenët një hallkë në zixhirin e breznive të njëpasnjëshme, për shumë njerëz dhe shoqëri në histori, në këtë kohë është krenari. Shkaku pse traditat shoqërore, urtësitë hyjnore dhe kulturat njerëzore u përballojnë sulmeve dhe reagimeve kaq të ashpra, mund të shpjegohet me ndjenjën e fortë të lidhshmërisë që ka njeriu me të kaluarën.²⁷⁵

Tradita është bartëse e unitetit dhe kontinuitetit historik. Struktura tradicionale është fenomen i ngurtësimit të vlerave autentike të cilat duhet përcjellur prej brezi në brez, si rezultat i një institucionalizimi të caktuar.²⁷⁶ Migrantët që fjalët e para i mësuajnë në gjuhën shqipe duke luajtur me shokë në rrugë apo në shkollë, tash larg atdheut për një kohë të gjatë sa mirë flasin, lexojnë, shkruajnë dhe kuptojnë, është temë diskutimi në hipotezën e parë. Nëse kalon më tepër se gjysmën e jetës në mërgim, nganjëherë duhet të kujtohesh për një shprehje, duke ju nënshtruar haresës gjuhësore migranti i gjeneratave të para, e çka mund të thuhet për të lindurin në Gjermani. Familja duhet të jetë e vetëdijshme për rolin kryesor që ka për kultivimin e gjuhës shqipe. Familja, gjegjësisht nëna, duhet të ketë përkushtim ndaj gjuhës amtare që fëmijës së vet t'ia mësojë shprehjet e para në gjuhën shqipe.

Komunikimi shqip dhe mësimi i gjuhës shqipe lidhet me identitetin dhe ardhmërinë e kombit, por për shumë të rinj dhe të reja nga rradhët e migrantëve sot gjuha shqipe bëhet gjuhë e dytë për ta. Ky problem nga dita në ditë mer përmasa më të mëdha i cili nuk përfshinë vetëm të lindurit në Gjermani por edhe të tjerët. Nëse krahasohet niveli gramatikor i atyre migrantëve që flasin shqip bindesh se mungon shqiptimi i drejtë i shkronjave. Një pjesë këtë mungesë e përjeton në shpirt me dhimbje duke u shqetësuar se është shqiptar dhe nuk e din gjuhën e nënës. Një pjesë tjetër as që brengoset për këtë çështje, injoron gjuhën amtare dhe kështu fëmijëve të vet jua humb lidhshmërinë me origjinën duke i shndërruar në shqiptar pa asnjë ndjenjë kombëtare. Duhet hulumtuar të gjitha mundësitë për të zbuluar arsyet që ndikojnë në këtë dukuri shqetësuese me të cilën përballlet gjuha shqipe ndër migrantët, e që mundë të përfundojë në harresë dhe injorim kolektiv, njejtë si ndër shqiptarët e Rumanisë, Turqisë, etj. Duke diskutuar për këtë çështje kaq të rëndësishme nganjëherë në vend që të analizohen pengesat, mundohet që faji ti hudhet dikujt, në këtë rast viktimë është organizimi i qendrave religjioze.

Në Gjermani qendrat religjioze janë të organizuara mirë dhe funksionojnë jo vetëm për kryerje të riteve fetare, por njëherit në mungesë të institucioneve përkatëse bartin edhe përgjegjësitë tjera kombëtare, të cilat me nderë dhe krenari nuk hezitojnë për ti bërë.

²⁷⁵ Bullaç, *Historia, shoqëria dhe tradita*, fq. 251.

²⁷⁶ Po aty, fq. 291.

Çuditërisht mektebi ka më tepër nxënës se shkolla shqipe, e në të dyjat shqip shpjegohet. Migrantët shqiptarë ashtu sikurse që janë fetar të mirë janë edhe atdhetar të mirë.

6.2. Hipoteza e dytë

Verifikimi i hipotezës së dytë bazohet mbi qëndrimin e migrantëve shqiptarë në Leverkusen të Gjermanisë ndaj identifikimit të tyre me kulturën gjermane. Migrantët shqiptarë verifikojnë me 141 thënje të përgjithshme (grup statistika e parë) dhe me 76 konfirmime direkte nga 116 të anketuar, gati paralelisht me konkluzën e parë të hipotezës së parë, se „kultura gjermane ka ndikim pozitiv në jetën e tyre“.²⁷⁷ Migrantët shqiptarë japin këto vlerësime duke verifikuar me 43% se mbi 40 vjet kanë jetë të përbashkët me këtë popull që është human, nuk rrenë, e mbanë fjalën, qëndron në premtime, është i sinqertë, korrekt, etj.²⁷⁸

Nga ky studim me veçori pozitive verifikohet edhe vërtetimi përmes korelacionit „unë jam i ndërlidhur me Gjermaninë“. Kjo veçori e cila u përcaktua me 108 thënie nga 116 të anketuar në konkluzën e hipotezës së parë „unë jam i ndërlidhur me atdheun tim“, tani tërheq vëmendjen e 56 të anketuarve (48,2%) që përcaktohen për këtë konkluzë duke pohuar se janë të ndërlidhur me Gjermaninë. Gradualisht verifikohet se Gjermania është atdheu i dytë i migrantëve shqiptarë.²⁷⁹ Në të gjitha rastet verifikohet ngecja e migrantit shqiptar për tu identifikuar me kulturën gjermane. Për verifikim veçohet rasti se nga 20,7% bartës të shtetësisë gjermane vetëm 2 të anketuar ndjehen se janë gjerman.²⁸⁰ Konceptualisht mes hipotezës së parë dhe të dytë përmes statistikave konstatohet një diferencë shumë e madhe. Bazë ilustrimi janë rezultatet e korelacionit dhe besueshmërisë me „unë jam i ndërlidhur me atdheun tim“ dhe „unë jam i ndërlidhur me Gjermaninë“. Migrantët shqiptarë duke u përcaktuar me 48,2% se janë të ndërlidhur me Gjermaninë shfaqin dëshirën serioze për tu integruar në shoqërinë gjermane. Njëherit përmes kësaj verifikohet stabiliteti individual dhe kolektiv për të ndërtuar fqinjësi të mirë.²⁸¹

Në segmente të caktuara migrantët shqiptarë nuk hezitojnë të identifikohen me kulturën gjermane. Identifikimi me këtë kulturë ata i bënë më të kompletuar dhe ju hapë mundësinë për kuptimin edhe më të drejtë të shumë gjërave që ndërlidhen me jetën në

²⁷⁷ Shih Shtojca, Tabela nr. 10.

²⁷⁸ Po aty, Tabela nr. 5

²⁷⁹ Po aty, Tabela nr. 12.

²⁸⁰ Po aty, Tabela nr. 10.

²⁸¹ Po aty, Tabela nr. 12.

mërgim.²⁸² Gjermania nuk lejon dy nënshtetësi dhe migrantët shqiptarë s'i pengon që të identifikohen me dy kultura. Si bartës të shtetësisë gjermane apo të një leje qëndrimi të rregullt migrantit i mundësohet me të gjitha normat që të fitojë të drejtën legjitime për tu identifikuar me kulturën gjermane si me kulturën e origjinës. Migrantët shqiptarë identifikohen me kulturën gjermane përmes gjuhës të cilën e flasin, e lexojnë, e shkruajnë dhe e kuptojnë shumë mirë. Ky hulumtim mundëson të konstatohet se a ka të bëjë me shfaqjen e një botëkuptimi paralel ndaj konceptimit të gjuhëve.²⁸³ Duke diskutuar për këtë botëkuptim paralel parafytyrohet një fuqi me dy pole të kundërta. Parashtrahet pyetja se proceset integruese a kushtëzojnë që njëri pol të eliminojë tjetrin? Gjegjësisht a është e drejtë që njëren gjuhë ta përngjajë me polin pozitiv e tjetrën me atë negativ? Aq sa është e polit pozitiv gjuha shqipe poashtu është e polit pozitiv edhe gjuha gjermane si gjuhë e proceseve integruese dhe si gjuhë komunikimi, shkence, pune, studimi, etj.

Në asnjë mënyrë migranti shqiptar nuk guxon të jetë i rrethuar me mjegulla përkufizuese të cilat pengojnë dhe ndërlikojnë shpejtësinë dhe dinamikën e ecurive dhe përparimeve integruese. Ka kaluar koha e konfuzioneve kontradiktore mes termave „kulturë“ dhe „qytetërim“. Françezët dhe anglezët deri nga gjysma e shekullit XIX dhe fillimi i atij XX e kanë përdorur fjalën „qytetërim“. Gjermanët për të mos mbetur mbrapa kanë përdorur fjalën „kulturë“.²⁸⁴ Për mendimin e Taylorit, kultura apo qytetërimi është një tërësi komplekse e cila përfshin diturinë, besimin, artin, moralin, jurisprudenten, doket dhe traditat e një shoqërie, shprehjet dhe afinitetet tjera të cilat i fiton njeriu si anëtarë i shoqërisë.²⁸⁵ Sociologu amerikan Maciaveri jep disa përkufizime në të cilat vërehet dallimi midis kulturës dhe qytetërimit. Maciaveri dallon mes këtyre termave duke u bazuar në funksionet e ndryshme të tyre. Sipas mendimit të tij çdo mjet ose vegël e orientuar kah dobia është element i qytetërimit. Qytetërimi përfshinë mjetet materiale dhe teknike, sistemet organizative, ligjet, shkollat.²⁸⁶ Kulturën e formon stili jetësor, ai i të menduarit të një shoqërie, marrëdhëniet e përditshme, mënyra e shprehjes në art, në letërsi, në fe, në gëzime, etj.

Literatura gjermane, etnoset dhe kombet (pa iu referuar konceptit qytetërim) i ndan në „Naturvölker“ dhe „Kulturvölker“. Në këtë klasifikim me apelativin „Naturvölker“ (shoqëri e natyrës) emërtohen shoqëritë e cilësuar si „primitive“, kurse me atë „Kulturvölker“ ato të

²⁸² Po aty, Tabela nr. 10.

²⁸³ Po aty, Tabela nr. 20.

²⁸⁴ Bullaç, *Historia, shoqëria dhe tradita*, fq. 203.

²⁸⁵ Po aty, fq. 204.

²⁸⁶ Po aty, fq. 35.

cilësuar si të „civilizuara“. Kjo lë përshtypje se shoqëritë primitive nuk zotërojnë aspak kulturë.²⁸⁷

Nëse pas kalimit më tepër se gjysmës së jetës në mërgim akoma kërkohen sqarime shtesë dhe të reja rreth këtyre dy termeve, atëherë duhet një „rilindje“ për të mbërthyer pajtueshmërinë dhe harmoninë mes këtyre dy koncepteve. Përderisa kultura gjermane nuk synon të jetë ideologjike padyshim mbetet në pajtueshmëri me natyrën e kulturës kombëtare të migrantëve. Në këtë rast migranti shqiptar nuk refuzon që të identifikohet me kulturën gjermane. Kultura gjermane nuk mëton përmes botëkuptimeve të proceseve integruese të ndikojë domosdoshmërisht në perceptimet e migrantëve shqiptarë ndaj kulturës, folklorit, kulteve religjioze, traditës, kodit moralo-etik etj. Ajo përmes përkrahjes morale dhe materiale inkurajon migrantët që ti kushtojnë kujdes kultivimit të kulturës dhe folklorit të tyre etnik, sa për ilustrim mund të përmendet një shprehje e kryetarit të komunës së Leverkusenit z. Paul Hebbel nga partia e CDU-së i cili me rastin e manifestimit qendror të gurrëthemelit të objektit të kultit në Leverkusen mes tjerash thotë „uroj që ju përmes ndërtimit të këtij objekti të kultit të keni me veti një pjesë të vendlindjes“.²⁸⁸ Të njejtën do ta thotë edhe prefekti z. Ernst Kuchler nga rradhët e SPD-së me rastin e një vizite që i bëri këtij objekti.²⁸⁹

Samuel Huntington mendon se njerëzit afrohen me ata, që kanë prejardhje, fe, gjuhë, vlera e institucione të ngjashme, kurse largohen prej atyre që i kanë të gjitha këto të ndryshme.²⁹⁰ Ky pohim është i vërtetë edhe për migrantët shqiptarë, ngase ata mendojnë me 67,5% se nuk gjasojnë me gjermanët. Nga ana tjetër edhe pse shumë nga këto elemente i kanë të ndryshme ata nuk ndjehen të huaj dhe të diskriminuar në Gjermani.²⁹¹ Duke qenë të ndryshëm, ashtu si i bën njerëzit historia dhe bota²⁹² duhet të bazohet në identifikimin e përbashkët që siguron të ardhme në paqë dhe bashkëjetesë.

Një ndër identifikimet e përbashkëta është shtetësia gjermane të cilën për momentin migrantët shqiptarë e posedojnë mbi 20%.²⁹³ Migrantët shqiptarë edhe pse e posedojnë shtetësinë gjermane ata vlerësojnë se njeriu do të ishte gjerman „nëse prindërit i ka gjerman“,

²⁸⁷ Po aty, fq. 37.

²⁸⁸ Hebbel, Paul, *Manifestimi qendror i gurëthemelit të ndërtimit të xhamisë*, Mesxhidi Aksa, Forum, Leverkusen, 15.05.2004.

²⁸⁹ Kuchler, Ernst, *Dialog der Kulturen, Moschee Mesxhidi Aksa*, Leverkusen, 25.11.2005.

²⁹⁰ Huntington, *Përplasja e qytetërimeve dhe ribërja e rendit botëror*, fq.140

²⁹¹ Shih Shtojca, Tabela nr. 14 dhe 13.

²⁹² Demiraj, Bardhyl, *Nach 450 Jahren: Buzukus "Missale" und seine Rezeption in unserer Zeit*, Francesco, Altimari, *Miti i Skënderbeut në letërsinë arbëreshe të Rilindjes*, fq. 307.

²⁹³ Shih Shtojca, Tabela nr. 6.

51,7%,²⁹⁴ 52,5% konstatojnë se kjo është vetëm një mendim dhe nuk ka të bëj me ta,²⁹⁵ që don të thotë se migrantët shqiptarë edhe pse e kanë shtetësinë gjermane ata „asesi nuk mund të bëhen gjerman“.²⁹⁶ Migrantit shqiptar identifikohet edhe me tokën gjermane përmes pronës të cilën e posedon. Bazuar në statistikën gojore në Leverkusen migrantët shqiptarë posedojnë mbi 150 objekte banimi, shtëpi apo banesa. Me kënaqësi migrantët shqiptarë identifikohen edhe me ndërmarjet dhe bizneset e tyre. Dikur që ishin vetëm punëtor krahu, duke qenë të kualifikuar dhe të shkolluar ata sot jo vetëm që udhëheqin në ndërmarjet e tyre por kanë arritur të hapin vende pune në mini firmat që i kanë në pronësi të tyre.²⁹⁷

Shoqërimi i migrantëve shqiptarë me gjermanët mundëson shpjegimin e nivelit të pranimit dhe komunikimit me shoqërinë vendëse. Përmirësimet e mjeteve të komunikimit dhe qëllimet e përbashkëta kanë ndikuar në ndërveprime simetrike ndërmjet kulturave të ndryshme.²⁹⁸

6.3. Hipoteza e tretë

Verifikimi i hipotezës së tretë bazohet mbi qëndrimin e migrantëve shqiptarë në Leverkusen të Gjermanisë ndaj identifikimit të tyre me kulturën fetare. Grup statistika e parë verifikon mospërputhjen e rezultateve midis hipotezave. E rëndësishme është se dallimet ndërmjet hipotezës së parë dhe të tretë janë minimale rreth faktit të identifikimit të migrantit shqiptar me kulturën kombëtare dhe fetare. Migrantët shqiptarë përmes hipotezës së tretë verifikojnë bindshëm stabilitetin e identifikimit të tyre me kulturën fetare përkatëse, në këtë rast të migrantëve shqiptarë në Leverkusen të cilët identifikohen me kulturën fetare islame.²⁹⁹ Nga verifikimi i hipotezës së tretë shihet qartë se migranti shqiptar nuk ndjehet i brengosur dhe me komplekse për atë se i takon një konfesionit. Përkundrazi ndjehet krenar dhe i privilegjuar duke u identifikuar me kulturën e tij fetare. Provat e hipotezës së tretë verifikojnë me 547 përcaktime vlerat e identitetit fetar (grup statistika e parë). Përmes verifikimit të hipotezës së tretë shihet një epërsi minimale me 42 përcaktime më tepër, në favor të identifikimit me kulturën fetare.

²⁹⁴ Po aty, Tabela nr. 16.

²⁹⁵ Po aty, Tabela nr. 17.

²⁹⁶ Po aty, Tabela nr. 16.

²⁹⁷ Po aty, Tabela nr. 4.

²⁹⁸ Huntington, *Përplasja e qytetërimeve dhe ribërja e rendit botëror*, fq.144.

²⁹⁹ Shih Shtojca, Tabela nr. 11.

Gjatë verifikimit të hipotezës së parë u vërtetua korelacioni „unë jam i ndërlidhur me atdheun tim“ si më i theksuari me 108 përcaktime nga 116 të anketuar.³⁰⁰ Gjatë verifikimit të hipotezës së tretë haset në të njejtën vlerë me 108 përcaktime nga 116 të anketuar të cilët përcaktohen duke thënë se „unë ndjehem dhe jam musliman“.³⁰¹ Një paralelizëm i rastësishëm jep të kuptohet se migrantët shqiptarë identitetin e tyre fetar e ndërlidhin me atdheun e tyre. Kjo verifikon testin e hipotezës së tretë për ndikimet pozitive që sjellë kultura fetare për mbrojtjen e identitetit në shoqëritë multikulturore. Nëse bëhet një krahasim mes hipotezave vlerësohet me të drejtë se ka të bëjë edhe me fillimin e paraqitjes së asimilimit, tjetërsimit apo natyralizimit të individëve të verifikuar si të pa përcaktuar në asnjërin identitet. Numri i tyre verifikohet të jetë gjashtë për të cilët diskutohet më poshtë. Një dallim tjetër i cili paraqitet me rastin e verifikimit të hipotezës së tretë është qasja e migrantit shqiptar ndaj njohurive, praktikës dhe përkrahjes fetare. Për të verifikuar këtë të fundit është krahasuar me përkujdesin e kultivimit të gjuhës shqipe. Maksimalisht 54 migrantë flasin shumë mirë gjuhën shqipe dhe minimalisht një flet dobët shqip.³⁰² Maksimalisht 85 migrantë e përkrahin shumë fenë dhe minimalisht dy migrantë e përkrahin fenë pak.³⁰³ Hipoteza e tretë dhe e parë rezulton me statistika të përafërta. Për të verifikuar këtë mund të bazohet në rezultatet e tabelës nr. 9 dhe tabelës nr. 11, posaçërisht në konkluzat „unë ndjehem dhe jam shqiptar“ dhe „unë ndjehem dhe jam musliman“.

Ky hulumtim ka për qëllim që në mesin e migrantëve nga të gjitha trojet etnike të analizojë elementin e identitetit fetar në frymën kulturore. Elementi fetar poashtu është krijues dhe ndikues në krijimin e multikulturalizmit. Për mendimin e Alija Izetbegoviqit kultura filloi me „prologun në qiell“. Me religjionin e vet, artin, etikën e filozofinë, ajo, për këtë arsye, do të merret vazhdimisht me raportin e njeriut ndaj atij qielli, nga erdhi ai.³⁰⁴ E tërë kultura është veprim i religjionit në njeriun ose veprim i njeriut mbi vetveten.³⁰⁵ Përmes hipotezës së tretë është bërë e mundur të konstatohet se migrantët shqiptarë janë në gjendje origjinale brenda konditave dhe vlerave të identitetit fetar. Përmes grup statistikës së parë del rezultati se migrantët shqiptarë me 547 thënje verifikojnë qëndrueshmërinë dhe stabilitetin e tyre fetar.³⁰⁶ Migrantët shqiptarë në Leverkusen janë të lumtur dhe krenar me fenë e tyre. Ata ndjehen

³⁰⁰ Po aty, Tabela nr. 12.

³⁰¹ Po aty, Tabela nr. 11.

³⁰² Po aty, Tabela nr. 21.

³⁰³ Po aty, Tabela nr. 22.

³⁰⁴ Izetbegoviq, Alija, *Islami ndërmjet lindjes dhe perëndimit*, Logos, Shkup, 1993, fq. 62.

³⁰⁵ Po aty.

³⁰⁶ Shih Shtojca, Tabela nr. 11 dhe 22.

komodë dhe janë të lidhur ngushtë me kulturën fetare, nuk hezitojnë të identifikohen me përkatësinë fetare, përkundrazi atë e shfaqin me mburje.³⁰⁷

Krenaria dhe lumturia fetare arrihet përmes njohurive dhe praktikimit të fesë, botëkuptim të cilin migrantët e kanë shprehur përmes hipotezës së tretë. Elementi fetar mbetet pjesë dhe normë e përditshmërisë së migrantit të cilën e respekton me devotshmëri. Migrantit shqiptar edhe pse ka njohuri të mjaftueshme fetare paraqet gjendje mesatare të praktikimit të fesë,³⁰⁸ posaçërisht nga gjeneratat e reja. Sidoqoftë është konstatuar përkrahje maksimale dimensionit të identitetit fetar. Të gjitha fetë në Leverkusen punojnë në një tavolinë të përbashkët për ti trajtuar shumë çështje të përditshmërisë së tyre. Përmes formimit të „Rat der Religionen“ (Këshillit të feve) ata ju kontribuojnë proceseve integruese dhe i shërbejnë dialogut. Përmes dialogut dëshirohet të arrihet mirëkuptim, tolerancë, bashkëjetesë në paqe dhe fqinjësi të mirë. Dialogu në këtë fushë nënkupton që ithtarët e feve të ndryshme, të jenë ndërmjet tyre tolerantë, të butë, të afërt. Të mos detyrojnë njëri tjetrin të pranojë besimin apo mendimin e tyre me forcë, por, të diskutojnë dhe të bashkëpunojnë në zgjidhjen e problemeve të përbashkëta.³⁰⁹ Migrantëve shqiptarë në Leverkusen ju është lejuar ngritja e minares së parë shqiptare në mbarë Europën perëndimore, nga e cila thirret ezani.

Migrantit shqiptar para së gjithash përmes kësaj konfirmon dhe zbulon, publikon identitetin e vet përmes njohjes së Zotit. Në kontekstin familjar dhe shoqëror migrantit shqiptar përjashton çdo lloj ekstremizmi, fundamentalizmi dhe vehabizmi, poashtu nuk përkrah përdorimin e diskriminimit dhe dhunës në emër të fesë. E gjithë kjo e bën të vështirë, apo të pamundur diskutimin mbi praninë e islamit në Evropë nën presionin e krizave, kjo ngatërrohet me problemin e imigrimit. Vërtet mund të flitet për një lloj "Islamofobie", e cila imazhin e muslimanëve e kthen në diçka djallëzore dhe e pengon zhvillimin serioz të dinamikave që ndikojnë në bashkësitë e tyre në Evropë. Gjenerata e dytë dhe e tretë kanë luajtur një rol përcaktues në zhvillimin e të menduarit të njerëzve brenda bashkësive të ndryshme muslimane në Evropë, për arsye që në shikim të parë duken si kontradiktore me njëra tjetrën.³¹⁰

Islamofobia duke qenë një frikë irracionale, e drejtë apo e gabuar, gjithsesi është një sëmundje që mendohet të jetë sajuar nga islamistët. Njëjtë si fjala antisemitizëm që u sajuar nga reaksionarë, të cilët dëshironin të hudhnin urrejtje ndaj çifutëve të frymëzuar nga

³⁰⁷ Po aty, Tabela nr. 11.

³⁰⁸ Po aty, Tabela nr. 22.

³⁰⁹ Nesimi, Qani, *Dialogu obligim hyjnor*, Logos-A, Shkup, 2005, fq. 14.

³¹⁰ Ramadan, Tarik, *Muslimsein in Europa*, MSV Verlag, Köln, 2001, fq. 355.

antijudaizmi i krishterë.³¹¹ Antisemitët urrejtjen e tyre e drejtuan drejt një populli, që sipas Thilo Sarrazin-it, i cili ishte dhe mbetet njëri prej atyre me përbërje etnike më të ndryshme në botë.³¹² Studimet sociologjike për islamofobinë janë shumë të rralla. Islamofobia është dallimi dual i cili ka për qëllim, në veçanti, preferencat, kulturore, nacionale dhe fetare. Është diskriminim i cili sulmon shenjat e dukshme të fetarizmit islam, mirëpo ka dallim mes dy gjërave: „Islamofobia profesionale e fshehur”, sulmon bartësit e simboleve fetare të dukshme, duke iu referuar argumentit të laicizmit (shekullarizmit), thënë shkurtë, islamofobi e cila fshehet pas vlerave të cilësuar si globale, të cilat në rend të parë parapëlqejnë të sulmojnë vajzat dhe gratë e mbuluara. Ato gra, sipas vlerësimit të tyre, nuk “meritojnë” të zhvillojnë punë profesionale në hapësirat gjysmëpublike ose publike. Supozohet se bartin ideologji të prishur, sidomos ideologji që është kundër integritimit. Gratë e mbuluara mund të jenë shkak për ikje të myshterive dhe shërbyesve. Ky argument dëgjohej disa herë në gjuhë të disa ndërmarrjeve private dhe kornizave të larta me detyra publike.³¹³

„Islamofobia profesionale e qartë”, në disa sektore ekonomike, muslimanët i konsideron “të rrezikshëm” dhe “shkaqe të rrezikut”. Nga ky lloj i islamofobisë muslimanët përjetojnë lodhje të shumta. Sikurse u thuhet, lirohuni nga shenjat e fetarizmit tuaj e ne do t’ju punësojmë. Kjo islamofobi nuk është studiuar dhe nuk është zbuluar.³¹⁴ Shkak i islamofobisë është mosnjohja e islamit dhe muslimanëve.

Zhvillimi i njohjes së islamit kontribuon, padyshim, në pakësimin e fotografive dhe prapavijave që e dëmtojnë imazhin e islamit dhe muslimanëve.³¹⁵ Të vetëdijshëm për këtë gjendje muslimanët përpiqen të realizojnë përmes shumë aktiviteteve kulturore dhe përmes vizitave të ndërsjella, posaçërisht me rastin e „dyerve të hapura” të objekteve të kultit vizitorëve t’iu mundësohet promovimi i vlerave serioze fetare dhe zberthimi substancial i dogmës fetare që të kuptohet shfaqja e tyre e jashtme. Migrantët shqiptarë duke u identifikuar me fetë e tyre, gjegjësisht me islamin, shfaqin imazhin e identitetit të tyre dhe trashigiminë etnike dhe kulturore, nga fakti se bashkësitë fetare në Gjermani, gjegjësisht në Leverkusen emërtohen dhe njihen në bazë të etnitetit të tyre.³¹⁶

³¹¹ e-zani.blogspot.com, *A ka kuptim islamofobia?*, (29.01.2012).

³¹² Sarrazin, Thilo, *Deutschland schafft sich ab, Wie wir unser Land aufs Spiel setzen*, Deutsche Verlags-Anstalt, München, 2010, fq. 59.

³¹³ Serat, Hasen, *Islamofobia e re*, Albislam, Shkup, 2004, fq. 4.

³¹⁴ Po aty, fq. 5.

³¹⁵ Po aty, fq. 7.

³¹⁶ Psh. Xhamia Mesxhidi Aksa Leverkusen, *BASHKËSI ISLAME E SHQIPTARËVE*.

Konferenca Islamike e formuar në vitin 2006 ka për qëllim dialogun serioz për integrimin e muslimanëve në këtë shtet. Duke e renditur islamin si pjesë e historisë së tashme të Gjermanisë, migrantëve ju mundësohet realizimi i praktikës fetare në formën më të përshtatur. Rajonet dhe komunat janë duke bërë përgaditjet e fundit për fillimin e mësimit fetar nëpër shkolla.³¹⁷ Debati mbi islamin ka përfshirë tërë Gjermaninë dhe është futur në të gjitha institucionet. Duke u implikuar ky debat edhe ekonomikisht, politikisht dhe akademikisht, kërkohet bashkëpunim shkencor dhe akademik nga kadro nga fusha të njëjta për të ndërtuar ura që afrojnë të gjitha fetë dhe kulturat në Gjermani. Islami duke u zhvilluar me traditë shekullore deri në këto ditë ka kontribuar pozitivisht në mbijetesën e kombit dhe të formimit të identitetit. Mund të bëhen hamendësime të shumta, por migranti shqiptar në Leverkusen mbetet me shpresë se kjo fe i garanton vazhdimisht perspektivë.

Shqiptarët duke patur një traditë të pasur kombëtare dhe fetare rradhiten ndër popujt me vision për të ardhmen e tyre. Të ndërgjegjshëm ndaj Krijuesit kultivuan qëndrueshmërinë, kompaktësinë, durimin, solidaritetin në kohët më të vështira kur rrezikohej mbijetesë fizike e kombit dhe fesë. Besimi i paluhatshëm në të amshueshmen vazhdimisht lindi trima të cilët nuk kursyen jetën për të gjetur kënaqësinë e Krijuesit. Migrantët shqiptarë nuk hezituan të flijohen për të parë kombi një ditë më të bardhë. Përkulja vetëm ndaj Krijuesit, migrantëve shqiptarë ju jep forcë dhe një botëkuptim për të arsyetuar nënshtrimin vetëm ndaj Zotit. Të edukuar me këtë disiplinë ata forcojnë durimin dhe sakrificën. Përmes praktikës së lëmoshës migrantët shqiptarë u solidarizuan me bamirësi jo vetëm ndaj të afërmeve të tyre, por edhe ndaj të gjitha thirrjeve të atdheut. Migrantët shqiptarë u munduan të zbusin sadopak dhimbjet e jetimit dhe skamnorit. Ky solidaritet unifikoi kombin duke ngritur komunikimin në nivelin më të lartë.

„S`ka dyshim se besimtarët janë vëllezër, ... „³¹⁸

"Shembulli i besimtarëve në miqësinë, solidaritetin, dashurinë dhe mëshirën mes tyre, është si shembulli i trupit. Një gjymtyrë po të lëndojë, i gjithë trupi vuan nga pagjumësia dhe ethet."³¹⁹

Njohja burimore e udhëzimeve fetare ndërtoi migrantin shqiptar në Leverkusen për të patur ndikim në përkujdesjen familjare. Përkushtimi ndaj familjes dhe farefisit arrin kulminacionin e respektimit. Sa për ilustrim mund të përmendet se për një rast sëmundje apo vdekje, tërë familja 20 anëtarëshe nuk heziton të udhëtojë për në vendlindje në mënyrë që të

³¹⁷ rp-online.de, *Integration in der Schule*, NRW führt Islam Unterricht ein, (21.12.2011).

³¹⁸ Kur'an, 49:10.

³¹⁹ Nevevi, Imam, *Rijadus-Salihin*, Logos-A, Shkup, 1998, fq. 106.

lehtësojë durimin në vështirësi. Në kohën e proceseve integruese temë debati tejet e nxehtë rezulton të jetë „dhuna në familje“, „vrasja për nderë“, „martesa e detyrueshme“. E gjithë kjo plasohet në medime se manifestohet në familjet e migrantëve dhe disi tentohet të ndërlihet me islamin me pretekst se bëhet kërcënues për familjen dhe shoqërinë. Migrantët shqiptarë në bazë të njohurive fetare që i kanë në nivel,³²⁰ karakterizohen me mirësjellje, respekt reciprok dhe përkujdesje maksimale. Për të reflektuar trajtimin e mirë ndaj grave, besimtarët janë të vetëdijshëm për urdhëresat që apelojnë mosaprovimin e dhunës dhe keqtrajtimin ndaj grave. Kaptina e katërt e Kur'anit justifikon ndalimin e ushtrimit të dhunës në rast tradhëtie si dhe martesën me forcë.

Profesori Nol Coulson duke studjuar pozitën e gruas në islam shprehet: „Nuk ka dyshim se normat ligjore kur'anore që kanë të bëjnë me definimin e pozitës së gruas e veçanërisht atyre të martuara, janë normat më të drejta dhe reale ligjore.“³²¹ Mendim të ngjashëm ka edhe Anni Besant që thotë: „Për sa i përket çështjes së gruas, legjislatura islame është prej legjislatrave më të përparuara dhe më të drejta që kanë dalë në këtë botë. Ai është shumë përpara legjislatrave perëndimore për sa i përket pasurisë së patundshme, të drejtave të trashigimisë dhe ligjit të shkurrorëzimit.“³²² Ndërtimi i shoqërisë mes migrantëve shqiptarë në Leverkusen karakterizohet nga fuqia e manifestimit të identitetit. Pikënisja e marrëdhënieve shoqërore ndikohet nga prizmi i vizionit për identitetin kombëtar dhe fetar. Nga ky moment ekzistenca e standardave në përputhje me normat fetare dhe kombëtare është vendimmarrëse për një shoqëri të re, ndërkaq të zhveshurit nga këto standarde janë të urrejtur dhe të vetmuar. Të gjitha fetë vijnë nga nevoja njerëzore për orientim në një të vërtetë të lartë.³²³

Vlerat kombëtare dhe fetare të migrantëve shqiptarë kanë formësuar etikën e bëmirisë me vlera universale të padiskutuara. Këto vlera nuk përmbajnë aspak egoizëm pasi edukojnë të bëhet mirë dhe ti ndihmohet tjetrit për të pritur një shpërblim të amshueshëm. Migrantët shqiptarë janë në gjendje të lartë gadishmërie për të luftuar çdo formë të ekstremizmit apo terrorizmit. Të shërbyer me argumentet fetare dhe me miqësinë gjermane ata refuzojnë çdo tendencë për imponim dhune dhe intolerancë ndaj shoqërisë njerëzore, në përgjithësi, a asaj gjermane, në veçanti.

³²⁰ Shih Shtojca, Tabela nr. 22.

³²¹ Nedevij, Hasen, *Islami dhe ndikimi i tij në renesancën evropiane*, Komiteti i Bashkuar Saudit, Prishtinë, 2004, fq. 49.

³²² Po aty.

³²³ Schmidt, Helmut, *Außer Dienst Eine Bilanz*, Pantheon Verlag, München, 2010, fq. 289.

Përfundim

Përmes këtij punimi, qëllim kryesor mëtohet të jetë qasja e të shqyrtuarit të gjendjes së identitetit të migrantit shqiptar në Gjermani, gjegjësisht në Leverkusen. Identiteti i migrantit shqiptar në këtë qytet fokusohet nga këndvështrimi objektiv i gjendjes së identitetit kombëtar dhe fetar të migrantit shqiptar, si dhe identifikimi i tij përmes margjinave të ndryshme të kulturës gjermane. Migrantët shqiptarë duke vlerësuar kulturën gjermane dhe duke patur një qëndrim të balancuar ndaj të ndjenjurit i huaj apo i diskriminuar në Gjermani, mbeten të qëndrueshëm dhe të bindur në burimet e kultivimit dhe lulëzimit të identitetit të tyre. Migrantët shqiptarë këto burime i kultivojnë individualisht dhe kolektivisht.

Ky punim në kapitullin e parë trajton hipotezat e studimit duke u bazuar në teoritë sociologjike që mundësojnë shpjegimin, formësimin dhe dimensionet e identitetit individual dhe kolektiv. Përmes hipotezave të studimit janë vështruar, analizuar dhe hulumtuar korelacionet teorike dhe praktike të karakteristikave të identitetit kombëtar dhe fetar. Janë precizuar specifikat dhe veçoritë e identifikimit të migrantit shqiptar me kulturën gjermane. Teoritë klasike për identitetin janë bazuar në leksikone dhe enciklopedi të ndryshme shkencore duke ju referuar sociologëve, filozofëve dhe antropologëve botëror si: Hegel, Sheling, Marks, Weber, Erikson, Edensor, Smith, Dreher, Hurrelmann, etj. Definicionet dhe operacionalizimet e konceptit të identitetit etnik janë përqëndruar në mendimet e sociologëve bashkohor si: Giddens, Marshall, Frable, Jemes, Mead, Hall, etj. Përveç kësaj, një qasje serioze që trajton kapitulli i parë është edhe akulturalizimi i cili në kohën e globalizimit është i përqëndruar në fushën e adaptimit të kulturave. Ky term në aspektin etnologjik tenton (synon) përafrimin e kulturave me prejardhje të ndryshme, si dhe i referohet rritjes graduale të individit, gjegjësisht migrantit. Përmes edukimit në faza të njëpasnjëshme duke u socializuar me kulturën dominante në formë të pakontrolluar, këto teori janë bazuar në mendimet e sociologëve dhe antropologëve si: Phinney, Redfield, Berisha, etj.

Kapitulli i dytë trajton identitetin nacional të migrantëve shqiptarë në qytetin e Leverkusenin, duke u bazuar në konceptet dhe definimet kryesore mbi kombin. Terma më të përfolur të këtij kapitulli janë; termi „nacion“, „komb“, „fis“, „gjini“, etj. Njëherit trajtohen edhe termat; „Gastarbeiter“, „Fremde“, „ausländische Mitburger“, „Zuwanderer“, „Einwanderer“, etj. Përmes nivelit arsimor, profesionit, qëndrimit të gjatë dhe të rregulluar në këtë qytet dhe përmes njohjes së gjuhës gjermane, migrantët shqiptarë kanë lëshuar rrënjë duke u bërë qytetarë të barabartë socialë, kulturorë, politikë, ekonomikë në të gjitha fushat dhe nivelet shoqërore. Në përputhje me normat dhe vlerat kombëtare dhe fetare, në përputhje me rregullat e përgjithshme të ligjeve gjermane, migrantit shqiptar i mundësohet të përvetësoj

identitetin e tij duke ndërtuar të ardhmen në mesin e shoqërisë perëndimore pa mos u ndarë nga origjina. Kjo nuk është vetëm një kornizë ideore, por një realitet faktik në mesin e komunitetit të migrantëve shqiptarë në Gjermani, gjegjësisht në Leverkusen.

Gjatë elaborimit të rezultateve të identifikimit të migrantëve shqiptarë me kulturën kombëtare, gjermane dhe fetare, është vërtetuar gjendja faktike e çështjeve të prekura. Duke filluar nga strategjitë e formimit të identitetit, njohuritë gjuhësore, kontaktimi i migrantëve shqiptarë me bashkatdhetarët dhe me pjesëtarët e kulturave tjera. Gjithashtu gjatë këtij kapitulli janë analizuar edhe shkaqet e migrimit të shqiptarëve si dhe zbankimi dhe ballafaqimi i tyre me mjedisin e ri. Duke iu referuar realitetit në terren në kapitullin e tretë është hulumtuar çështja e gjendjes së identitetit të migrantëve shqiptarë gjatë proceseve integruese me qëllim të kuptimit sa më realisht të ndjenjave thelbësore për një jetë të përbashkët të migrantëve shqiptarë me popullin gjerman, si dhe me pjesëtarët e etnive tjera në qytetin e Leverkusenis. E gjithë kjo ka rezultuar të kuptohet se jeta e përbashkët është synim i të gjithëve.

Migrantët shqiptarë duke mbetur besnik ndaj identitetit të tyre kombëtar dhe fetar ndiqen për të vepruar denjësisht me qëllim të arritjes së zgjidhjeve të kënaqshme dhe bazike. Migrantët në kontekstin e përceptimit afirmativ deklarojnë se janë të ndikuar nga kultura gjermane, por në asnjë mënyrë nuk pranojnë asimilimin. Të përgjegjshëm dhe konstruktiv, migrantët shqiptarë me një traditë shekullore ushtrojnë përpjekje serioze për mbijetesën dhe formësimin e identitetit. Historikisht faktorë të rëndësishëm dhe potencial me ndikim qenësor mbeten; emancipimi kombëtar dhe fetar i migrantëve shqiptarë në Leverkusen të Gjermanisë. Mbetet mister mosdeklarimi i identitetit kombëtar dhe fetar i disa migrantëve shqiptarë në këtë qytet. Kjo çështje edhe pse nuk është alarmante për kohën, të tillëve ju humbin ndjenjat për identitet dhe ndonëse të bllokuar nga „prangat fillestare“ nuk mund të thonë „unë jam unë“. Të njëjtit pasi ndjehen kështu, pasardhësit e tyre i lënë pa origjinë, më vonë nga vetë kërkesa e unit pasardhësit do të pyesin „kush jamë unë“. Atëherë medoemos të kemi përgjigje, andaj ti kemi ndjenjat e plota individuale për të thënë „unë jam shqiptar“, „unë jam i kësaj feje“.

Shtojcë: Rezultatet e intervistave në formë tabelash

Tabela 1: Pjesëmarrja e të anketuarve sipas moshës së tyre:

116 të intervistuar	N	%
18 deri 25 vjeç	10	8,6
26 deri 45 vjeç	81	70
46 deri 60 vjeç	9	7,7
Mbi 61 vjeç	16	13,7
Gjithsej	116	100

Tabela 2: Pjesëmarrja e të anketuarve sipas gjinisë së tyre:

116 të intervistuar	N	%
Femërore	29	25
Mashkullore	87	75
Gjithsej	116	100

Tabela 3: Pjesëmarrja e të anketuarve sipas nivelit arsimor të tyre:

116 të intervistuar	N	%
Fillore cikli i I (4 vjeçare)	1	0,86
Fillore cikli i II (8 vjeçare)	29	25
E mesme profesionale	37	31,8
E mesme e përgjithshme	33	28,4
Fakultet	16	13,8
Gjithsej	116	100

Tabela 4: Pjesëmarrja e të anketuarve sipas profesionit të tyre:

116 të intervistuar	N	%
Punoni në një ndërmarrje si punëtor i pa kualifikuar	18	15,5
Punoni në një ndërmarrje si punëtor i kualifikuar	45	38,9
Punoni në një ndërmarrje si nëpunës zyrtar	7	6,4
Punoni në një institucion si nëpunës, mësues, bankier, etj.	9	7,7
Keni një ndërmarrje private	10	8,6

Studjoni	7	6,4
Jeni pensionist	11	9,5
Jeni amvise	6	5,2
Nuk keni një profesion	3	2,6
Gjithsej	116	100

Tabela 5: Pjesëmarrja e të anketuarve sipas kohëzgjatjes së qëndrimit të tyre në migrim:

116 të intervistuar	N	%
Jeni lindur në Gjermani	9	7,8
Qëndroni deri 15 vjet	36	31
Qëndroni deri 30 vjet	50	43,2
Qëndroni deri 50 vjet	21	18
Qëndroni mbi 50 vjet	0	0
Gjithsej	116	100

Tabela 6: Pjesëmarrja e të anketuarve sipas llojit të lejeqëndrimit:

116 të intervistuar	N	%
Shtetësi gjermane	24	20,7
Leje qëndrimi të kufizuar	7	6
Leje qëndrimi të pakufizuar	85	73,3
Gjithsej	116	100

Tabela 7: Pjesëmarrja e të anketuarve sipas përqindjes së jetës së kaluar në migrim:

116 të intervistuar	N	%
Më pak se 25 %	20	17,2
Ndërmjet 25-50 %	41	35,3
Deri 75 %	44	38
100 %	11	9,5
Gjithsej	116	100

Tabela 8: Pjesëmarrja e të anketuarve sipas vendit të origjinës:

116 të intervistuar	N	%
Shqipëria	2	1,7
Kosova	16	13,9
Maqedonia	95	81,8
Trojet etnike	3	2,6
Gjithsej	116	100

Tabela 9: Identifikimi i migrantit shqiptar me kulturën kombëtare:

Çka mendoni për konkluzat në vijim?

116 të intervistuar	N	%
Kultura ime kombëtare ka shumë ndikim pozitiv në jetën time	79	68,1
Unë jam krenar me kulturën time kombëtare	86	74,1
Unë ndjehem komod me kulturën time kombëtare	72	62
Unë jam i lidhur ngushtë me kulturën time kombëtare	77	66,4
Unë ndjehem krenar të identifikohem me kulturën time kombëtare	87	75
Unë ndjehem dhe jam shqiptar	104	90

Tabela 10: Identifikimi i migrantit shqiptar me kulturën gjermane:

Çka mendoni për konkluzat në vijim?

116 të intervistuar	N	%
Kultura gjermane ka ndikim në jetën time	76	65,5
Unë edhe me kulturën gjermane krenohem	15	12,9
Unë edhe me kulturën gjermane ndjehem komod	27	23,2
Unë jam i lidhur ngushtë me kulturën gjermane	14	12
Unë ndjehem krenar të identifikohem me kulturën gjermane	7	6
Unë ndjehem gjerman edhe nëse kam apo jo shtetësi gjermane	2	1,7

Tabela 11: Identifikimi i migrantit shqiptar me kulturën fetare:

Çka mendoni për konkluzat në vijim?

116 të intervistuar	<i>N</i>	<i>%</i>
Kultura ime fetare ka shumë ndikim pozitiv në jetën time	90	77,5
Unë jam krenar me kulturën time fetare	91	78,4
Unë ndjehem komod me kulturën time fetare	81	69,8
Unë jam i lidhur ngushtë me kulturën time fetare	84	72,4
Unë ndjehem krenar të identifikohem me kulturën time fetare	93	80,1
Unë ndjehem dhe jam musliman³²⁴	108	93,1

Tabela 12: Në mënyrë që të kemi korelacion dhe besueshmëri:

Çka mendoni për konkluzat në vijim?

116 të intervistuar	<i>N</i>	<i>%</i>
Unë jam i ndërlidhur me atdheun tim	108	93,1
Unë jam i ndërlidhur me Gjermaninë	56	48,2
Unë jam i ndërlidhur me Europën	29	25
Unë jam i ndërlidhur me tërë njerëzimin	41	35,3
Unë jam i ndërlidhur me diçka tjetër	0	0
Unë nuk jam i ndërlidhur me asnjë kategori	0	0

Tabela 13: A ndjeheni në pozitë të pafavorshme, të diskriminuar shkakun e etnitetit tuaj?

116 të intervistuar	<i>N</i>	<i>%</i>
Jo	42	39,4
Rrallë	25	23,5
Ndonjëherë	35	32,5

³²⁴ Nuk ka patur përcaktime tjera konfesionale.

Shpesh	2	1,8
Shumë shpesh	3	2,8
Gjithsej	107	100

Tabela 14: A gjasoni me një person „tipik gjerman“?

116 të intervistuar	<i>N</i>	%
Shumë ngjashëm	1	0,8
Ngjashëm	16	14,5
Jo ngjashëm	20	17,2
Aspak	77	67,5
Gjithsej	114	100

Tabela 15: A ndjeheni i huaj në Gjermani?

116 të intervistuar	<i>N</i>	%
Jo	41	35,4
Po	75	64,6
Gjithsej	116	100

Tabela 16: Sipas mendimit tuaj, kur do të ishte njeriu gjerman?

116 të intervistuar	<i>N</i>	%
Nëse identifikohet me Gjermaninë	14	12
Nëse e flet gjermanishten	2	1,7
Nëse një kohë të gjatë jeton në Gjermani	1	0,86
Nëse ka lindur në Gjermani	3	2,5
Nëse rrethi shoqëror është gjerman	2	1,7
Nëse njeriu ndjehet gjerman	21	18,1
Nëse prindërit i ka gjerman	60	51,7

Nëse sillet si gjerman	10	8,6
Nëse ka shtetësi	9	7,7
Nëse është i akceptuar ashtu si është nga gjermanët	11	9,4
Nëse ka interesim për integrim	4	3,4
Nëse punon në Gjermani	0	0
Nëse ka pamje gjermani	1	0,86
Diçka tjetër	0	0
Nuk e di	10	8,6
Asesi nuk mund të bëhem gjerman	41	35,3

Tabela 17: Kjo që në tabelën 16 deklaruat a ka të bëjë edhe me ju?

116 të intervistuar	<i>N</i>	%
Po	35	30,2
Jo	61	52,5
Pjesërisht	15	13
Idiferent	5	4,3
Gjithsej	116	100

Tabela 18: Shoqëria juaj përbëhet apo do të ishte përbërë nga shokë?

- a) Të kulturës suaj kombëtare?
- b) Të kulturave tjera?
- c) Të kulturës gjermane?

116 të intervistuar	<i>N/A</i>	%	<i>N/B</i>	%	<i>N/C</i>	%
Asnjë	3	2,5	2	2,3	3	3,8
Pakicë	5	4,3	61	70,6	41	51,9
Gjysma	13	11	16	19	20	25,3
Shumica	62	53,5	7	8,1	15	19

Krejt	33	28,7	0	0	0	0
Gjithsej	116	100 %	86	100 %	79	100

Tabela 19: Sa shpesh takoheni me?

- a) Pjestarët e kulturës suaj kombëtare?
- b) Pjestarët e kulturave tjera?
- c) Pjestarët e kulturës gjermane?

116 të intervistuar	<i>N/A</i>	<i>%</i>	<i>N/B</i>	<i>%</i>	<i>N/C</i>	<i>%</i>
Asnjëherë	1	0,8	2	2,4	2	2,4
Rrallë	3	2,5	29	35,4	27	33
Ndonjëherë	13	11,2	30	36,6	26	31,6
Shpesh	67	57,7	15	18,3	14	18
Shumë shpesh	32	27,8	6	7,3	13	16
Gjithsej	116	100 %	82	100 %	82	100

Tabela 20: Sa e njihni gjuhën gjermane?

- a) Sa mirë flitni gjermanisht?
- b) Sa mirë lexoni gjermanisht?
- c) Sa mirë shkruani gjermanisht?
- d) Sa mirë kuptoni gjermanisht?

116 të intervistuar	<i>N/A</i>	<i>%</i>	<i>N/B</i>	<i>%</i>	<i>N/C</i>	<i>%</i>	<i>N/D</i>	<i>%</i>
Shkëlqyeshëm	33	28,5	37	32	30	25,8	38	32,8
Shumë mirë	32	27,6	42	36	20	17,2	41	35,2
Mirë	40	34,5	23	20	35	30,1	21	18,1
Mjaftueshëm	10	8,6	11	9,5	24	20,6	16	13,9
Dobët	1	0,8	3	2,5	7	6,3	0	0
Shumë dobët	0	0	0	0	0	0	0	0

Gjithsej	116	100	116	100	116	100	116	100
-----------------	------------	------------	------------	------------	------------	------------	------------	------------

Tabela 21: Sa e njihni gjuhën shqipe?

- a) Sa mirë flitni shqip?
- b) Sa mirë lexoni shqip?
- c) Sa mirë shkruani shqip?
- d) Sa mirë kuptoni shqip?

116 të intervistuar	<i>N/A</i>	<i>%</i>	<i>N/B</i>	<i>%</i>	<i>N/C</i>	<i>%</i>	<i>N/D</i>	<i>%</i>
Shkëlqyeshëm	34	29,3	45	38,8	40	34,5	52	44,8
Shumë mirë	54	46,7	45	38,8	43	37	38	39,6
Mirë	23	19,8	20	17,2	23	19,8	20	17,2
Mjaftueshëm	5	4,2	6	5,2	6	5,2	6	5,3
Dobët	0	0	0	0	4	3,5	0	0
Shumë dobët	0	0	0	0	0	0	0	0
Gjithsej	116	100	116	100	116	100	116	100

Tabela 22: Sa e njihni fenë tuaj?

- a) Sa mirë i njihni obligimet fetare?
- b) Sa mirë i praktikoni obligimet fetare?
- c) Sa e përkrahni fenë?

116 të intervistuar	<i>N/A</i>	<i>%</i>	<i>N/B</i>	<i>%</i>	<i>N/C</i>	<i>%</i>
Shumë	63	54,3	35	30,1	85	73,2
Mesatarisht	49	42,2	69	59,5	29	25
Pak	4	3,5	12	10,4	2	1,8
Gjithsej	116	100	116	100	116	100

LITERATURA E SHFRYTËZUAR

Burimet primare

1. Açıkgenç, Alparslan, *Mendimi shkencor dhe barrët e tij*, Logos-A, Shkup, 2006.
2. Ali, Pajaziti, *Fjalor i sociologjisë*, Logos A, Shkup, 2009.
3. Aliu, Bashkim, *Karakteristikat e sistemit ekonomik islam*, Furkan ISM, Shkup, 2005.
4. Altermatt, Urs, *Etnonacionalizmi në Europë*, Tiranë, 2002.
5. Bartles Ulrike/Heib Claudia/Ristau Daniela, *Deutschland mit anderen Augen*, Horlemann, 2009.
6. Böhm Dietmar, Böhm Regine & Deiss-Niethammer Birgit, *Handbuch Interkulturelles Lernen*, Herder, Freiburg, 1999.
7. Braha, Shaban, *Gjenocidi sërbomadh dhe qëndresa shqiptare*, Lumi-T, Gjakovë, 1991.
8. Bucaille, Maurice, *Bibla, Kur'ani dhe shkenca*, Sh.K.B. Shpresa e Kosovës, Gjakovë, (pa vit botimi).
9. Bullaç, Ali, *Historia, shoqëria dhe tradita*, Logos A, Shkup, 2003.
10. Dana, Sonila, *Kthimi nga emigracioni dhe sfidat e riintegritimit*, Shoqata „Shpresë për të ardhmen“ Tiranë, 2006.
11. Davutoglu, Ahmet, *Vetëpërceptimet e qytetërimeve*, Logos A, Shkup, 2002.
12. Drube, Claus, *Broshurë informative për prindërit shqiptar*, München, 2006.
13. Eckard, Michels, *Informationen, Kultur und Interkulturelle Kommunikation, Von der Deutschen, Akademie zum Goethe-Institut. Sprach- und auswärtige Kulturpolitik 1923-1960*, München, 2005.
14. Ekmekçiu, Ali, Behushi, Nazmie, *Fjalor Shqip-Gjermanisht*, Toena, Tiranë, 2001.
15. Esser, Hartmut, *Integration und ethnische Schichtung*, Mannheimer Zentrum für Europäische Sozialforschung, Mannheim, 2001.
16. Esser, Hartmut, *Soziologie*, Band 2, Campus Verlag, Frankfurt, 2000.
17. Feraj, Husamedin, *Skicë e mendimit politik shqiptar*, Logos-A, Shkup, 2009.
18. *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe*, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 1984.
19. Fromm, Erich, *Nëntë skica psikologjike*, Dy Lindje dhe dy Perëndime, Tiranë, 2005.
20. Fuchs-Heinritz, Werner, *Lexikon zur Soziologie*, VS Verlag, Wiesbaden, 2011
21. Gashi, Osman, *Mësimdhënia e letërsisë dhe perspektivat e multikulturalizmit*, Blendi, Prishtinë, 2009.
22. Geiger, Ruth-Esther, *Ihr seid Detschland, wir auch*, Suhrkamp Verlag, Frankfurt, 2008.

23. Gestrich, Andreas, & Kraus, Marita, *Migration und Grenze*, Franz Steiner Verlag, Wiesbaden, 1998.
24. Giddens, Anathony, *Sociologjia*, Çabej, Tiranë, 2002.
25. Grinberg, Rebecca, Grinberg, Leon, *Psychoanalyse der Migration und des Exils, Migrimi nga pikëpamja e psikoanalizës*, Internationale Psychoanalys, München und Wien, 1990.
26. Gülen, Fethullah, *Drejt një qytetërimi botëror me dashuri & tolerance*, Prizmi, Tiranë, 2007.
27. Gyndyz, Shinasi, *Dhuna fetare*, BIK, Prishtinë, 2005.
28. Habermas, Jurgen, *Perëndimi i përçarë*, Asdreni, Shkup, 2006.
29. Halit, Muharremi, *Fjalor i teologjisë*, Geer, Tiranë, 2006.
30. Hartmut, Wagner, *Bezugspunkte europäischer Identität*, LIT Verlag, Münster, 2006.
31. Hasani, Ismail, *Vetëdija fetare dhe kombëtare tek shqiptarët*, U.P. Prishtinë, 2001.
32. Heckmann, Friedrich, *Ethnic Minderheit, Volk und Nation*, Enke Verlag, Stuttgart, 1992.
33. Hofmann, Murad, *Islami si alternativë*, Furkan ISM, Shkup, 2000.
34. Huntigton, Samuel, *Përplasja e Qytetërimeve*, Logos A, Shkup, 2009.
35. Ibn Warraq, Taslima Nasreen, *Warum ich kein Muslim bin (Pse nuk jam mysliman)*, Matthes & Seitz Berlin, Berlin, 2004.
36. Ibrahim, Arta, *Integrimi i Ballkanit Perëndimor në UE*, Logos A, Shkup, 2009.
37. Ikonimi, Luljeta, *E drejta migratore*, Organizata Ndërkombëtare për Migracion, Tiranë, 2009.
38. Izetbegović, Alija, *Islami ndërmjet lindjes dhe perëndimit*, Logos-A, Shkup, 1993.
39. Jashari, Hasan, *Sociologjia e arsimit*, Interlingua, Shkup, 2005.
40. Kasimati, Mimoza, *Migracioni shqiptar pas viteve 90 dhe ndikimi i tij në jetën ekonomike dhe sociale të fëmijëve të lënë pas*, UNICEF, Tiranë, 2009.
41. Kermani, Navid, *Wer ist wir-Deutschland und seine Muslime*, C. H. Beck oHG, München, 2009.
42. Krasniqi, Milazim, *Shtresimet e Identitetit Kulturor Kombëtar Shqiptar*, Zëri ynë, Prishtinë, 2003.
43. Kroth, Isabella, *Halbmond-wahrheiten*, Diedrichs Verlag, München, 2010.
44. Kullashi, Muhamedin, *Përplasja e identiteteve*, Dugagjini, Prishtinë, 2003.
45. Marshall, Gordon, *Fjalor Sociologjik i Oksfordit*, Botimet IDK, Tiranë, pa vit botimi.
46. Mojzes, Poll & Svidler, Leonard, *Ndërtimi i besimit përmes dialogut ndërmjet kishave dhe bashkësive fetare në Maqedoni*, Philadelphia, Shkup, 2004.

47. Morina, Qemal, *Identiteti fetar i shqiptarëve*, Edukata islame, BIK, Prishtinë, 2003.
48. Murtezai, Ekrem, *Fjalor i filozofisë*, Toena, Tiranë, 2007.
49. Murtezai, Ekrem, *Fjalor i terminologjisë fetare*, BIK-u, Prishtinë, 2007.
50. Mustafa, Muhamet, *Diaspora dhe politikat e migracionit*, Forum 2015, Prishtinë, 2007.
51. Nedevij, Hasen, *Islami dhe ndikimi i tij në renesancën evropiane*, Komiteti i Bashkuar Saudit, Prishtinë, 2004.
52. Nesimi, Qani, *Dialogu obligim hyjnor*, Logos-A, Shkup, 2005.
53. Nevevi, Imam, *Rijadus-Salihin*, Logos-A, Shkup, 1998.
54. Nuscheler, Franz, *Internationale Migration. Flucht und Asyl*, Leske+Budrich, Opladen, 1995.
55. Pirraku, Muhamet, *Kthenia kombit shqiptar atë që i takon nga natyra-për hirë të paqes në ballkan*, Ftesa, nr. 13, Gostivar, 1999.
56. Popper, Karl, *Për filozofinë dhe shkencën*, Fan Noli, Tiranë, 2009.
57. Prah, Hans-Werner, *Sociologie der Freizeit*, Ferdinand Schöningh, Paderborn, 2002.
58. Qahili, Reshat, *Antropologjia filozofike*, Tetovë, 2007.
59. Qahili, Reshat, *Mendimi antropologjik i Erih Fromit*, Vatra, Shkup, 2008.
60. Qosja, Rexhep, *Ideologjia e shpërbërjes, trajtesë mbi idetë çintegruese në shoqërinë e sotme shqiptare*, Toena, Tiranë, 2006.
61. Radchenko, Tatjana, *Bedeutung endogener und gesellschaftlicher Faktoren für die Identität eingebürgerter Migranten*, Universität zu Köln, Köln, 2009.
62. Raimi, Sunaj, “ *Sociologjia*”, Kosta Abras-Ohër, 2009.
63. Ramadan, Tarik, *Të jesh mysliman Evropian*, Logos-A, Shkup, 2011.
64. Regine, Penitsch, *Migration und Identität*, Weißensee Verlag, Berlin, 2003.
65. Reka, Blerim, & Ibrahim, Arta, *Studime Evropiane*, UEJL, Tetovë, 2004.
66. Reka, Blerim, *Kushtetuta e UE*, Logos A, Shkup, 2007.
67. Reka, Blerim, *Kushtetuta e UE-Rubikoni i Supranacionales*, Logos-A, Shkup, 2007.
68. Roald A. Hysa, Eduart Thartori, *Integrimi i shqiptarëve në Evropë dhe vlerat që Islami i përcjell në këtë integrim*, Forumi Musliman i Shqipërisë, Tiranë, 2008.
69. Rudolf de Cillia, *Spracherwerb in der Migration*, bm:bwk, Berlin, 2003.
70. Sarrazin, Thilo, *Deutschland schafft sich ab, Wie wir unser Land aufs Spiel setzen*, Deutsche Verlags-Anstalt, München, 2010.
71. Schmidt, Helmut, *Außer Dienst Eine Bilanz*, Pantheon Verlag, München, 2010.
72. Serat, Hasen, *Islamofobia e re*, Albislam, Shkup, 2004.
73. Seyran, Ates, *Der Multikulti-Irrtum*, Ullstein Verlag, Berlin, 2007.

74. Shamiq, Mid'hat, *Si shkruhet vepra shkencore*, Logos A, 2006..
75. Straubhar, Thomas, *Migration im 21. Jahrhundert*, J.C.B. Mohr, Tübingen, 2002.
76. Sulejmani, Metush, *Përsiatje sociologjike*, Logos-A, Shkup, 2005.
77. Ukshini, Sylë, *Kosova në politikën e jashtme të BE-së 1991-2007*, Logos-A, Shkup, 2008.
78. Voka, Rexhep, *Mendime*, K.B.I. Tetovë, 1991.
79. Wolfgang Bebedek & Minna Nikolova, *Kuptimi i të drejtave të njeriut*, Manz Crossmedia, Vjenë, 2003.
80. Xhaferi, Arbën, *Dialogu mes civilizimeve, Tribunë e përbashkët e përfaqësuesve të religjoneve dhe grupeve etnike*, Logos-A, Shkup, 2003.

Burimet terciare

81. Andric, Ivo, *Projekti për shfarysjen e shqiptarëve*, kohajone.com (25.12.2012).
82. Baliqi, Bekim, *Historia dhe Identiteti*, scribd.com (24.12.2011).
83. Baliqi, Bekim, *Teoritë mbi Identitetin kombëtar dhe shtetëror*, scribd.com (23.12.2011).
84. Ervin, Hatibi, *Identiteti shqiptar*, klealove.com (25.01.2012).
85. Fuhrer, Urs, Uslucan, Halil, *Familie, Akkulturation und Erziehung*, socialnet.de (28.12.2011).
86. Gashi, Driton, *Integrim apo asimilim*, albstudent.net, (19.12.2011).
87. Gesetz über den Aufenthalt, *die Erwerbstätigkeit und die Integration von Ausländern im Bundesgebiet*, aufenthaltstitel.de (25.01.2012).
88. Kiçmari, Sabri, *Nocioni i Kombit*, beepworld.de (25.01.2012).
89. Klein, Martin, *Akkulturation*, wirtschaftslexikon.gabler.de (28.12.2011).
90. Maliqi, Shkëlzen, *Kombi në pikën e verbër*, shkelzenmaliqi.wordpress.com (25.01.2012).
91. Murati, Valon, *Identiteti kosovar nuk është identitet kombëtar*, beepworld.de (26.10.2012).
92. Posener, Alan, *A ka kuptim islamofobia?*, e-zani.blogspot.com (29.01.2012).
93. Ruci, Ani, *Identiteti në Ballkan*, dw-world.de (29.12.2011).
94. Selaci, Gëzim, *Si të kryeni një projekt hulumtues*, gselaci.files.wordpress.com, (20.12.2011).
95. Shala, Adem, *Këshilli i arsimtarëve në Gjermani*, rrezore.com (25.01.2012).
96. Stadt Leverkusen, LIGA.NRW, *Mikrozensus 31.12.07*, leverkusen.com (23.11.2011).
97. Thomas, Wanie, *Enti për Migracion dhe Refugjat*, www.bamf.de (26.11.2011).
98. Zejneli, Xhelal, *Shqiptarët dhe studiuesit gjermanë*, shkupipress.posterous.com (27.12.2011).